

# RAPORT I STUDIMIT BAZË MBI DHUNËN NË FAMILJE DHE POLICINË E SHTETIT SHQIPTAR

**RAPORT I STUDIMIT BAZË  
MBI  
DHUNËN NË FAMILJE  
DHE POLICINË E SHTETIT SHQIPTAR**

INSTITUTI STUDIMOR DATA CENTRUM

TETOR 2012

Raporti u përgatit nga:

Alketa Berzani

Elsa Osmani

Redaktoi:

Arlinda Gjypi



**Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së  
Brendshme (MB) / Policisë së Shtetit (PSH) Shqiptar për  
Policimin në Komunitet**



Ky projekt u financua nga SIDA dhe vihet në zbatim nga SIPU në kuadër të programit “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme / Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet” (2012-2015)

Ky dokument është një raport studimor i përgatitur për programin “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme / Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet”. Opinionet ose pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e vetë Programit

## FALËNDERIME

Raporti studimor mbi *Dhunën në Familje dhe Policinë e Shtetit Shqiptar* është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm midis programit “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme / Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet” (2012-2015) dhe institutit studimor “Data Centrum”. Ky studim bazë u realizua si nevojë e planifikimit të aktiviteteve dhe mbështetjes së mëtejshme që ky program do të ofrojë ndaj Policisë së Shtetit në fushën e dhunës në familje. “Data Centrum” shpreh falënderimet e sinqerta për Ekipin Menaxherial të Programit (EPM) për këshillimin e vazhdueshëm dhe organizimin e tre grupe vetë diskutimit me disa grupe interesi. Dëshirojmë të falënderojmë gjithashtu SIDA-n që financon këtë program dhe SIPU-n si zbatuesin e tij.

“Data Centrum” shpreh falënderimet dhe mirënjohjen ndaj të gjitha institucioneve dhe aktorëve që morën pjesë në realizimin e këtij studimi.

Dëshirojmë të falënderojmë veçanërisht komunitetin e qarkut të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës, komunitetin rom, ballkano-egjiptian dhe LGBT, organizatat jofitimprurëse, bashkitë, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë Shëndetësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për kontributin e tyre të vyer gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave.

Një falënderim i veçantë drejtohet të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit Shqiptar që morën pjesë në këtë studim: z. Nuri Loca, drejtor në Drejtorinë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimit, të gjithë specialistëve të Sektorit dhe Seksioneve për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje, si dhe të gjithë specialistëve dhe ndihmëspecialistëve (SPZ) në Seksionet për Hetimin dhe Parandalimin e Krimit.

Për më tepër, dëshirojmë t’u shprehim mirënjohjen dhe falënderimet e përzemërta znj. Alma Gjurgji, shefe e Sektorit për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje, dhe z. Eneo Gjergjani, specialist për Policimin në Komunitet, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme, koordinimin, informacionin dhe opinionet e çmuara që na kanë dhënë në çdo hap të studimit.

Falënderojmë të gjithë punonjësit e policisë për kohën që na kushtuan në realizimin e intervistave.

Një falënderim i përzemërt u drejtohet të gjitha OJF-ve (“Gruaja tek Gruaja” dhe “Hapat e lehtë” në Shkodër, qendra sociale “Vatra” në Vlorë, Fondacioni “Kennedy” në Korçë dhe “Sot për të ardhmen” në Durrës) të cilat bënë të mundur kontaktet me individët, viktimat të dhunës në familje, dhe mbi të gjitha një mirënjohje e madhe dhe falënderim i thellë u shkon pa dyshim të gjithë këtyre personave, viktimat të dhunës në familje, që ndanë me ne përvojat e tyre.

“Data Centrum” shpreson që gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e këtij studimi të jenë të dobishme për Programin dhe të gjithë aktorët e angazhuar me dhunën në familje.

## LISTA E STAFIT KYÇ QË U PËRFSHI NË STUDIM

<b>Udhëheqëse e grupit të punës studimore:</b>	Alketa Berzani
<b>Konsulente:</b>	Niki Batzia
<b>Asistente e projektit studimor:</b>	Fjoralba Musa
<b>Menaxher terreni:</b>	Artur Angoni
<b>Menaxher i përpunimit të të dhënave:</b>	Vassilis Papadakis
<b>Stafi përgjegjës për studimin cilësor:</b>	Fleura Shkëmbi
	Elsa Osmani
	Almandina Guma
	Arlinda Gjypi
	Venera Canaj

“Data Centrum” shpreh falënderime për të gjithë moderatorët, facilitatorët, rekrutët, anketuesit dhe mbikëqyrësit e terrenit për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar në çdo fazë të studimit.

## PASQYRA E LËNDËS

Falënderime .....	3
Lista e stafit kyç që u përfshi në studim .....	4
<b>KAPITULLI I HYRJE</b> .....	13
1.1. PARATHËNIE PËR STUDIMIN .....	14
1.2. PARATHËNIE PËR FENOMENIN E DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI .....	14
1.3. PËRSHKRIM I REAGIMIT ZYRTAR NDAJ DHUNËS NË FAMILJE .....	16
1.3.1. Kuadri ligjor .....	16
1.3.2. Kuadri Institucional .....	20
1.3.3. Policia e Shtetit Shqiptar .....	22
1.4. RAPORTIMI ZYRTAR I DHUNËS NË FAMILJE .....	25
<b>KAPITULLI 2 METODOLOGJIA</b> .....	29
2.1. OBJEKTIVAT E STUDIMIT .....	30
2.2. VENDNDODHJA / MBULIMI .....	30
2.3. GRUPET NË FOKUSTË STUDIMIT .....	30
2.4. METODOLOGJIA .....	31
2.4.1. Rishikim dokumentesh e raportesh .....	31
2.4.2. Studimi cilësor .....	31
2.4.3. Studimi sasior .....	34
2.4.4. Kufizimet e studimit .....	37
<b>KAPITULLI 3 REZULTATET / GJETJET</b> .....	39
3.1. DHUNA NË FAMILJE .....	40
3.1.1. Perceptimi i komunitetit mbi dhunën në familje .....	40
3.1.2. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi dhunën në familje dhe burimi i informacionit .....	40
3.1.3. Perceptimi mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje .....	41
3.1.4. Qëndrimet ndaj dhunës në familje .....	43
3.1.5. Përvoja personale: format e dhunës në familje .....	45

3.1.6.	Profili i viktimave të dhunës në familje .....	47
3.1.7.	Profili i dhunuesve .....	48
3.2.	ADRESIMI DHE RAPORTIMI I DHUNËS NË FAMILJE .....	48
3.2.1.	Qëndrimet e komunitetit mbi raportimin e dhunës në familje .....	48
3.2.2.	Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi ligjet për dhunën në familje .....	49
3.2.3.	Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi autoritetet përgjegjëse për dhunën në familje .....	49
3.2.4.	Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi shërbimet që mund të ofrohen në Shqipëri për viktimat e dhunës në familje .....	50
3.2.5.	Perceptimi i komunitetit mbi autoritetet që mund të kontribuojnë më tepër në parandalimin e dhunës në familje .....	51
3.2.6.	Institucionet më të besueshme për të raportuar dhunën në familje .....	51
3.2.7.	Niveli i rekomandimit për të raportuar rastet e dhunës në familje në polici .....	52
3.2.8.	Raportimi i dhunës në familje: niveli dhe institucionet ku raportohet .....	53
3.2.9.	Faktorët frenues dhe nxitës në raportimin e dhunës në familje .....	54
3.3.	POLICIA DHE DHUNA NË FAMILJE .....	57
3.3.1.	Opinionet e përgjithshme publike për policinë .....	57
3.3.2.	Perceptimi i komunitetit mbi rolin e policisë në rastet e dhunës në familje .....	59
3.3.3.	Struktura organizative përgjegjëse për dhunën në familje brenda Policisë së Shtetit .....	60
3.3.4.	Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me aktorë të tjerë për dhunën në familje .....	61
3.3.5.	Ndërgjegjësimi dhe perceptimi i komunitetit mbi efikasitetin e bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me aktorët e tjerë për dhunën në familje .....	66
3.3.6.	Efektiviteti dhe suksesi i Policisë së Shtetit .....	67
3.3.7.	Nxitësit dhe frenuesit në efikasitetin e Policisë së Shtetit Shqiptar .....	71
3.4.	NEVOJA PËR PËRMIRËSIME TË MËTEJSHME .....	78
3.4.1.	Nevojat: Legjislacioni, bashkëpunimi ndërinstitucional, shërbimet .....	78
3.4.2.	Perspektiva e komunitetit në shërbimet e dobishme dhe aktivitetet për luftimin e dhunës në familje .....	79
<b>KAPITULLI 4 PËRFUNDIMET</b> .....		81
<b>KAPITULLI 5 REKOMANDIMET</b> .....		85
<b>SHTOJCAT</b> .....		90
SHTOJCA A: LISTA E PJESËMARRËSVE NGA AUTORITETET DHE OJF-TË NË STUDIMIN CILËSOR .....		90
SHTOJCA B: NIVELET NË POLICINË E SHTETIT TË INTERVISTUARA GJATË STUDIMIT CILËSOR .....		93

## LISTA E GRAFIKËVE

<b>Grafiku 1</b>	Trendi i raportimit zyrtar të dhunës në familje dhe kërkesa për urdhër mbrojtjeje .....	25
<b>Grafiku 2</b>	Pranueshmëria e dhunës në familje: Të rinjtë vs. Të rriturit .....	43
<b>Grafiku 3</b>	Pranueshmëria e dhunës në familje: Gjinia & Vendbanimi .....	44
<b>Grafiku 4</b>	Qëndrimi ndaj ndëshkimit të dhunuesit .....	44
<b>Grafiku 5</b>	Përvoja personale me dhunën në familje .....	45
<b>Grafiku 6</b>	Përvoja personale me llojet e ndryshme të dhunës në familje .....	46
<b>Grafiku 7</b>	A duhet raportuar dhuna në familje .....	48
<b>Grafiku 8</b>	Kush ka të drejtën të raportojë një rast dhune në familje .....	49
<b>Grafiku 9</b>	Sa do t'ua rekomandonit të tjerëve ta raportonin në Polici dhunën në familje .....	52
<b>Grafiku 10</b>	Adresimi i rasteve të dhunës në familje .....	53
<b>Grafiku 11</b>	Autoritetet ku viktimat adresojnë/ raportojnë dhunën në familje .....	54
<b>Grafiku 12</b>	Faktorët frenues në raportimin e dhunës në familje: Totali i viktimave që nuk kanë raportuar .....	54
<b>Grafiku 13</b>	Faktorët frenues në raportimin e dhunës në familje: Të rinj vs. Të rritur .....	55
<b>Grafiku 14</b>	Gatishmëria për të denoncuar në të ardhmen për shkak të masave mbrojtëse (UM) .....	56
<b>Grafiku 15</b>	Rrethanat nxitëse për raportimin e dhunës në familje .....	56
<b>Grafiku 16</b>	Imazhi publik i Policisë së Shtetit Shqiptar .....	58
<b>Grafiku 17</b>	Shkalla e kënaqësisë me rolin e Policisë së Shtetit .....	58
<b>Grafiku 18</b>	Efektiviteti i Policisë në përgjigje ndaj dhunës në familje .....	68



## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1</b>	Evidenca e rasteve të raportuara të DHF: viti 2008 deri në 6-mujorin e parë të 2012-s për çdo qark .....	26
<b>Tabela 2</b>	Kërkesat për UM: viti 2008 deri në 6-mujorin e parë të 2012-s për çdo qark .....	26
<b>Tabela 3</b>	Rastet e dhunës në familje dhe vrasjet: viti 2008 deri në 6-mujorin e parë të 2012-s .....	27
<b>Tabela 4</b>	Çështjet e vlerësimit, metoda dhe kampioni për grupin përkatës .....	32
<b>Tabela 5</b>	Karakteristikat e të anketuarve .....	35
<b>Tabela 6</b>	Burimi i informacionit mbi dhunën në familje .....	40
<b>Tabela 7</b>	Sa i përhapur mendoni se është fenomeni i DHF në Shqipëri .....	41
<b>Tabela 8</b>	Sa i përhapur mendoni se është fenomeni i DHF në zonën tuaj .....	42
<b>Tabela 9</b>	Njihni dikë që ka qenë viktimë e ndonjëres prej formave të DHF .....	42
<b>Tabela 10</b>	Qëndrimet ndaj dhunës në familje .....	45
<b>Tabela 11</b>	Përvoja personale me llojet e ndryshme të DHF: Të rinjtë vs.Të rriturit .....	46
<b>Tabela 12</b>	Profili i viktimave të dhunës në familje .....	47
<b>Tabela 13</b>	Njohuria mbi ligje të veçanta në Shqipëri për DHF .....	49
<b>Tabela 14</b>	Njohuria mbi autoritetet / institucionet përgjegjëse për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje në Shqipëri .....	50
<b>Tabela 15</b>	A jeni në dijeni për shërbime të ndryshme që mund t'u ofrohen viktimave/personave nga DHF në vendin tonë .....	50
<b>Tabela 16</b>	Vlerësimi për ndihmën që mund të japin këto institucione në parandalimin e DHF .....	51
<b>Tabela 17</b>	Institucioni ku keni më shumë besim për të raportuar rastet e dhunës në familje .....	52
<b>Tabela 18</b>	Perceptimi mbi rolin e Policisë në rastet e dhunës në familje .....	59

<b>Tabela 19</b>	Ndërgjegjësimi mbi bashkëpunimin e Policisë me institucione të tjera .....	66
<b>Tabela 20</b>	Sa efikas është bashkëpunimi i Policisë me institucionet e tjera .....	67
<b>Tabela 21</b>	Efektiviteti i Policisë në përgjigje ndaj dhunës në familje .....	67
<b>Tabela 22</b>	Reagimi i Policisë në rastet e dhunës në familje të raportuara .....	69
<b>Tabela 23</b>	Kapacitetet e Policisë së Shtetit lidhur me burimet njerëzore .....	72
<b>Tabela 24</b>	Kapacitetet e PSH-së lidhur me infrastrukturën, burimet logjistike dhe financiare .....	73
<b>Tabela 25</b>	Legjislacioni dhe zbatimi .....	74
<b>Tabela 26 A</b>	Shërbimet e ofruara - Institucionet e tjera .....	75
<b>Tabela 26 B</b>	Shërbimet e ofruara nga Policia .....	76
<b>Tabela 27</b>	Bashkëpunimi ndërinstytucional .....	77
<b>Tabela 28</b>	Nevojat: Legjislacioni, bashkëpunimi ndërinstytucional dhe shërbimet .....	78
<b>Tabela 29</b>	Aktivitete dhe shërbime të dobishme për të luftuar dhunën në familje .....	80
<b>Tabela 30</b>	Shtojca A: Lista e pjesëmarrësve nga autoritetet dhe OJF-të në studimin cilësor .....	90

## LISTA E FIGURAVE

<b>Figura 1</b>	Mendime të lira të pjesëmarrësve në lidhje me policinë .....	57
<b>Figura 2</b>	Struktura organizative përgjegjëse për dhunën në familje brenda PSH-së .....	61
<b>Figura 3</b>	Shtojca B: Nivelet në Policinë e Shtetit të intervistuar gjatë studimit cilësor .....	93

## SHKURTIME

<b>PSH</b>	Policia e Shtetit
<b>DPP</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DPQ</b>	Drejtoritë e Policive në Qarqe
<b>EMP</b>	Ekipi Menaxherial i Programit
<b>SIDA</b>	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>SIPU</b>	Instituti Suedez për Administrim Publik
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>MPÇSSHB</b>	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>PNUD</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>OSBE</b>	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>ADC</b>	Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim
<b>SKBGJ-DHGDHF</b>	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>DHF</b>	Dhuna në Familje
<b>UM</b>	Urdhër Mbrojtjeje
<b>UMM</b>	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
<b>ESOMAR</b>	Shoqata Evropiane për Sondazhe dhe Studime Marketingu
<b>F2F</b>	Ballë për ballë
<b>FG</b>	Fokus Grup
<b>IDI</b>	Intervistë e thelluar

## PËRKUFIZIME

**Dhunë në familje:** Në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhuna përkufizohet si "veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik". Si rrjedhojë, *dhuna në familje përkufizohet si "çdo akt dhune i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare"*.

**Pjesëtarë të familjes:** Sipas ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006, pjesëtarë të familjes janë:

- a. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
- b. vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
- c. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën "b";
- d. gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
- e. vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit; dhe
- f. fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues

**Abuzimi emocional:** shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit të një individi. Kjo mund të përfshijë kritikimin e vazhdueshëm, poshtërimin, përçmimin e aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.<sup>1</sup>

**Abuzimi psikologjik:** përfshin shkaktimin e frikës nëpërmjet trembjes; kërcënimin për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve ose të familjes së partnerit apo të miqve; kërcënimin për braktisje; vrasjen e kafshëve shtëpiake dhe shkatërrimin e pronës; kërcënimet për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve; izolimin e dhunshëm nga familja, miqtë, shkolla dhe/ose puna dhe mohimin e mundësisë për para ose mbështetje ekonomike.<sup>2</sup>

**Dhuna fizike:** përfshin, por nuk kufizohet me: çjerrjen, shtyrjen, goditjen, kapjen, rrahjen, asfiksimin, pickimin, shpimin, shkuljen e flokëve, përdredhjen e krahut, goditjen me shuplakë, gjuajtjen, djegien, therjen dhe mbytjen. Dhuna fizike mund të përfshijë përdorimin e madhësisë dhe të forcës fizike të një personi, shtrëngimet ose armët (p.sh. pistoletë, thikë ose një objekt tjetër) për të marrë dhe për të ruajtur kontrollin mbi personin tjetër. Dhuna fizike shpesh shkakton disa forma dëmtimi ose lëndimi dhe mund të shkaktojë edhe vdekje.<sup>3</sup>

**Dhuna seksuale:** përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit. Abuzimi seksual përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin martesor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimin e personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe të familjes.<sup>4</sup>

**Viktimë** është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e sipërpërmendur.

**Dhunues** është personi që ushtron dhe/ose paditet përpara organeve kompetente për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.

1. Dhuna në familje në Shqipëri: vrojtim kombëtar, INSTAT, Mars 2009, fq.15

2. Loc.cit

3. Loc.cit

4. Loc.cit

# ***KAPITULLI I***

## **HYRJE**

### **RISHIKIM I INFORMACIONIT EKZISTUES**

## I.1. PARATHËNIE PËR STUDIMIN

Instituti studimor "Data Centrum" në kuadër të programit "Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit për Policimin në Komunitet" (2012-2015) realizoi studimin bazë mbi "Dhunën në familje dhe Policinë e Shtetit" gjatë periudhës maj-korrik 2012.

Programi njih dhe punon mbi rezultatet e arritura nga programet e mbështetjes së mëparshme dhe atyre në vazhdimësi, si programi i BE-së PAMECA III. Ky program do të kontribuojë për të përmirësuar drejtimit kryesore të përzgjedhura nga Policia e Shtetit për zbatimin e Strategjisë 7-vjeçare 2007-2013 dhe Planin e Veprimit përkatës.

Synim i programit është të zhvillojë e përmirësojë edhe më tepër programin e Policimit në Komunitet dhe

- i. të përmirësojë aftësinë e Policisë së Shtetit që të ofrojë mbrojtje dhe siguri në përputhje me parimet e shërbimit
- ii. të rrisë besimin e individëve dhe komunitetit, si dhe vullnetin e tyre për të bashkëpunuar dhe punuar aktivisht me Policinë e Shtetit për reduktimin e krimeve.

Programi do të sigurojë mbështetje në tre drejtime:

1. Menaxhimin e Performancës;
2. Partneritetin /bashkëpunimin mes të rinjve dhe policisë, dhe
3. Dhunën në familje.

## I.2. PARATHËNIE PËR FENOMENIN E DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI

Dhuna në familje është një fenomen mbarëbotëror; i cili ndikon negativisht në integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social, sidomos të pjesës më të ndryshme të shoqërisë: grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Ky fenomen, i cili shkaktohet nga faktorë të ndryshëm, si: ndikimi kulturor me rrënjë të thella në traditat e vjetra patriarkale, situatat jetësore jo të shëndosha, diskriminimi gjinor, papunësia, kontrolli ndërbreznor në familje etj.; përbën një shqetësim në rritje për shoqërinë shqiptare, qeverinë dhe shoqatat civile, si dhe donatorët e huaj të cilët operojnë në vend.

Studime të ndryshme nxjerrin në pah se është e vështirë të masësh nivelin dhe përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen zhvillohet brenda familjes dhe konsiderohet si çështje familjare. Si rrjedhojë, studime të ndryshme vlerësojnë se janë disa faktorë që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, si p.sh.: turpi, frika nga ndëshkimi, normat kulturore, stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje etj., ndaj faktet dhe shifrat duhen parë me kujdes, pasi ato jo detyrimisht japin një pasqyrë të qartë lidhur me përhapjen në vend të dhunës në familje.

Në vijim, po paraqesim disa fakte dhe shifra që bazohen në studime të ndryshme, të cilat përshkruajnë përhapjen e dhunës në familje në Shqipëri, format e saj, profilin e viktimës dhe dhunuesit/es: faktorët që ndikojnë në ekzistencën dhe zhvillimin e këtij fenomeni.

Në Shqipëri është kryer vetëm një vërtetim kombëtar për dhunën në familje, i realizuar nga INSTAT-i, me mbështetjen e PNUD-it dhe UNICEF-it. Në këtë vërtetim (puna në terren u zhvillua në nëntor-dhjetor 2007), ku u përfshinë 2590 gra të moshës 15-49 vjeç, të paktën 56% e tyre deklaruan se kishin përjetuar të paktën një prej formave të dhunës në familje gjatë martesës së tyre ose në marrëdhëniet intime. 50,6% deklaruan se kishin përjetuar abuzim emocional në martesë ose në lidhjet e tyre intime, 39,1% kishin përjetuar abuzim psikologjik, 31,2% dhunë fizike dhe 12,7% kishin përjetuar dhunë seksuale.<sup>1</sup> Më tej, nga 991 fëmijët e anketuar të moshës 10-14 vjeç, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes.<sup>2</sup>

Një tjetër studim për Dhunën ndaj Fëmijëve (UNICEF, 2006) ku u përfshinë 1500 fëmijë, 1500 prindër dhe 1500 mësues nga tetë qarqe të Shqipërisë, zbuloi një përhapje të gjerë të ndëshkimit trupor në shtëpi: 1 në 2 fëmijë

1. Dhuna në familje në Shqipëri: vërtetim kombëtar, INSTAT, Mars 2009, fq.25

2. Ibid, pg. 51

pranoi se kishte qenë subjekt i dhunës në shtëpi kur ishte e nevojshme.<sup>3</sup>

Në Studimin Demografik dhe Shëndetësor 2008-09, INSTAT-i deklaroi se tre të katërtat (75 për qind) e fëmijëve shqiptarë të moshës 2-14 vjeç kanë përjetuar forma të ndëshkimit fizik ose psikologjik.<sup>4</sup>

Një studim mbi "Dhunën në familje dhe në komunitetet me etni të ndryshme" i zhvilluar në qarqet Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastrë, me një numër prej 426 të anketuarish ku u përfshinë burra dhe gra të moshës mbi 15 vjeç (202 të anketuar nga komuniteti në përgjithësi dhe 224 të anketuar nga komuniteti rom dhe egjiptian), zbuloi se 41% e romëve dhe egjiptianëve pranojnë të kenë përjetuar dhunë fizike; 34% dhunë psikologjike dhe 25% dhunë socio-ekonomike.<sup>5</sup>

Nuk ka të dhëna lidhur me përhapjen e dhunës në familje mes komunitetit LGBT. Sidoqoftë, bazuar në intervistën e thelluar me shoqatën ProLGBT, dhuna në familje në këtë komunitet rezultoi të jetë më e shpeshtë ndaj meshkujve sesa ndaj femrave. Deklarohet se mospranimi i orientimit seksual të tyre nga familjet është i lidhur shumë me presionin shoqëror ndaj gjithë familjes, duke e kthyer atë në faktorin kryesor për dhunën në familje ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT.

Format e dhunës fizike dhe psikologjike shpesh janë të lidhura ose paraprijnë njëra-tjetrën dhe, si pasojë, shumica e viktimave i përjetojnë ato njëkohësisht pa qenë të aftë t'i ndajnë njëra nga tjetra.

#### *Profili i viktimave dhe dhunuesve*

Studime të ndryshme tregojnë se anëtari më i dhunuar në familje është femër. Siç thuhet në "Raportin mbi ngritjen dhe efektshmërinë e funksionimit të sistemit të referimit ndërsektorial për dhunën në familje, në nivel lokal", 91% e 204 rasteve të regjistruara në sistemin e mbledhjes së të dhënave aplikuar në 5 bashki (Shkodër, Vlorë, Pogradec, Berat dhe Rrëshen) në periudhën qershor-shtator 2009, tregojnë prova të dhunës ndaj anëtares femër të familjes.<sup>6</sup>

Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të bazuara në rastet e raportuara zyrtarisht nga viti 2009 në 2011, tregojnë se në 81% të 5396 rasteve të raportuara të dhunës në familje, viktimat është femër.

Bazuar në Vrojtimin Kombëtar për Dhunën në Familje, në 2590 gra të moshës mes 15 dhe 49 vjeçe, nuk ka ndryshime domethënëse mes grupmoshave të grave në përjetimin e abuzimit emocional ose psikologjik. Sidoqoftë, ka ndryshime domethënëse mes grupmoshave të grave në përjetimet e dhunës seksuale dhe fizike. Në veçanti, gratë nga moshja 26 vjeç e sipër ishin në mënyrë të theksuar ato që raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë në grupmoshat 15 deri në 17 vjeç, 18 deri në 21 vjeç dhe 22 deri në 25 vjeç.<sup>7</sup>

Gratë nga zonat rurale ishin më të prirura për të pësuar dhunë emocionale dhe fizike nga bashkëshorti/partneri i tyre sesa gratë nga zonat urbane. Nuk shihet një lidhje mes përjetimeve të grave të abuzimit psikologjik, dhunës fizike dhe/ose dhunës seksuale dhe statusit në punë. Gratë me arsim të lartë kishin më pak mundësi të përjetonin dhunë emocionale, abuzim psikologjik dhe dhunë fizike nga bashkëshortët/partnerët e tyre. Është për t'u theksuar fakti se nuk ka ndryshime domethënëse lidhur me përjetimet e dhunës seksuale pavarësisht nivelit arsimor të grave.<sup>8</sup>

Sipas po të njëjtit studim, djemtë ishin më të prekur sesa vajzat nga dhuna fizike e ushtruar prej babait/njerkut të tyre; ndërsa vajzat dhunoheshin fizikisht më shumë se djemtë nga vëllai/motra e tyre.<sup>9</sup> Djemtë dhe vajzat pësonin dhunë fizike të njëjtë nga nëna/njerka e tyre. Fëmijët në zonat rurale (66.4%) ishin më të prirur për të pësuar dhunë fizike krahasuar me fëmijët e zonave urbane (50.4%).<sup>10</sup>

Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të bazuara në rastet e raportuara zyrtarisht nga

3. Studim mbi Dhunën ndaj Fëmijëve, UNICEF, 2006, fq.7

4. Studim Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri, INSTAT, Mars 2010, fq.152

5. A.Toska, A.Corrokkaj, E. Aliaj. Dhuna në familje dhe në komunitetet me etni të ndryshme, 2008, fq.37-38

6. Raporti "Ngritja e mekanizmit të referimit ndërsektorial për rastet e dhunës në familje, në nivel lokal dhe efektivitetit i funksionimit të tij", Rrjeti i Shoqatave kundër dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, Mars 2010, fq.31

7. Dhuna në familje në Shqipëri: vërtetim kombëtar, INSTAT, Mars 2009, fq.59

8. Po aty, fq.60

9. Loc.cit.

10. Po aty, fq.53



viti 2008 deri 2011, tregojnë se në 60% të 6218 rasteve të denoncuar të dhunës në familje, viktima është bashkëshortja e dhunuesit përkundrajt 6% të rasteve kur viktima janë bashkëshortët. Veç kësaj, në 7% të këtyre rasteve viktimat ishin fëmijët dhe në 8% ishin prindërit.

Shpeshësia e dhunës në familje ndaj burrave është shumë e ulët krahasuar me dhunën ndaj grave.

Nuk ka studime që të tregojnë një panoramë të dhunës ndaj të moshuarve dhe burrave. Siç mund të shihet nga raporti "Dhuna në familje: Paraqitje e situatës aktuale", hartuar nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me MPÇSSHB-në në vitin 2006, dhuna ekonomike është forma më e përhapur e dhunës ndaj të moshuarve dhe konsiston në: vjedhjen e parave ose sendeve të tjera me vlerë përmes përdorimit të manipulimit ose forcës. Sëmundjet, paaftësitë fizike dhe izolimi e bëjnë këtë grup më të ndjeshëm ndaj dhunës ekonomike dhe neglizhencës. Për më tepër, burrat janë më shumë të prekur nga dhuna psikologjike, ndërsa dhuna ekonomike nuk është e zakonshme duke marrë parasysh se në shumicën e familjeve shqiptare, ekonominë e shtëpisë e administrojnë burrat. Dhuna psikologjike në përgjithësi shprehet përmes presionit që shoqëria dhe familja ushtrojnë mbi burrat për të siguruar të ardhurat në familje.

Sipas Vrojtimt Kombëtar të Dhunës në Familje, meshkujt e të gjitha niveleve arsimore kryejnë akte të dhunës në familje ndaj bashkëshorteve dhe/ose partnereve të tyre intime. Analiza tregon se gratë që kanë përjetuar lloje të ndryshme të dhunës (emocionale, psikologjike dhe fizike) kishin më shumë gjasa që të raportonin se bashkëshorti i tyre kishte mbaruar arsimin e detyrueshëm ose të mesëm.<sup>11</sup>

Studimi mbi "Dhunën në familje dhe në komunitetet me etni të ndryshme" tregon se, sipas 79% të të anketuarve romë dhe egjiptianë, dhunuesi kryesor në familje është bashkëshorti, ndërsa në 8% të rasteve është shoqëria.<sup>12</sup>

Studime të ndryshme kanë treguar se ka tre nivele faktorësh që nxisin dhunën në familje.

- i. Makrofaktorët: ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikave, lëvizjeve të shumta demografike, traditës patriarkale etj.;
- ii. Mikrofaktorët (niveli familjar): marrëdhëniet familjare, historia e mëparshme e abuzimit gjatë fëmijërisë, rritja në një familje me ambient abuzues, modeli prindëror në familje, numri i lartë i fëmijëve në një familje, edukimi familjar etj.
- iii. Faktorët e nivelit personal: problemetë shëndetit mendor, çrregullime të ndryshme të personalitetit, abuzimi me alkoolin dhe drogën, stresi, niveli i ulët arsimor, kompleksi i inferioritetit, niveli i ulët i kontrollit, mungesa e ndjeshmërisë, varësia emocionale, përvojat personale në marrëdhëniet familjare etj.

### **1.3. PËRSHKRIM I REAGIMIT ZYRTAR NDAJ DHUNËS NË FAMILJE**

#### **1.3.1. Kuadri ligjor**

##### **Konventat ndërkombëtare të ratifikuara**

Me rënien e komunizmit në vitin 1991, qeveria shqiptare ka bërë përpjekje serioze për të pajtuar sistemin juridik shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ka miratuar e ratifikuar marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare të lidhura me antidiskriminimin dhe, direkt ose indirekt, me dhunën në familje.

Republika e Shqipërisë është pjesë e konventave të mëposhtme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e ratifikuar më 4 tetor 1991.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) e ratifikuar më 27 shkurt 1992. Kjo konventë i siguron shtetit një autorizim të qartë për mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme dhune në shtëpi dhe familje dhe përcakton rolin e tij si një arbitër kryesor për mirëqenien e fëmijës në ambientin familjar.

11. Dhuna në familje në Shqipëri: vërtetim kombëtar, INSTAT, Mars 2009, fq.58-59

12. A.Toska, A.Corrokaç, E. Aliaj. Dhuna në familje dhe në komunitetet me etni të ndryshme, 2008, fq.30

- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese, e ratifikuar më 11 maj 1994.
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar më 11 maj 1994. Kjo konventë është konsideruar si “një biletë ndërkombëtare të drejtash” për gratë. Ajo e përkufizon diskriminimin në një mënyrë shumë të qartë, duke treguar se gratë kanë të drejtë që të gëzojnë të drejta njerëzore të barabarta dhe të plota.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të ratifikuara më 10 shkurt 1996.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese, e ratifikuar më 10 shkurt 1996.

Në shtator 2010, qeveria shqiptare nënshkroi Deklaratën e Mijëvjeçarit, ku përfshihen edhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, një prej të cilëve është edhe barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas.

## Kuadri ligjor kombëtar

Në vitin 1998 qeveria shqiptare miratoi Kushtetutën e re të Shqipërisë. Kushtetuta i jep përparësi parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe mbrojtjes dhe respektimit të dinjitetit, të drejtave dhe lirive të njeriut. Për shembull, neni 18/2 thekson “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës dhe bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore”.

Më tej, neni 54/3 siguron se çdo fëmijë ka të drejtë “të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka për qëllim të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të garantojë mbrojtje me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje.

Ligji ka katër objektiva kryesorë:

1. krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
2. orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
3. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
4. sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Ligji për Dhunën në Familje ka caktuar një mekanizëm që u siguron viktimave të dhunës në familje një urdhër mbrojtjeje, i cili mund të jepet nga një gjykatë civile me kërkesë të viktimës së kësaj dhune. Gjykata duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 15 ditësh. Ka gjithashtu një dispozitë për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, të cilët duhet të lëshohen brenda 48 orësh nga gjykata nëse abuzuesi paraqet “kërcënim direkt dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien” e viktimës. Gjykata duhet të zhvillojë një seancë tjetër brenda 20 ditëve për të vendosur nëse do ta zgjasë apo ndërpresë urdhrin.<sup>13</sup>

Sipas Ligjit “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, lëshimi i një urdhri mbrojtjeje apo një urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes nuk i ndalon palët e interesuara për nisjen e një procesi penal për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

13. Amnesty International, T’i jepet fund dhunës në Shqipëri: Hapat e mëtejshëm, Mars 2010, fq. 4

Ligji nr. 9914, datë 12.5.2008 "Për disa shtesa në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" përcaktoi edhe Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës si një autoritet përgjegjës për çështjet e dhunës në familje.

Ligji ka pasur disa shtesa e ndryshime më 30.09.2010 me Ligjin nr.10 329, duke përfshirë përmirësime të mëtejshme, si:

- Detyrimin e autoriteteve përgjegjëse që të sigurojnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe informacioneve të dhëna nga viktimat;
- Lëshimin e një akti normativ për krijimin e një sistemi reagimi të koordinuar dhe referimi kombëtar për rastet e dhunës në familje. Ky sistem u legjitimua me VKM nr.334, datë 17.2.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
- Ligjërimin e policisë / prokurorisë për të paraqitur një kërkesë për urdhër mbrojtjeje për të miturit
- Përcaktimin e kohës minimale (24 orë) për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për të miturit;
- Përfshirjen e paditësit nga detyrimi për të paguar të gjitha shpenzimet gjyqësore; duke përfshirë edhe shërbimin përmbarrimor shtetëror;
- Përcaktimin e procedurës për asistencë ligjore falas për viktimat

Veç ligjit, akte të ndryshme ligjore, urdhra dhe dokumente janë hartuar nga ministrinë e linjës që të sigurojnë zbatimin e ligjit.

Një nga aktet më të rëndësishme ligjore është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.334, datë 07.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Ky vendim përcakton mekanizmin që duhet të ngrihet në bashki, të përbërë nga tre nivele:

a. *Komitetet drejtuese*

përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si: bashkia, policia, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria e rrethit, drejtoria arsimore, drejtoria e shëndetit publik, shërbimet sociale pranë bashkisë dhe komunave, zyra e përmbarrimit, prefektura, kryetarët e komunave përkatëse, zyra e punësimit, OJF-të, qendrat / strehëzat për viktimat e dhunës në familje, institucionet fetare që mund të ofrojnë shërbime për viktimat; dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë.

b. *Ekipe teknike ndërdisiplinore*

përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në komitetin drejtues, përfaqësues të njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunësve vendorë të barazisë gjinore, si dhe nga profesionistë të lirë: avokatë, psikologë etj.

c. *Koordinatorët vendorë*

për referimin e rasteve të dhunës në familje, të cilët janë përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë vendore, njëherëshi drejtues të punës së ekipit teknik ndërdisiplinor.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për Barazinë Gjinore", rregullon çështjet kyçe të barazisë gjinore për trajtim të njëjtë mes burrave dhe grave.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka zhvilluar *Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje 2011-2015*, bashkë me një Plan Veprimi Kombëtar. Kjo strategji është vazhdim i strategjisë së mëparshme, të zhvilluar në periudhën 2007-2010.

Strategjia Kombëtare synon:

- të arrijë barazi gjinore nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave (p.sh.: pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit), me mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë; dhe

- të përmirësojë mbrojtjen, reagimin e autoriteteve publike dhe mbështetjen për viktimat e dhunës në familje, si dhe të theksojë punën parandaluese, duke adresuar shkaqet e dhunës dhe abuzimit në familje.

Një prej qëllimeve strategjike të SKBGJ-DHGDHF-së është zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore, objektivat kryesorë të të cilit janë: 1) kuadër më i ashpër ligjor me tolerancë zero ndaj dhunës; 2) kulturë e përmirësuar kundër dhunës nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit; 3) masa dhe shërbime të përshtatshme për viktimat e dhunës në familje; 4) punonjësit në strukturat shtetërore t'u përgjigjen nevojave/të drejtave të viktimave dhe dhunuesve, dhe t'i adresojnë ato; 5) ngritja e një sistemi të mbledhjes së të dhënave dhe monitorimi i dhunës me bazë gjinore.

Ligji Nr.10.399, datë 17.03.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005, për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" sanksionon të drejtën për tërheqjen e ndihmës ekonomike jo vetëm nga kryefamiljari, por edhe nga gratë e dhunuara në rastet kur ato pajisen me UM/UMM; si dhe parashikon mbështetjen me ndihmë ekonomike të familjeve në kohën kur bashkëshortet janë në proces zgjidhjeje martesë. Ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare përfitohet për periudhën e vlefshmërisë së UM/UMM-ve.

Kodi shqiptar i Familjes përfshin gjithashtu nene të ndryshme lidhur me dhunën në familje ndaj bashkëshortes/it dhe fëmijëve. Ai përcakton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijës në jetën familjare, si dhe abuzimin dhe neglizhimin ndaj fëmijës. Për shembull, neni 62 thotë se "bashkëshorti abuzues duhet të largohet nga banesa bashkëshortore". Ky nen, sidoqoftë, nuk ka masa të tjera procedurale.

Ligji nr.8876, datë 4 prill 2002, "Mbi Shëndetin Riprodhues" përcakton se çdo grua duhet të vendosë me vullnetin e saj të lirë dhe pa ndonjë formë diskriminimi, detyrimi apo dhunë për të gjitha çështjet që lidhet me seksualitetin e saj dhe shëndetin e saj seksual e riprodhues.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka dispozita që mund të përdoren për të adresuar krime që lidhen me dhunën në familje; disa prej tyre vlejnë për abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve. Në këto vepra penale përfshihen, por nuk kufizohen:

- Vrasja (76-83, 85)
- Kanosja (84)
- Plagosja e lehtë ose e rëndë me dashje (Neni 88/89)
- Dëmtime të tjera me dashje, si dhe çdo lloj tjetër akti dhunë përbën kundravajtje penale kur shkakton paafësi të përkohshme për punë më tepër se nëntë ditë (Neni 90)
- Plagosja e lehtë ose e rëndë nga pakujdesia (Neni 91, 92)
- Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas (Neni 93)
- Marrëdhënia seksuale (Neni 100-108)
- Braktisja e fëmijëve të mitur (Neni 124)
- Mosdhënia e mjeteve për jetesë (mohimi i mbështetjes së nevojshme për të jetuar për fëmijët, prindërit apo bashkëshortin nga personi i cili është i detyruar nga një vendim gjyqësor t'ua sigurojë këtë, përbën kundravajtje penale) (Neni 125)
- Kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (Neni 134/141)

Ndryshimet e fundit në Kodin Penal, sipas Ligjit nr. 23/2012 datë 1.03.2012, sigurojnë dy nene të posaçme të rëndësishme për dhunën në familje.

- Neni 124/b përcakton/përfshin mbrojtjen e të miturve edhe nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit, kujdestari ligjor ose nga çdo person i detyruar të kujdeset për ta. Kjo lloj veprë dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.
- Neni 130/a e përcakton dhunën në familje duke përfshirë: rrahjen apo çdo vepër tjetër dhunë; kanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë; plagosjen me dashje, të kryer nga bashkëshorti/ja; ish-bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëjetuesi/ja, giini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, si vepër që dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Këto masa të rëndësishme kanë një subjekt të veçantë që përfshin një anëtar të familjes që kryen akte të dhunshme ndaj një anëtari tjetër të familjes, dhe me këtë mund të themi se dhuna në familje tashmë është qartësisht e përfshirë në Kodin Penal.

Para ndryshimeve në Kodin Penal, incidentet e dhunës në familje mund të ndiqeshin në rrugë civile duke iu drejtuar gjykatës për UM / UMM-je dhe/ose në rrugë penale duke iu drejtuar prokurorisë në rastet kur plotësoheshin disa kushte. Nga ana tjetër, dënimi për shkeljen e UM/UMM-ve ishte gjobë ose burgosje deri në 2 vjet.

Me ndryshimet e Kodit Penal, incidentet e dhunës në familje janë cilësuar si vepër penale (neni 130/a), dhe si pasojë prokuroria me të marrë dijeni për një rast të dhunës në familje (nga viktimë, policia ose burim tjetër) fillon menjëherë procedimin e rastit (kryesisht). Pra edhe nëse pala paditëse tërhiqet, çështja nuk mund të pushohet. Nga ana tjetër, dhunimi i urdhrat të mbrojtjes apo i urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes përbën një kundravajtje penale sipas nenit 320/321 të Kodit Penal të ndryshuar; si rrjedhojë, dhunuesi mund të arrestohet kur ekzistojnë këto rrethana dhe dënimi për shkeljen e UM/UMM-ve është përcaktuar vetëm burgosje deri në 2 vjet (pra është hequr dënimi me gjobë).

### 1.3.2. Kuadri Institucional

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, organizon institucionet e mëposhtme shtetërore në një sistem të koordinuar si autoritete përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Autoriteti kryesor përgjegjës, sipas këtij ligji, është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritete të tjera përgjegjëse janë: Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, njësitë e qeverisjes vendore, si edhe autoritetet gjyqësore (gjykatat).

Bazuar në këtë ligj, detyrat e të secilit prej autoriteteve përgjegjëse janë si më poshtë vijon:

#### **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka detyrat e mëposhtme:**

- a. të hartojë dhe zbatojë strategjitë dhe programet kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- b. të financojë ose bashkëfinancojë projektet që kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- c. të mbështesë ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare, si dhe shërbimet mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi;
- d. të organizojë kurse trajnimi rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
- e. të mbajë të dhëna statistikore për nivelin e dhunës në familje;
- f. të mbështesë dhe mbikëqyrë krijimin e qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;
- g. të mbështesë dhe mbikëqyrë krijimin e qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- h. të licencojë OJF-të e ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

Në këtë ministri, në Drejtorinë e Shanseve të Barabarta dhe Politikave Familjare, ka dy sektorë: Sektori për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, si dhe Sektori për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror në varësinë e MPÇSSH-së siguron shërbim për gratë e dhunuara.

Me nismën dhe drejtimin e MPÇSSH-së është ndërtuar një sistem i reagimit të koordinuar dhe referimit të rasteve të dhunës në familje për koordinimin e punës mes të gjitha autoriteteve përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror për parandalimin e dhunës në familje. Sipas MPÇSSH-së, deri më tani ky mekanizëm funksionon në 20 bashki.

Në prill të vitit 2011 u ngrit dhe u vu në funksionim Qendra e parë Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës

në Familje. Ngritja dhe funksionimi i kësaj qendre u mbështet nga PNUD-i në kuadrin e programit "Një OKB".

### **Ministria e Brendshme ka detyrat e mëposhtme:**

- a. të krijojë sektorë të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;
- b. të trajnojë efektivat e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje

(Për më shumë mbi strukturën dhe detyrat do të përkrahë në seksionin 1.3.3 të këtij kapitulli)

### **Ministria e Shëndetësisë ka detyrat e mëposhtme:**

të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna, me qëllim që:

- a. të ofrojë në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
- b. të bëjë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
- c. të evidentojë rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- d. të pajisë edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
- e. të referojë dhe orientojë viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Ministria e Shëndetësisë ka këtë strukturë që mbulon çështjet e dhunës në familje: Drejtorinë e Shëndetit Publik në MSH, Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, qendrat shëndetësore, si dhe shërbimet e urgjencës. Në Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik është ngritur Shërbimi Psikosocial dhe i Shëndetit Mendor; shërbim ky që përbëhet nga një mjek, një psikolog/punonjës social, një infermier. Ky shërbim ofron ndihmë psikosociale edhe për viktimat e dhunës në familje.

### **Ministria e Drejtësisë ka detyrat e mëposhtme:**

- a. të trajnojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
- b. të trajnojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23 pika 6, si dhe për të ndërmarë të gjitha veprimet e duhura;
- c. të financojë mbrojtje ligjore falas, sipas parashikimeve në ligji, dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar që mund të japin një asistencë të tillë.

Në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka një strukturë të veçantë që merret vetëm me çështjet e dhunës në familje. Dhuna në familje mbulohet nga Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, e cila mbulon gjithashtu edhe shërbimin përmbarimor. Të gjitha statistikave për urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes mblidhen nga Drejtoria e Statistikave në Ministrinë e Drejtësisë. Për ndihmën ligjore falas është ngritur Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.

### **Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka këto detyra:**

- a. harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje
- b. përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

**Njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë këto detyra:**

- a. angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
- b. instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
- c. ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Qeveria vendore ka ngritur sektorë të veçantë të përqendruar, mes të tjerave, edhe në dhunën në familje. Bazuar në intervistat e thelluara me përfaqësuesit e bashkive: Korçë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër, këto struktura janë nën varësinë e drejtorive të ndryshme (Drejtorisë së Shërbimeve Sociale; Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike; Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Kulturës dhe Sportit) bazuar në organizimin e brendshëm të secilës bashki. Këta sektorë kanë kryesisht në përbërje vetëm një specialist, i cili merret me dhunën në familje, si dhe barazinë gjinore. Bashkitë me anë të strukturave të tyre trajtojnë rastet e dhunës në familje edhe me ndihmë ekonomike. Në 37 bashki dhe 23 komuna janë emëruar administratorët socialë në përshkrimin e punës së të cilëve përfshihen edhe çështje të parandalimit të dhunës në familje dhe trajtimit të viktimave të saj.<sup>14</sup>

Bazuar në VKM nr.334, datë 17.2.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", pushteti vendor është autoriteti kryesor për drejtimin e komitetit drejtues, ekipit teknik ndërdisiplinor dhe përcaktimin e koordinatorit vendor. Sipas MPÇSSHB-së, deri më sot, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm (Fondi i Besimit të OKB-së, PNUD, USAID, ADC) janë 20 bashki që kanë ngritur këtë mekanizëm. Këto bashki janë: Shkodër, Vlorë, Durrës, Korçë, Rrëshen, Berat, Pogradec, Kamzë, Pukë, Lezhë, Elbasan, Manzë, Gramsh, Lushnjë, Laç, Shijak, Gjirokastër, Përmet, Tiranë dhe Minibashkia nr.6 në Tiranë.

**Sistemi gjyqësor**

Përgjegjësitë e gjykatave sipas Ligjit për Dhunën në Familje lidhen me shqyrtimin e kërkesave për UM / UMM-të. Sistemi gjyqësor në Shqipëri nuk ka seksione specifike apo gjyqtarë të profilizuar për dhunën në familje. Përgjithësisht në gjykatat e shkallës së parë me këto çështje merren gjyqtarët e Seksionit Familjar. Nuk ka ndonjë akt ligjor që të përcaktojë kriteret që duhet të përmbushin gjyqtarët të cilëve u caktohen çështjet e dhunës në familje dhe as nuk ka dispozitë të veçantë për këtë çështje në ligjin për dhunën në familje.

Sipas ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", Presidenti i Republikës ka kompetencën të vendosë nëse një gjykatë do të ketë një Seksion Familjar, si edhe juridiksionin territorial për gjykimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo kompetencë ushtrohet përmes lëshimit të një dekreti. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë është përgjegjës për caktimin e gjyqtarëve në Seksionin Familjar çdo dy vjet.

Si pasojë, nuk ka një strukturë të unifikuar në të gjitha gjykatat e rrethve gjyqësore në vend. Në disa prej tyre ka Seksione Familjare dhe gjyqtarët e këtij seksioni kanë përgjegjësi për të lëshuar urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrat e mbrojtjes. Rastet për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes caktohen mbi bazën e një shorti elektronik, ndërsa urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes shtyrtohen nga gjyqtarët e gatshëm pavarësisht nëse në gjykatën e rrethit ekziston ose jo një Seksion Familjar.

Në Prokurorinë e Rrethit të Tiranës ka një sektor të veçantë për krimet kundër jetës dhe shëndetit, i cili merret gjithashtu edhe me çështjet e dhunës në familje. Në rrethe të tjera, çdo prokuror merret edhe me rastet e dhunës në familje.

**1.3.3. Policia e Shtetit Shqiptar**

Drejtorja e Përgjithshme e PSH-së përfshin pesë departamente: Departamentin kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Departamentin për Sigurinë Publike, Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, Departamentin për Shërbime Mbështetëse, si dhe atë të Trajnimit Policor.

14. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015. Fq.38

Janë 12 drejtori policie në nivel qarku, 12 njësi rajonale të policisë rrugore, 43 komisariate dhe tetë drejtori të kufirit dhe migracionit. Inspektorët e zonës (SPZ) janë të shpërndarë në komunitet duke marrë ditë pas dite përgjegjësinë e aktiviteteve të Policimit në Komunitet në terren. Ata janë shpesh lidhja direkte me krerët e komunave dhe, kur u kërkohet, marrin pjesë në takimet lokale.

Përjasja e PSH-së për Policimin në Komunitet dhe zbatimin i Planit të Veprimit mbulohet nga neni 122 i Ligjit për Policinë e Shtetit, ku thuhet se PSH-ja është e detyruar të konsultohet në nivele të ndryshme me partnerët në kohën që përgatit planet e saj vjetore të policimit në qarqe.

Për më tepër, PSH-ja ka adoptuar Policimin në Komunitet si modelin kryesor në strategjinë e saj shtatëvjeçare, me këto elemente: parandalimin e krimit, veprimtarinë e orientuar nga planifikimi strategjik, policimin e udhëhequr nga informacioni / inteligjenca, partneritetin, dhe aktivitete të bazuara në kosto.

Strategjia vë një theks të veçantë në "identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve, dukshmërinë dhe arritshmërinë e shërbimeve të policisë nga qytetarët, cilësinë e këtyre shërbimeve". Gjithashtu, ka edhe një Plan të veçantë Veprimi të Policimit në Komunitet për 2011-2013-n (në vijim të planit të mëparshëm të Veprimit 2008-2010), i cili identifikon një numër nismash, përgjegjësitë dhe kufijtë kohorë për zbatimin.

Strategjia 7-vjeçare e Policisë së Shtetit (2007-2013) ka caktuar si një nga prioritetet: "*reduktimin e mëtejshëm të krimit dhe sjelljes antishoqërore*". Në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë i kushtohet reduktimit të dhunës në familje përmes masave ligjore dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit policor, i cili përballet me rastet e dhunës në familje.

Bazuar në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", MB dhe DPP kanë nxjerrë akte të ndryshme ligjore, urdhra dhe dokumente për të siguruar zbatimin e ligjit, si vijon:

- Urdhri nr. 379, datë 03.03.2008 i ministrit të Brendshëm: "Mbi masat për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe trajtimit të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare"
- Urdhri nr. 344, datë 05.10.2010 i ministrit të Brendshëm "Për disa ndryshime në urdhrin e ministrit të Brendshëm nr.251, datë 15.02.2008, Për përpilimin e statistikave kriminalitetit", i cili rikonfirmon:
  - Krijimin e regjistrave të veçantë për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, që administrohen nga çdo DPQ dhe komisarjat;
  - Krijimin e formularëve statistikorë për evidentimin e rasteve të dhunës në familje;
  - Strukturat e posaçme policore për evidentimin, administrimin dhe plotësimin e regjistrave dhe formularëve statistikorë, të ngritura në çdo DPQ e komisarjat.
- Urdhri nr.981, datë 31.10.2008, i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë "Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare".
- Që nga viti 2008 është në zbatim manuali "Mbi procedurat standarde që duhet të zbatohet punonjësi i PSH-së në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare" i miratuar me Urdhrin nr. 1035, datë 17.11.2008 nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Ky manual përshkruan në detaje procedurat dhe detyrat e punonjësve të policisë në përgjigje të rasteve të dhunës në familje.

### *Strukturat e veçanta në Policinë e Shtetit me fokus dhunën në familje*

Me miratimin e ndryshimeve strukturore në DPP, në korrik 2007, bazuar në ligjin nr.9669 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", u ngritën struktura të veçanta për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje, të cilat filluan të funksiononin normalisht në vitin 2008.

Kështu, në nivel qendror (DPP) ka një "sektor" për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje, në varësi të Drejtorisë së Hetimit dhe Parandalimit të Krimit në Departamentin për Sigurinë Publike; kurse në nivel lokal (në DPQ-të) ka "seksione" për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje, në varësi të sektorëve për Rendin dhe Sigurinë Publike.



Sektori dhe seksionet për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje përfaqësojnë strukturën administrative dhe operacionale në PSH, përgjegjëse për të marrë të gjitha masat për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e të miturve.

Këto struktura kanë përgjegjësinë të mbikëqyrin, monitorojnë dhe koordinojnë punën me strukturat lokale për hetimin dhe parandalimin e krimeve, për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje. Veç kësaj, ato duhet të sigurojnë një bashkëpunim dhe koordinim të punës me të gjitha autoritetet përgjegjëse.

Në nivel komisarati nuk ka struktura të veçanta për dhunën në familje, por inspektorët e zonës dhe/ose specialistët për hetimin e krimeve, të cilët janë pjesë e seksionit të Hetimit dhe Parandalimit të Krimeve, merren edhe me çështjet e dhunës në familje. Ndërkohë, punonjësit e policisë në sallat e drejtimit dhe komandimit (129) u përgjigjen të gjitha telefonatave, përfshirë këtu raportimin e rasteve të dhunës në familje.

Punonjësit e policisë u përgjigjen incidenteve të dhunës në familje:


- për të respektuar ligjin
- për të parandaluar dhe reduktuar dhunën në familje në të gjitha format e saj
- për të garantuar mbrojtje ligjore, veçanërisht siguri, për anëtarët e familjes qëi nënshtrohen dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar
- për të ndërprerë veprimet e dhunshme
- për të parandaluar dëmtimet e rënda dhe vrasjet
- për të minimizuar dhe reduktuar përsëritjen e herëpashershme të akteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Policisë së Shtetit:

- të krijojë struktura të posaçme dhe të caktojë personat përgjegjës
- t'i përgjigjet çdo njoftimi të marrë nga viktimë ose persona të tjerë për incidente të dhunës në familje
- të sekuestrojë armën e gjetur gjatë kontrollit dhe të kryejë veprimet procedurale sipas rastit
- të regjistrojë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar dhe sipas rastit, të fillojë hetimet kryesisht
- të informojë, orientojë dhe referojë viktimën për në shërbimet sociale dhe shëndetësore
- të mbrojtë dhe të garantojë sigurinë e viktimës dhe dëshmitarëve
- të ndihmojë dhe kontribuojë që autori /dhunuesi të kapet sa më shpejt të jetë e mundur
- të paraqesë kërkesë për UMM/UM
- të përgatisë dokumentet brenda afateve procedurale për ndjekje penale
- të bashkëpunojë me prokurorinë për fillimin e procesit penal në rastet e përgjegjësisë penale
- të vërë punonjës policie në dispozicion të viktimës kur i rrezikohet jeta
- të marrë pjesë në procesin gjyqësor kur është e nevojshme për sigurinë e viktimës
- të mbështesë zyrat e përmbarrimit kur kërkohet për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre në vazhdimësi
- me urdhër të gjykatës, të shoqërojë viktimën dhe dhunuesin në banesë për të mbikëqyrur largimin e sendeve vetjake

## I.4. RAPORTIMI ZYRTAR I DHUNËS NË FAMILJE

Bazuar në të dhënat zyrtare nga DPP-ja, ka një tendencë rritjeje të rasteve të raportuara të dhunës në familje në polici, sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Dhunën në Familje, gjë që mund të vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku 1).



*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë*

Tabela 1 tregon numrin e rasteve të raportuara të dhunës në familje në policinë e çdo qarku që nga viti 2008 deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 (janar - qershor).

Nëse krahasojmë rastet e raportuara në vitin 2011 me të dhënat e vitit 2010, mund të shohim se niveli i raportimit në qarkun e Fierit pothuajse është dyfishuar (+48.5%), në qarkun e Durrësit është +39.2% dhe në qarkun e Tiranës +29.2%.

Raportimi zyrtar në Shqipërinë Veriore, sidomos në Kukës dhe Dibër, është shumë më i ulët krahasuar me Shqipërinë Qendrore dhe Jugore. Gjatë vitit 2011, 52.2% e rasteve të raportuara kanë ndodhur në qendër, 36.1% në jug dhe 11.7% në veri të Shqipërisë.

TABELA 1	EVIDENCA E RASTEVE TË RAPORTUARA TË DHUNËS NË FAMILJE: VITI 2008 DERI NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË 2012-s PËR ÇDO QARK				
	2008	2009	2010	2011	Janar-Qershor 2012
Tiranë	437	579	539	696	392
Durrës	94	147	217	302	121
Elbasan	75	85	209	141	88
Vlorë	18	92	173	107	61
Berat	12	59	117	101	59
Fier	38	28	233	346	68
Gjirokastrë	11	13	62	53	28
Korçë	32	46	122	179	107
Shkodër	61	77	182	85	46
Lezhë	27	78	86	93	51
Dibër	9	6	16	46	56
Kukës	8	7	42	32	23
<b>TOTAL</b>	<b>822</b>	<b>1217</b>	<b>1998</b>	<b>2181</b>	<b>1100</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Sipas të dhënave të DPP-së për periudhën 2008-2011, në 60% të rasteve viktime është bashkëshortja përkundrejt 6% të rasteve kur viktimë është bashkëshorti.

Në 5% të rasteve të raportuara dhuna në familje ka ndodhur mes motrave e vëllezërve. Në 7% të rasteve të raportuara viktime është fëmija përkundrejt 8% të rasteve kur viktimë është prindi. Bazuar në të dhënat e rasteve të raportuara në polici për periudhën 2009-2011, në 81% të rasteve viktimat janë femra.

Tabela e mëposhtme (tabela 2) tregon rritjen e kërkesave për urdhër mbrojtjeje gjatë viteve.

TABELA 2	KËRKESAT PËR URDHËR MBROJTJEJE: VITI 2008 DERI NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË 2012-s PËR ÇDO QARK				
	2008	2009	2010	2011	Janar-Qershor 2012
Tiranë	249	415	393	467	233
Durrës	94	141	196	261	113
Elbasan	4	15	23	37	20
Vlorë	8	46	82	68	44
Berat	6	58	114	99	52
Fier	0	7	84	89	37
Gjirokastrë	2	7	34	35	22
Korçë	3	26	105	129	91
Shkodër	4	49	109	60	27
Lezhë	0	64	61	45	22
Dibër	3	6	16	34	26
Kukës	4	7	17	21	18
<b>TOTAL</b>	<b>377</b>	<b>841</b>	<b>1234</b>	<b>1345</b>	<b>705</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Sipas të dhënave të DPP-së për vitin 2011, nga 2181 raste të denoncuara të dhunës në familje, vetëm në 23 raste (1,1%) viktimat janë nga komuniteti rom dhe egjiptian. Ndërsa nga komuniteti LGBT nuk ka asnjë rast zyrtar të raportuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmon se gjatë vitit 2011 nga 518 kërkesa të reja me objekt "lëshim urdhër mbrojtjeje" (dhe 64 raste të mbartura), kjo gjykatë ka lëshuar 501 urdhra mbrojtjeje: 149 raste ose 28,8% janë pranuar, 334 raste ose 64,5% janë pushuar (mungesë provash, dokumentacioni apo nga vetë kërkuesi) dhe 18 raste ose 3,5% janë rrëzuar. Ndërkohë, 81 raste kanë qenë të papërfunduara.

Po kjo gjykatë për periudhën 01.01.2012-31.05.2012 ka marrë 211 kërkesa të reja për lëshim urdhër mbrojtjeje (dhe 72 kërkesa të mbartura), nga të cilat ka përfunduar 239 çështje: 78 janë pranuar, 155 janë pushuar dhe 6 janë rrëzuar.

Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjatë vitit 2011 janë procesuar 93 urdhra mbrojtjeje, nga të cilët 58 janë pranuar (62,4%), 27 raste janë pushuar (29%) dhe 8 raste janë rrëzuar (8,6%). Nga këto, në 79 raste paditësi ka qenë femër dhe në 14 raste mashkull. 57 raste janë të moshës 26-45 vjeç, 39 raste nga fshati.

Sipas MPÇSSHB-së dhe PSH-së, nga rastet e dhunës në familje ka 16-30 raste të tilla që përfundojnë në vrasje, sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme. Ndërkohë që numri i vrasjeve në familje përbën 17% deri 22% të numrit të përgjithshëm të viktimave të kësaj vepre penale.

TABELA 3	RASTET E DHUNËS NË FAMILJE DHE VRASJET: VITI 2008 DERI NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË 2012-s		
	Viti	Raste të denoncuara në polici	Vrasje
2008	822	22 raste	2,7%
2009	1217	16 raste	1,3%
2010	1998	20 raste	1,0%
2011	2181	30 raste	1,4%
Janar-Qershor 2012	1100	11 raste	1,0%

Burimi: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë



# ***KAPITULLI 2***

# **METODOLOGJIA**

## 2.1. OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Ky studim bazë ofron një panoramë të ecurisë në luftën kundër dhunës në familje, me qëllim që të ndihmojë në hartimin e fushave ku mund të ndërhyhet nga ana e Programit dhe të nxjerrë përfundime për të përmirësuar situatën.

Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë kapacitetet dhe aftësinë e Policisë së Shtetit për të ofruar shërbime për të adresuar, hetuar dhe zvogëluar rastet e dhunës në familje, si dhe shkallën e koordinimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë për trajtimin e përshtatshëm të rasteve të dhunës në familje.

Më konkretisht:

- Të identifikojë përhapjen e formave të dhunës në familje që ndodhin ose kanë ndodhur në zonat e zgjedhura gjeografike;
- Të identifikojë nevojat e policimit që lindin si rezultat i këtyre formave të dhunës në familje;
- Të identifikojë grupet veçanërisht të prekshme nga dhuna në familje;
- Të identifikojë pikat e forta dhe burimet e Policimit në Komunitet për të parandaluar, përgjigjur dhe hetuar rastet e dhunës në familje;
- Të hulumtojë qëndrimet sociale dhe kulturore që pengojnë raportimin e dhunës në familje dhe të ofrojë vlerësime mbi shkallën e dhunës në familje që nuk raportohet/denoncohet;
- Të identifikojë strategjitë e ndërhyrjes për parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje në bazë të pikave të forta, burimeve të Policimit në Komunitet dhe nevojave të viktimave.

## 2.2. VENDNDODHJA / MBULIMI

Studimi u krye në pesë qarqetë vendit (zona urbane dhe rurale):

- Tiranë
- Durrës
- Vlorë
- Korçë
- Shkodër

## 2.3. GRUPET NË FOKUSTË STUDIMIT

- Komuniteti (të rinjtë dhe të rriturit, banorë në zonat urbane e rurale)
- Grupet e marginalizuara: komuniteti rom, egjiptian dhe LGBT
- Viktimat e dhunës në familje
- Policia e shtetit
- Pushteti qendror
- Pushteti lokal
- Sistemi i Drejtësisë (Gjykata, Prokurori)
- Shoqëria civile dhe strehëzat, linjat e këshillimit.

## 2.4. METODOLOGJIA

Ky studim u hartua dhe zbatua sipas një përçasjeje metodologjike të kombinuar:

- a) rishikim dokumentacionesh e raportesh (desk research)
- b) studim cilësor
- c) studim sasior

Metodologjia e përdorur na jep mundësinë të kemi një kuptueshmëri më të thellë të gjendjes aktuale në aspektin e arsytimeve, perceptimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të komunitetit dhe aktorëve kryesorë dhe, në të njëjtën kohë, sasinë / volumin e këtyre rezultateve.

Metoda e përdorur për realizimin e studimit u hartua për të bërë të mundur përfshirjen e plotë në të, të gjitha grupeve të pafavorizuara, marginalizuara, minoriteteve dhe grupeve etnike. Perspektiva gjinore është ruajtur dhe trajtuar plotësisht, sikurse edhe të gjitha format e diversitetit.

Instituti "Data Centrum" si anëtar zyrtar i ESOMAR-it (Shoqata Evropiane për Sondazhe dhe Studime Marketingu) i bindet të gjithë dispozitave të Kodit Ndërkombëtar të Studimeve të Marketingut dhe atyre Sociale, si dhe zbaton standardet e përcaktuara nga ky organizëm për cilësinë e punës në terren.

### 2.4.1. Rishikim dokumentesh e raportesh

Kjo fazë e studimit u përqendrua në shqyrtimin e dokumenteve dhe strategjive zyrtare, raporteve ekzistuese, studimeve dhe të dhënave mbi fenomenin e dhunës në familje, si dhe përgjigjes zyrtare ndaj këtij fenomeni në Shqipëri.

### 2.4.2. Studimi cilësor

Faza cilësoreu fokusua në katër grupe kryesore:

- Komuniteti në zonat urbane e rurale: meshkuj dhe femra, të moshës 14-55 vjeç
- Grupet e marginalizuara: komuniteti rom, egjiptian dhe LGBT
- Viktimat e dhunës në familje
- Autoritetet dhe aktorët e tjerë:
  - Policia e Shtetit (DPP, DPQ dhe komisariatet),
  - Qeveria qendrore,
  - Qeveria lokale (Bashkitë),
  - Sistemi i drejtësisë (Gjykatat dhe Prokuroria),
  - OJF-të
  - Strehëzat dhe linjat e këshillimit, përfaqësuar nga specialistët që merren me dhunën në familje.

Në varësi të target-grupit u përzgjedh metoda që do të përdorej dhe çështjet për t'u vlerësuar. Mbledhja e të dhënave cilësore u realizua gjatë periudhës kohore 1-23 qershor 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet çështjet për vlerësim, metodën dhe madhësinë e kampionit për secilin grup që u përfshi në studim.



**TABELA 4**

**ÇËSHJTJET E VLERËSIMIT, METODA DHE KAMPIONI PËR GRUPIN PËRKATËS**

Grupi i përfshirë	Çështjet për vlerësim	Metoda e përdorur	Sinteza (madhësia e kampionit)
<p><b>Komuniteti në zonat urbane e rurale</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Perceptimi i komunitetit në lidhje me dhunën në familje: ashpërsia, përhapja, tendenca ndër vite, burimi i informacioneve dhe arsyet</li> <li>Përvoja personale mbi dhunën në familje: incidentet dhe procesi i raportimit</li> <li>Perceptimi në profilin e viktimave dhe dhunuesve</li> <li>Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi ligjet ekzistuese, autoritetet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë mbështetës, shërbimet për viktimat dhe dhunuesit.</li> <li>Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi rolin e policisë për dhunën në familje</li> <li>Vlerësimi i rolit të policisë mbi dhunën në familje: efikasiteti, kapacitetet, arsyet</li> <li>Eksperienca dhe kënaqësia me shërbimet policore në përgjithësi</li> <li>Sugjerimet e komunitetit: shërbimet për viktimat dhe dhunuesit, roli dhe bashkëpunimi i autoriteteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fokus grupe me komunitetin në zona urbane</li> <li>Intervista të thelluara me komunitetin në zona rurale</li> <li>Fokus grupe me grupe të marginalizuara (egjiptianët dhe romët)</li> </ul>	<p><b>Total: 14 fokus grupe dhe 15 intervista të thelluara</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>12 fokus grupe me komunitetin në zona urbane (14-55 vjeç; të realizuara veç me meshkuj dhe veç me femra)</li> <li>2 fokus grupe me komunitete vulnerabël (egjiptianët dhe romët)</li> <li>15 intervista të thelluara me komunitetin në zonat rurale (14-55 vjeç, meshkuj dhe femra)</li> </ul>
<p><b>Viktimat e dhunës në familje</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përvoja me dhunën në familje: lloji i dhunës, profili i dhunuesit, kohëzgjatja, arsyet, pasojat.</li> <li>Procesi i raportimit: Kush? Si? Kur? Kur?</li> <li>Vlerësimi i institucioneve të ndryshme: shërbimet e ofruara, sjellja e stafit, procedurat, bashkëpunimi i institucioneve</li> <li>Shkalla e kënaqësisë me autoritetet dhe shërbimet e marra</li> <li>Reagimi dhe pasojat për dhunuesit</li> <li>Roli i policisë: kontaktet me policinë, besimi, shërbimet e ofruara, kënaqësia me shërbimet, stafit, procedurat etj</li> <li>Vlerësimi i bashkëpunimit të policisë me autoritetet e tjera për rastin specifik.</li> <li>Vlerësimi i kapaciteteve të policisë &amp; efikasiteti për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje.</li> <li>Sugjerimet e viktimave të dhunës në familje në aspektin e ligjeve dhe zbatimit, shërbimet për viktimat dhe dhunuesit, roli i autoriteteve dhe bashkëpunimi i tyre, stafit, procedurat etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Intervista të thelluara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>12 intervista të thelluara me viktimat e dhunës në familje</b></li> </ul>

<p><b>Autoritetet dhe aktorët e tjerë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura përgjegjëse për dhunën në familje, roli, stafi dhe linja e raportimit brenda institucionit.</li> <li>• Struktura/stafi i veçantë që merret me rasteteviktimave me profile të ndryshme në drejtim të gjinisë, moshës, statusit të shëndetit mendor, orientimit seksual dhe grupeve të tjera të marginalizuara.</li> <li>• Përvoja dhe statistika mbi fenomenin e dhunës në familje, ndërjegjësimit të komunitetit, raportimit etj.</li> <li>• Shërbime direkte dhe aktivitete mbështetëse të parashikuara.</li> <li>• Bashkëpunimi mes institucioneve: me kë, si, vlerësimi dhe arsyet.</li> <li>• Analiza e situatës aktuale (pikat e forta dhe të dobëta, nevojat, sugjerime për përmirësim) në lidhje me <ul style="list-style-type: none"> <li>o legjislacionin dhe zbatimin,</li> <li>o shërbimet për viktimat dhe dhunuesit,</li> <li>o bashkëpunimin ndër-institucional</li> </ul> </li> <li>• Fokus i veçantë mbi policinë: roli, stafi, kapacitetet, efikasiteti, bashkëpunimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Intervista të thelluara me autoritetet</li> <li>• Grupe diskutimi me OJF-të dhe punonjësit e policisë</li> </ul>	<p><b>Total: 35 intervista të thelluara dhe 2 grupe diskutimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 14 intervista të thelluara me Policinë e Shtetit* në nivele të ndryshme</li> <li>• 3 intervista të thelluara me pushtetin qendror</li> <li>• 4 intervista të thelluara me pushtetin vendor</li> <li>• 5 intervista të thelluara me sistemin e drejtësisë</li> <li>• 9 intervista të thelluara me shoqërinë civile, strehëzat dhe linjat e këshillimit**</li> <li>• 1 grup diskutimi me punonjësit e policisë* që punojnë me dhunën në familje</li> <li>• 1 grup diskutimi me OJF-të dhe organizatat që operojnë në Tiranë dhe Durrës**</li> </ul>
---	---	---	--

\*Për detaje, ju lutem shihni Shtojcë B

\*\* Për detaje, ju lutem shihni Shtojcën A

## Instrumentet Cilësore

“Data Centrum” ka përpiluar instrumente cilësore të posaçme për secilin grup të përfshirë në studim dhe metodën përkatëse: udhërrëfyes për fokus grupet me komunitetin urban, udhërrëfyes për intervistat pjesërisht të strukturuara për të intervistuar komunitetin rural, viktimat, OJF-të, dhe autoritetet.

Të gjitha instrumentet përfundimtare u miratuan nga EMP-ja dhe PSH-ja.

## Detajet teknike të studimit cilësor

Ekipi i përzgjedhur për studimin cilësor u trajnuar dhe mori udhëzime specifike përpara fillimit të punës. Trajnimi i realizuar përfshiu qëllimin dhe temat e studimit, përkufizimet kryesore mbi dhunën në familje, autoritetet përgjegjëse dhe shërbimet e ofruara sipas ligjit shqiptar, procedurat e kërkimit dhe aspektet etike për intervistimin e viktimave të dhunës.

Të gjitha fokus grupet dhe intervistat e thelluara u kryen nga moderatorë profesionistë me përvojë në fushën e studimeve cilësore, me mbështetjen edhe të asistentëve. Vëmendje e veçantë iu kushtua intervistave të thelluara me viktimat e dhunës në familje, të cilët u intervistuan nga psikologë me përvojë, në përputhje me të gjitha rregullat etike.

Çdo grup diskutimi zgjati mesatarisht 2 orë, ndërsa intervistat e thelluara zgjatën për afërsisht 1.2 orë.

Me të gjithë pjesëmarrësit në studim u aplikuan procedurat standarde të marrjes së lejes përpara intervistimit.

“Data Centrum” ka krijuar një bazë të dhënash, e cila përditësohet vazhdimisht dhe përdoret për të kontrolluar specifikimet e rekrutimit të çdo projekti, në mënyrë që standardet në vijim të plotësohen nga çdo pjesëmarrës:

- Nuk ka pjesëmarrje të mëparshme gjatë 6 muajve të fundit.
- Nuk ka pjesëmarrje më shumë se 3 herë në total.
- Nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në fusha të ngjashme.

Gjatë procesit të rekrutimit u respektuan rigorozisht rregullat e ESOMAR-it.

### 2.4.3. Studimi sasior

Faza sasore u realizua në formën e intervistave ballë për ballë (F2F) në banesën e të anketuarve. Intervistat me stilolaps dhe letër (PAPI) u administruan duke përdorur një pyetësor të strukturuar dhe karta për pyetje specifike. Mbledhja e të dhënave u realizua në periudhën 5-13 qershor 2012. Profili i të anketuarve gjatë kësaj faze ishte: meshkuj dhe femra, 14-65 vjeç, banorë të Shqipërisë në zonat urbane dhe rurale të 5 qarqeve, të cilët nuk punojnë në sektorë specifikë, si: kërkime, shërbime sociale, polici, media, drejtësi.

“Data Centrum” përdori një kampionim të shtresëzuar në disa nivele:

- Përzgjedhja e zonës (qytet/fshat)
- Përzgjedhja e pikave të nisjes
- 1 në 3 familje
- Përzgjedhja e të anketuarve sipas karakteristikave specifike të lartpërmendura.

## Madhësia e kampionit &amp; shpërndarja

<b>TABELA 5 KARAKTERISTIKAT E TË ANKETUARVE</b>				
		<b>Faktori peshues</b>	<b>Kampion i peshuar</b>	<b>Kampioni real</b>
	<b>Total</b>	1.000	570	570
<b>Qarku</b>	Tiranë	1.000	250	250
	Durrës	1.000	80	80
	Vlorë	1.000	80	80
	Korçë	1.000	80	80
	Shkodër	1.000	80	80
<b>Vendbanimi</b>	Urban	0.997	286	285
	Rural	1.004	284	285
<b>Mosha</b>	<b>Të rinj (14-24 vjeç)</b>	0.891	196	220
	14-24 vjeç	0.891	196	220
	<b>Të rritur (25-65 vjeç)</b>	0.936	374	350
	25-35 vjeç	1.068	94	88
	36-45 vjeç	1.063	84	79
	46-55 vjeç	1.074	102	95
	56-65 vjeç	1.068	94	88
<b>Gjinia</b>	Femra	1.000	285	285
	Meshkuj	1.000	285	285

Faktorët peshues u përdorën për të transformuar shpërndarjen e kampionit aktual vetëm në drejtim të moshës dhe vendbanimit, sipas shpërndarjes reale të popullsisë.

## Instrumentet Sasiore

Pyetësi u hartua duke synuar mbledhjen e informacioneve mbi ndërgjegjësimin, perceptimet, qëndrimet, sjelljet dhe përvojat e të anketuarve mbi dhunën në familje, duke theksuar pikëpamjet mbi rolin e policisë.

Pyetësi përmban shtatë seksione, sikurse të përshkruara në vijim së bashku edhe me nëntemat përkatëse në çdo seksion:

1. **Pyetje filtruese** për t'u siguruar që është pyetur i duhur (mosha, gjinia, sektori i punësimit dhe vendbanimi)
2. **Opinion mbi situatën aktuale** (problemet kryesore në vend, në zonën e tyre, marrëdhënie familjare në të shkuarën përkundrejt së tashmes dhe pritshmëritë për të ardhmen)
3. **Ndërgjegjësimi dhe qëndrimet mbi dhunën në familje** (ndërgjegjësimi, burimi i informacionit, perceptimi mbi përhapjen e fenomenit, përvojat e rrethit personal, pranimi, qëndrimet ndaj dhunës në familje)
4. **Përgjigja zyrtare ndaj dhunës në familje** (ndërgjegjësimi mbi ligjet, autoritetet dhe shërbimet në vend)
5. **Policia** (opinione të përgjithshme dhe niveli i kënaqësisë me punën e policisë; policia dhe dhuna në familje: roli, efikasiteti, bashkëpunimi me institucionet e tjera, kënaqësia)
6. **Sugjerime**
7. **Përvoja personale me dhunën në familje** (lloji i dhunës në familje, shkalla e dhunës, raportimi, shërbimet e marra dhe kënaqësia me policinë, arsyet që nuk raportojnë, qëllimet për të raportuar në të ardhmen)
8. **Demografike** (arsimi, statusi civil, anëtarë në familje, fëmijët, statusi i punësimit, minoritetet)

Para finalizimit të instrumentit dhe nisjes së punës në terren u zhvillua një fazë pilotimi për të testuar funksionimin dhe shkallën e kuptueshmërisë së pyetësit.

Pyetësi përfundimtar u miratua nga EMP-ja dhe PSH-ja.

## Detajet teknike të studimit sasior

“Data Centrum” përzgjedhi dhe trajnoi me kujdes një ekip prej 14 anketuesish me përvojë në administrimin e studimeve sasiore për të kryer intervistat, dy mbikëqyrës terreni me përvojë për të drejtuar dhe monitoruar anketuesit dhe menaxherin e terrenit që siguron se të gjitha udhëzimet dhe shpërndarjet zbatohen siç duhet. Ky ekip u mbështet drejtpërdrejt nga udhëheqësi dhe asistenti i projektit.

I gjithë ekipi u trajnua posaçërisht për procedurën dhe pyetësin e këtij studimi. Dita e parë e trajnimit u organizua para fazës së pilotimit, ndërsa dita e dytë e trajnimit pas fazës së pilotimit/para punës në terren. Trajnimi përfshiu qëllimin dhe temat e këtij studimi, përkufizimet kryesore mbi dhunën në familje, autoritetet përgjegjëse dhe shërbimet e ofruara sipas ligjit shqiptar, kampionin dhe procedurat, si dhe aspektet etike për intervistimin e të rinjve dhe viktimave të mundshme të dhunës.

Puna në terren u organizua me grupe të vogla anketuesish, gjithmonë të koordinuar dhe monitoruar nga mbikëqyrësi i terrenit.

Kohëzgjatja mesatare e një interviste ishte 25 minuta.

## Kontrolli

Procedurat e kontrollit të të gjitha projekteve sasiore të kryera nga “Data Centrum” janë të bazuara në kërkesat e inspektimit të përcaktuara nga ESOMAR-i.

Metodat e zbatuara të kontrollit janë si më poshtë:

- Të paktën 25% e punës së secilit anketues u kontrollua direkt në vend nga mbikëqyrësi i terrenit, për të

siguruar respektimin e të gjitha procedurave dhe udhëzimeve për realizimin e intervistës, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kampionit të përcaktuara nga "Data Centrum". Kontrolliu realizua gjatë gjithë punës së secilit anketues.

- Pyetëtorët e parë të të gjithë anketuesve u kontrolluan nga mbikëqyrësi i terrenit, asistenti i projektit dhe menaxheri i terrenit, në mënyrë që të vlerësohej kuptueshmëria e pyetjeve dhe saktësia e mbledhjes së të dhënave.

### **Sigurimi i cilësisë së punës**

Të gjithë anketuesit ishin femra, bazuar në faktin që dhuna në familje është një fenomen me bazë gjinore. Në këtë mënyrë siguroam që femrat dhe të rinjtë të ndihen më të lirshëm për të treguar përvojat personale me dhunën në familje, si dhe mendimin e tyre mbi autoritetet.

Nga të anketuarit nuk u mbledhën të dhëna personale, si: emri, adresa e shtëpisë ose numri i telefonit.

Të gjithë të anketuarve iu bë e ditur se përgjigjet e tyre do të mbeteshin plotësisht anonime dhe të fshehta, duke u përpunuar statistikisht.

Mbikëqyrësi i terrenit, menaxheri i terrenit dhe asistenti i projektit kanë monitoruar vazhdimisht punën e anketuesve dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura. Të gjitha rezultatet e këtij kontrolli qenë të kënaqshme.

### **Përpunimi dhe analizimi i të dhënave**

Pas kontrollit fizik të pyetësorëve, hedhja e të dhënave u realizua nga operatorë me përvojë duke përdorur një program të veçantë (Quantum). Programi i hedhjes së të dhënave "Quantum" ofron kontroll elektronik në filtra dhe rangun e vlerave në nivelin 100% për të ofruar përfundimisht të dhëna të pastra. Kjo procedurë u mbikëqyr nga menaxheri i prodhimit të të dhënave të "Data Centrum"-it. Baza me të dhëna të pastra u përdor për të prodhuar tabela statistikore dhe realizuar analizën e të dhënave.

### **Niveli i përgjigjes**

Sipas praktikës së "Data Centrum"-it, u përdor një formular itinerari për regjistrimin e të gjitha kontakteve që çdo anketues ka kryer gjatë punës së tij për të realizuar intervistat.

Në mënyrë që të arriheshin 570 intervista të suksesshme, u kontaktua një total prej 1379 personash. Në 473 raste nuk kishte njeri në shtëpi (34.3%), në 196 raste personat refuzuan të marrin pjesë (14.2%), dhe 140 raste nuk kishin profil të përshtatshëm për shkak të specifikimeve të paracaktuara (10.2%). Pra, niveli i përgjigjes është 41.3%.

### **Vlefshmëria**

Studimi përqipet të përfshijë të gjitha temat e rëndësishme që lidhen me dhunën në familje dhe rolin e policisë, me qëllim që të sigurojë vlefshmërinë e përmbajtjes. Për më tepër, të dhënat janë mbledhur me saktësi të lartë dhe në kushte të përshtatshme, me pjesëmarrjen vullentare të të anketuarve, dhe motivimin e profesionalizmin e plotë të anketuesve. Të gjitha të dhënat janë pastruar dhe peshuar para se të analizohen.

Gabimi statistikor:  $\pm 4.19\%$  (në nivelin  $2\sigma$ )

Bazat e vogla: deri në 50 janë vetëm indikative

Më tej, tabelat përmbajnë një (\*) në qoftë se numri i të anketuarve në grup është i vogël ( $n < 50$ ). Në këtë rast përqindjet duhet të interpretohen me shumë kujdes, sepse luhatjet rastësore në përbërjen e kampionit mund të kenë një ndikim të madh në shpërndarjen e kategorive të përgjigjeve nga kampioni.

#### **2.4.4. Kufizimet e studimit**

Në përgatitjen e këtij raporti autorët janë të ndërgjegjshëm se ka disa kufizime:

- Studimi ka mbuluar 5 nga 12 qarqet e vendit
- Madhësia e kampionit në ndarje të ndryshme të popullsisë ka besueshmëri të kufizuar për shkak të

numrit të vogël të popullsisë në këto ndarje / qeliza.

- Mungesa e studimeve të mëparshme me fokus specifik rolin e policisë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për dhunën në familje.
- Përdorimi kufizuar i dokumentacioneve dhe statistikave zyrtare p.sh.:ende nuk ka të dhëna të publikuara për grupmoshat nga Census 2011 Shqipëri.
- Vështirësi në qasjen e institucioneve dhe njerëzve, sidomos viktimat e dhunës në familje.

Rekomandojmë zhvillimin e studimeve të mëtejshme në të gjithë vendin (mbulim kombëtar) me qëllim plotësimin e punës aktuale të "Data Centrum"-it.

# ***KAPITULLI 3***

# **REZULTATET**



Ky kapitull paraqet analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore të mbledhura nga të gjitha grupet e përfshira në studim.

Rezultatet sasiore nga komuniteti i zonave urbane dhe rurale të qarkut të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës do të paraqiten në total dhe më tej të dhënat do të analizohen e paraqiten sipas grupmoshës (por jo vetëm). Në kontekstin e këtij studimi duam të qartësojmë se “të rinjtë” i referohet grupmoshës 14-24 vjeç dhe “të rriturit” i referohet grupmoshës 25-65 vjeç.

Vini re: Të dhënat në tabela paraqesin përqindjet (%) e përgjigjeve të dhëna për bazat përkatëse.

### 3.1. DHUNA NË FAMILJE

#### 3.1.1. Perceptimi i komunitetit mbi dhunën në familje

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nga komuniteti urban dhe rural janë në dijeni dhe përmendin në mënyrë të vetvetishme forma të ndryshme të dhunës në familje, si: izolimin nga miqtë, shkolla dhe/ose puna, mohimin e mundësisë për mbështetje ekonomike, kërcënimet për dëmtim fizik, kritikën e vazhdueshme, poshtërimin, pabarazinë gjinore, moslejimin e grave të punojnë, shpullat, gjuajtjet, vrasjet, vetëvrasjet për shkak të xhelozisë ose dhunës së vazhdueshme fizike, shfrytëzimin e fëmijëve - punësimin e tyre, fëmijët e rrugës (veçanërisht e përhapur në komunitetin rom), abuzimin seksual, braktisjen, lënien pas dore të fëmijëve, shkeljen e të drejtave të njeriut, kontrollin e mjeteve financiare etj.

Më tej, pjesëmarrësit e grupmoshës 14 - 35 vjeç e konsiderojnë edhe dhunën midis partnerëve intimë / të dashurve (pra, mes çifteve që nuk janë në martesë apo bashkëjetesë) si një formë të dhunës në familje.

#### 3.1.2. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi dhunën në familje dhe burimi i informacionit

Të gjithë të anketuarit janë të njohur me fenomenin e dhunës në familje dhe burimet kryesore të informacionit mbi këtë çështje janë: televizioni (99.7%), rrethi shoqëror (53.6%), rrethi familjar (45.3%) dhe shtypi i shkruar (45.8%).

Ka disa ndryshime midis të rinjve dhe të rriturve. Të rinjtë janë më aktivë në përdorimin e internetit (45.9 %) dhe librave (23.6%). Shumica e tyre janë nxënës dhe studentë, ndaj edhe shkolla është një burim tjetër i rëndësishëm informimi (37.3%). Ndërkohë, të rriturit ndajnë më shumë informacion për çështjet e dhunës në familje në rrethin e tyre personal (me miqtë 56%, me rrethin familjar 46.9%) dhe në vendin e punës (16.9%).

<b>TABELA 6</b> <b>BURIM I INFORMACIONIT MBI DHUNËN NË FAMILJE</b>	<b>Totali</b> <b>(n=570)</b>	<b>Të rinjtë</b> <b>(n=196)</b>	<b>Të rriturit</b> <b>(n=374)</b>
Televizioni	99.7	99.5	99.7
Miqtë	53.6	49.1	56.0
Revistat, gazetatat	45.8	53.6	41.7
Rrethi familjar	45.3	42.3	46.9
Interneti	22.7	45.9	10.6
Radio	22.6	26.4	20.6
Shkolla	15.6	37.3	4.3
Librat	14.5	23.6	9.7
Vendi i punës	13.4	6.8	16.9
Vendet e tjera (kinema etj.)	3.9	6.0	2.5

Nuk ka dallime domethënëse statistikore në burimin e informacionit midis meshkujve e femrave. Dallimet mes banorëve të qarqeve të ndryshme janë të vogla: më shumë të anketuar banues në qarkun e Korçës dhe Shkodrës deklarojnë se marrin informacion mbi dhunën në familje përmes radios dhe më pak përmes internetit krahasuar me ata në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Vlorës.

### 3.1.3. Perceptimi mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje

Pothuajse gjysma e të anketuarve shprehen se dhuna në familje është shumë e përhapur në vend.

<b>TABELA 7 SA E PËRHAPUR MENDONI SE ËSHTË FENOMENI I DHF-së NË SHQIPËRI?</b>	<b>Shumë i përhapur</b>	<b>Disi i përhapur</b>	<b>Pak i përhapur</b>	<b>Aspak i përhapur</b>
Totali (n=570)	51.4	38.9	9.0	0.5
Të rinjtë (n=196)	48.2	41.8	8.6	1.4
Të rriturit (n=374)	53.1	37.4	9.1	0
Meshkuj (n=285)	49.9	39.0	9.8	0.9
Femra (n=285)	53.0	38.9	8.1	0
Zona urbane (n=286)	55.7	34.3	9.7	0.3
Zona rurale (n=284)	47.1	43.6	8.3	0.6

Analiza e të dhënave cilësore tregon se mentaliteti patriarkal, superioriteti i meshkujve, diskriminimi gjinor brenda familjes së bashku me gjendjen e dobët ekonomike dhe financiare, presionin e vazhdueshëm të rritjes së çmimeve, nivelin e ulët të punësimit, kërkesave gjithnjë në rritje nga fëmijët, varësia nga alkooli dhe drogat, bixhozi / kumari, xhelozia, gjendja e shëndetit mendor, mungesa e aftësive të duhura të prindërimit gjatë rritjes dhe edukimit të fëmijëve, komunikimi i varfër mes anëtarëve të familjes janë disa nga arsyet më kryesore pse dhuna në familje është një fenomen kaq i përhapur. Për më tepër, moszbatimi i duhur i ligjit konsiderohet si një faktor nxitës për këtë fenomen.

*“Meshkujt dominojnë, burri ka të drejtën t’i gjuajë gruas dhe fëmijëve – ky është mentaliteti i burrave”. (Vajzë, 17 vjeçe, Tirana urbane)*

*“Jemi një vend me zakone e doke të forta. Po, dhuna mes anëtarëve të familjes eksizton, sepse ne kemi stereotipe të trashëguara dhe që ushqehen që herët brenda familjeve tona”. (Mashkull 25-35 vjeç, Tirana urbane)*

*“Mospasja i bën të tëra ... fëmijët duan më shumë... po edhe këto nuset e sotme nuk dinë se ç’duan. E kështu ndodhin gjithë këto raste me dhunë në familje dhe divorce, shumë divorce” (Femër, komuniteti rom)*

Gati dyfishi i të anketuarve të qarkut të Durrësit (30%) krahasuar me Tiranën (12.6%), Korçën (15.1%) dhe Shkodrën (17.6%) deklarojnë se dhuna në familje është shumë e përhapur në zonën e tyre.

<b>TABELA 8</b> <b>SA E PËRHAPUR MENDONI SE ËSHTË FENOMENI I DHF-së NË ZONËN TUAJ?</b>	<b>Tiranë (n=250)</b>	<b>Durrës (n=80)</b>	<b>Vlorë (n=80)</b>	<b>Korcë (n=80)</b>	<b>Shkodër (n=80)</b>
Shumë e përhapur	12.6	30.0	22.7	15.1	17.6
Disi e përhapur	38.4	39.8	33.8	41.3	39.8
Pak e përhapur	39.1	24.0	36.2	34.9	36.2
Aspak e përhapur	7.6	3.6	3.8	7.6	5.1
Nuk e di	2.4	2.7	3.6	1.1	1.3

*“Dhuna në familje në zonën tonë është pothuajse e përditshme. Gjatë viteve të fundit është rritur edhe më shumë për shkak të stresit dhe problemetë mëdha ekonomike që hasin familjet”. (Mashkull, 51 vjeç, Shkodra rurale)*

*“Dëgjojmë çdo ditë në lajme ose kur bëjmë muhabet me njëra-tjetrën... njëri rrahu gruan, çifte që divorcohen për shkak të xhelozisë...”. (Femër, 32 vjeçe, Durrësi rural)*

Më shumë se 1 në 2 të anketuar deklarojnë se njohin dikë në rrethin e tyre personal (shoqëror e familjar) ose në lagjen e tyre që ka përfjetuar të paktën një formë të dhunës në familje.

Nëse krahasojmë deklaratat e viktimave të dhunës me totalin e të anketuarve, do të vëmë re se viktimat njohin më shumë raste të dhunuarish në familje që i përkasin rrethit të tyre personal ose fqinjëve.

Pjesëmarrësit, anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, deklarojnë se dhuna në familje është një fenomen mbarëshoqëror, dhe jo specifikisht më i përhapur mes tyre. Problemet ekonomike dhe xhelozia u përmendën si dy faktorët kryesorë të situatave të dhunshme brenda familjeve të tyre.

<b>TABELA 9</b> <b>NJIHNI DIKË QË KA QENË VIKTIMË E NDONJËRËS PREJ FORMAVE TË DHF-së</b>	<b>Totali (n=570)</b>	<b>Viktimat e dhunës në familje (n=254)</b>
Në vendin ku punoni apo studioni	35.9 %	41.7%
Në pallatin / lagjen tuaj	55.5%	66.4%
Në rrethin tuaj miqësor/ shoqëror apo familjar	56.8%	70.4%

Gjatë diskutimeve në fokusgrupe dhe intervistat e thelluara pothuaj të gjithë pjesëmarrësit treguan raste konkrete të dhunës në familje, raste që u kishin ndodhur fqinjëve, miqve, kolegëve apo të afërmeve të tyre.

*“Në lagjen time ka shumë familje të varfra. Kemi një komshi 59 vjeç, me shkollë fillore, i papunë, që e rreh gruan dhe vajzën e vet adoleshente çdo ditë. E rreh gruan se ajo s’ka gatuar gjë (se s’ka ç’të gatujë) dhe vajzën se asaj i duhen para për të shkuar në shkollë. Disa herë babai im ka provuar t’ia heqë vajzën prej duarsh dhe mami ka marrë në telefon policinë. Policia e mban një natë burrin dhetë nesërmen ai vjen prapë në shtëpi. Punë pa bërëqet...” (Femër, 19-24 vjeçe, Tirana urbane)*


*“Jam vetë person që dhunohem nga burri. Nëna ime, edhe pse është 70 vjeçe, është rrahur në mënyrë barbare nga babai im dhe të afërmit që kemi përreth” (Femër, 25-35 vjeçe, Vlora rurale)*

*“Po, jam në dijeni të këtyre rasteve, edhe brenda familjes, edhe në rrethin shoqëror. Por nuk kam dëshirë t’i them konkretisht.” (Mashkull 36-55vjeç, Shkodra rurale)*

### 3.1.4. Qëndrimet ndaj dhunës në familje

Shumica e të anketuarve (67.5%) e konsiderojnë dhunën në familje si të papranueshme pavarësisht rrethanave, ndërkohë 3 nga 10 të anketuar e shohin si të pranueshme në rrethana të caktuara. Vetëm 2.1% e tyre deklarojnë se dhuna në familje është gjithmonë e pranueshme.

71.4% e të rinjve përkundrejt 65.4% e të rriturve e shohin dhunën në familje si të papranueshme pavarësisht rrethanave.



*"Është njerëzore të shprehesh. Ndaj edhe s'është e thjeshtë ta dallosh dhunën emocionale apo atë psikologjike. S'e marrim seriozisht..." (Mashkull, 25-35 vjeç, Tirana urbane)*

*"Forma më e papranueshme, e patolerueshme është dhuna fizike dhe ajo seksuale" (Femër, 19-24 vjeç, Korça rurale)*

*"Është mëse e zakonshme t'u japësh ca shpulla kalamajve. Një dru i mirë të edukon. Jemi mësuar me këtë gjë, e bëjmë edhe vetë tani që jemi bërë me fëmijë". (Mashkull, 25-35 vjeç, Durrësi rural)*

*"Epo zërin do ta ngremë, se s'ka shtëpi pa debate. Po druri dhe vrasjet në familje janë vërtet serioze, të patolerueshme" (Femër, komuniteti rom)*


Diskutimet e thelluara zbuluan se abuzimi emocional dhe psikologjik shihen si format më të shpeshta dhe më të pranueshme të dhunës në familje, pasi pasojat e tyre janë më pak të dukshme.

Dhuna në familje ndaj fëmijëve (e bërtitura, përdorimi i nofkave, shpullat, tërheqja e veshit, kërcënimet etj.) konsiderohet përgjithësisht e pranueshme duke argumentuar se kjo është në të mirë të fëmijës dhe edukuese për të.

Dhuna në familje ndaj gruas konsiderohet si e rrënjësuar thellë në mentalitetin mashkullor të popullatës. Pjesëmarrëset femra e përmendin këtë si një fakt të papëlqyeshëm dhe acarues, ndërsa meshkujt janë kryesisht përshkrues, pa u shprehur haptazi nëse kjo është e pranueshme apo jo.


Ka disa ndryshime të vogla midis gjinive dhe banorëve në zonat urbane e rurale mbi pranueshmërinë e dhunës në familje. 2.7% e meshkujve deklarojnë se dhuna në familje është e pranueshme në çfarëdo rrethane përkundrejt 1.4% të grave që e deklarojnë këtë. 71% e të anketuarve banorë në zonat urbane përkundrejt 63.9% të atyre në zonat rurale e konsiderojnë dhunën në familje si të papranueshme pavarësisht rrethanave.

**GRAFIKU 3  
PRANUESHMËRIA E DHUNËS NË FAMILJE  
GJINIA & VENDBANIMI**



Kur pyeten nëse dhunuesit duhen dënuar, 67.3% e të anketuarve përgjigjen se dhunuesit duhen dënuar gjithmonë. Ky qëndrim është më i lartë tek ata që banojnë në zonat urbane. 1.8% e të anketuarve që jetojnë në zonat rurale deklarojnë se dhunuesit nuk duhen ndëshkuar në asnjë rrethanë.

**GRAFIKU 4  
QËNDRIMI NDAJ NDËSHKIMIT TË DHUNUESIT**



Gjatë diskutimeve të thelluara pjesëmarrësit pohojnë se dhunuesit duhet të ndëshkohen dhe burgosen në varësi të shkallës së ashpërsisë së dhunës. Ata sugjerojnë edhe masa mbështetëse për dhunuesit, pasi pjesa më e madhe e tyre përshkruhen si persona të varur nga alkooli, droga ose me probleme të shëndetit mendor. Masat mbështetëse të sugjeruara nga pjesëmarrësit janë: programe rehabilitimi, këshillim psikologjik, terapi në grup, mundësi punësimi dhe mbështetje nga vetë komuniteti që i rrethon.

Të anketuarve iu lexuan disa pohime mbi dhunën në familje dhe iu kërkua që të shprehnin nëse ishin dakord apo jo me secilin prej pohimeve.

83% e të anketuarve besojnë se problemet duhet të zgjidhen duke diskutuar me njëri-tjetrin, dhe jo me dhunë. Gati gjysma e të anketuarve besojnë se dhuna në familje është një fenomen që mund të ndodhë në çdo familje.

<b>TABELA 10 QËNDRIMET NDAJ DHUNËS NË FAMILJE</b>	<b>Shumë dakord</b>	<b>Disi dakord</b>	<b>Paksa dakord</b>	<b>Aspak dakord</b>
Dhuna në familje është një fenomen që mund të ndodhë në çdo familje	48.8	33.4	11.8	6.0
Për hir të familjes viktimat/të dhunuarit duhet t'i falin autorët	17.5	37.5	26.5	17.8
Dhuna në familje varet nga karakteri i anëtarëve të familjes	51.4	28.8	16.9	2.5
Problemet duhet të zgjidhen duke diskutuar, dhe jo me dhunë	83.0	11.4	5.6	0.0


### 3.1.5. Përvoja personale: format e dhunës në familje

44.5% e 570 të anketuarve në të pesë qarqet deklarojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje. Më pak se 1% e të anketuarve refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

54.1% e femrave përkundrejt 34.9% e meshkujve të këtyre të anketuarve (që janë të moshës 14-65 vjeç) pohojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje. Nuk ka ndryshime statistikisht domethënëse midis femrave të reja (14-24 vjeç) dhe femrave të rritura (25-65 vjeç) mbi përjetimin e dhunës në familje (përkatësisht 52.7% kundrejt 54.9%) në krahasim me meshkujt e rinj dhe meshkujt e rritur që kanë ndryshime domethënëse mes tyre (përkatësisht 43.6% kundrejt 30.3%).

Ka ndryshime të dukshme midis qarqeve në lidhje me nivelin e përjetimit të dhunës në familje, sikurse deklarojnë: 62% në Durrës, 49.1% në Vlorë, 48.9% në Tiranë, 32.5% në Shkodër dhe 20.9% në Korçë.

Nuk ka ndryshime statistikisht domethënëse midis zonave urbane dhe atyre rurale (përkatësisht 42.7% kundrejt 46.3%).



Bazuar në totalin e të anketuarve, 41.6% e tyre kanë përjetuar abuzim emocional, 16.9% abuzim psikologjik, 6.2% dhunë fizike dhe vetëm 0.4% dhunë seksuale.

E thënë ndryshe, duke u bazuar vetëm tek të anketuarit që kanë deklaruar se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje (n=254): 93.3% e tyre kanë përjetuar abuzim emocional, 38.2% abuzim psikologjik, 14.2% dhunë fizike dhe vetëm 0.8% dhunë seksuale.


Pra, shohim se dhuna pësohet në disa forma. Viktimat e dhunës në familje kanë përjetuar mesatarisht 1.5 forma të dhunës në familje.

Diferenca midis të rinjve dhe të rriturve që kanë përjetuar abuzim psikologjik është statistikisht domethënëse: përkatësisht 26.4% kundrejt 12%.

Nga diskutimet e thelluara rezultojnë se të rinjtë pohojnë që prindërit nuk i lejojnë të shprehin lirshëm mendimet

e tyre, u flasin në një mënyrë që i bën të ndihen keq ose të pavlerë, këmbëngulin të dinë se ku gjendet i riu / e reja gjatë gjithë kohës, nuk i lejojnë të kenë marrëdhënie dashurore, të dalin në mbrëmje, adoleshentet femra të kenë shokë etj.

Si të rriturit, ashtu edhe të rinjtë viktime të dhunës në familje kanë përjetuar disa forma të dhunës në familje. Të rinjtë kanë një mesatare prej 1,6 përkundrejt të rriturve me një mesatare 1,4 forma dhune të përjetuara në marrëdhëniet familjare.



Ka ndryshime midis meshkujve të rinj dhe femrave të reja, si dhe meshkujve e femrave të rritura në nivelin e përjetimit të formave të ndryshme të dhunës në familje.

Abuzimi emocional ndodh dy herë më shumë mbi femrat e rritura sesa mbi meshkujt e rritur (përkatësisht 54.3% kundrejt 26.9%), ndërkohë që dhuna fizike ndodh pothuaj 4 herë më shumë mbi femrat e rritura sesa mbi meshkujt e rritur (përkatësisht 9.1% kundrejt 2.3%).

Nuk ka pothuaj asnjë diferencë në përjetimin e abuzimit psikologjik dhe dhunës fizike nga meshkuj dhe vajzat e moshës 14-24 vjeç. Gati 4 nga 10 meshkuj të rinj kanë përjetuar abuzim emocional përkundrejt 5 nga 10 femra të reja.

PËRVOJA PERSONALE ME LLOJET E NDRYSHME TË DHUNËS NË FAMILJE: TË RINJTË PËRKUNDREJT TË RITURVE	Femra		Meshkuj	
	Të rejat	Të rriturat	Të rinjtë	Të rriturit
Abuzimi emocional	48.2%	54.3%	39.1%	26.9%
Abuzimi psikologjik	28.2%	13.7%	24.5%	10.3%
Dhuna fizike	7.3%	9.1%	7.3%	2.3%
Dhuna seksuale	-	0.6%	-	0.6%
Asnjë formë abuzimi	46.4%	44.0%	55.5%	69.7%

Gjetjet cilësore tregojnë se dhuna në familje nuk është vetëm e mbivendosur, e shumëfishtë, por edhe një fenomen i përsëritur dhe i zgjatur në kohë, që përjetohet ndër vite nga viktimat e saj.

### 3.1.6. Profili i viktimave të dhunës në familje

44.5% e popullatës midis moshës 14 dhe 65-vjeçare në qarkun e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës ka përjetuar të paktën një formë të dhunës në familje. Këto subjekte janë të shpërndara në grupmosha të ndryshme, ndërkohë që mesatarja e moshës së tyre është 33.5 vjeç.

6 nga 10 viktimat të dhunës në familje janë femra dhe pothuaj po kaq janë të martuar.

Viktimat jetojnë në familje me një mesatare prej 4.6 anëtarësh dhe me të ardhura mujore mesatare prej 37,015 lekësh në muaj.

1 në 20 viktimat e deklaruar të dhunës në familje iu përkasin minoriteteve.

<b>TABELA 12 PROFILI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE</b>		<b>n=254</b>
		në %
<b>MOSHA</b>	14-18 vjeç	18.2
	19-24 vjeç	18.9
	25-35 vjeç	19.8
	36-45 vjeç	18.6
	46-55 vjeç	15.2
	56-65 vjeç	9.3
	Mosha mesatare e viktimave	33.5 vjeç
<b>GJINIA</b>	Femra	60.8
	Meshkuj	39.2
<b>VENDBANIMI</b>	Urban	48.2
	Rural	51.8
<b>ARSIMI</b>	Bazë	38.5
	I mesëm	44.2
	I lartë	17.4
<b>STATUSI CIVIL</b>	I/e pa martuar	37.3
	I/e martuar	57.0
	Tjetër (i/e divorcuar, i/e ve, jeton me dikë)	5.7
<b>PUNËSIMI</b>	I/e punësuar	37.3
	I/e papunë (student/e, pensionist/e, aktualisht i/e papunë, invalid/e)	62.7
<b>ANËTARËT E FAMILJES</b>	2-3 anëtarë	16.5
	4 anëtarë	35.5
	5 anëtarë	26.1
	6+ anëtarë	21.7
	Mesatarja e anëtarëve të familjes	4.6 anëtarë
<b>TË ARDHURAT MUJORE FAMILJARE</b>	Deri në 20.000 Lekë	21.6
	20.001 – 40.000 Lekë	33.4
	40.001 – 60.000 Lekë	27.0
	Mbi 60.000 Lekë	13.0
	Preferoj të mos e deklaroj	5.1
	Mesatarja e të ardhurave mujore familjare	37015 Lekë
<b>MINORITETI</b>	Komuniteti rom	2.4
	Komuniteti grek	2.3



### 3.1.7. Profili i dhunuesve

Profili i dhunuesve i përshkruar nga grupe të ndryshme: komuniteti, OJF-të dhe autoritetet, përputhet mjaft mirë.

Sipas tyre, tre janë kategoritë kryesore të dhunuesve:

- Burrat që dhunojnë bashkëshortet e tyre (veçanërisht meshkuj të moshës 35-55 vjeç, me arsim të ulët, të papunë, të alkoolizuar, të varur nga kumari/bixhozi, fanatikë, xhelozë)
- Prindërit që dhunojnë fëmijët e tyre. Sipas "Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri" (ALO 116), dhunuesit ndaj fëmijëve, viktimat e dhunës në familje, janë kryesisht babai ndaj djemve dhe nëna ndaj vajzave.
- Fëmijët ndaj prindërve të tyre të moshuar. Sipas intervistës me Fondacionin "Kennedy", djemtë janë veçanërisht dhunues ndaj prindërve.

Ka më pak raste kur motrat e vëllezërit janë cilësuar si një kategori dhunuesish, kryesisht vëllezërit mes tyre ose vëllezërit ndaj motrave, veçanërisht në ato raste kur kanë konflikte pronësie apo trashëgimie.

Sipas efektivave të policisë, ka më pak raste kur gratë abuzojnë ndaj bashkëshortëve të tyre.


*"Më kujtohet një grua 65-66 vjeçe, e rrahur nga i shoqi që ishte diku tek të 70-at. U shtrua në Spitalin Ushtarak dhe doli që aty pas disa muajsh. I kishte çarë gojën, kishte frakturë gjithandej. Shkaku ishte ndarja e pasurisë ndërmjet djemve dhe dëshmitari i vetëm ishte nipi 5-6 vjeç që na tregoi se si e kishte rrahur gjyshi gjyshen. Kështu që mund të thuash që ndodh tek të gjithë dhe nga të gjithë" (OJF)*

## 3.2. ADRESIMI DHE RAPORTIMI I DHUNËS NË FAMILJE

### 3.2.1. Qëndrimet e komunitetit mbi raportimin e dhunës në familje


Gati 1 në 3 të anketuar besojnë se dhuna në familje duhet të raportohet me raste.

Ka ndryshime në qëndrimet e komunitetit në zonat urbane me ato rurale. Të anketuarit në zonat rurale janë më konservatorë: 2.5% e tyre deklarojnë se dhuna në familje nuk duhet të raportohet asnjëherë dhe 40.1% e tyre pranojnë që dhuna në familje duhet të raportohet në raste të caktuara.



Teksa pyeten se kush ka të drejtë të raportojë incidentet e dhunës në familje, pothuaj 9 nga 10 të anketuar deklarojnë se është vetë "viktima" dhe pothuaj 4 në 10 deklarojnë se kushdo që merr dijeni për situatën, ka të drejtë të raportojë.

**GRAFIKU 8**  
**KUSH KA TË DREJTËN TË RAPORTOJË NJË RAST DHUNE NË FAMILJE**



### 3.2.2. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi ligjet për dhunën në familje

<b>TABELA 13</b> <b>NJOHURIA MBI LIGJE TË VEÇANTA NË SHQIPËRI PËR DHF</b>	<b>Total (n=570)</b>
Parandalimin e dhunës në familje	70.8%
Mbështetjen sociale dhe psikologjike për viktimat	56.9%
Mbështetjen ligjore për viktimat	72.15
Mbështetjen mjekësore për viktimat	67.0%
Dënimin e autorëve/dhunuesve	86.5%
Programe mbështetëse apo kurimi / rehabilitimi për autorët/dhunuesit	50.5%

Të dhënat sasiore tregojnë se ka një nivel të lartë ndërgjegjësimi mbi ekzistencën e ligjeve dhe masave ligjore për çështjet e dhunës në familje. Ndërkohë, hulumtimi i thelluar me metoda cilësore zbulon se pjesëmarrësit, në fakt, presin që ligje të tilla të jenë të shkruara. Ata kanë mungesë njohurish mbi përmbajtjen e ligjeve në fjalë dhe përgjegjësi konkrete që kanë autoritetet përgjegjëse.

Pjesëmarrësit e moshës 14 deri në 35-vjeçare kanë disi më shumë informacion për aspektet legjislative mbi dhunën në familje, si p.sh.: mbi ndryshimet e fundit ligjore, ligji mbi barazinë gjinore, linja telefonike për fëmijët, etj. Viktimat e dhunës në familje të intervistuar gjatë këtij studimi raportojnë se nuk kanë pasur informacion mbi masat mbrojtëse dhe shërbimet e ofruara. Vetëm pak prej tyre ishin informuar nga punonjësit e policisë (salla operative 129), kisha dhe OJF-të.

*“Deri në momentin që e raportova rastin tim në polici, nuk dija asgjë për procedurat apo çfarë lloj mbështetjeje mund të merreja” (Viktimë, femër, Shkodër)*

*“I vetmi informacion që mora, ishte nga qendra “Sot për të ardhmen”, dhe jo nga autoritetet zyrtare që supozohet se duhet të na informojnë”. (Viktimë, femër, Durrës)*

### 3.2.3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi autoritetet përgjegjëse për dhunën në familje

Pjesa më e madhe e të anketuarve deklarojnë se institucionet përgjegjëse për të mbështetur viktimat e dhunës në familje janë: policia (95%), rrethi personal shoqëror e familjar (86.8%) pasuar nga sistemi i drejtësisë (gjykata dhe prokuroria: 83.7%).

<b>TABELA 14</b> <b>NJOHURIA MBI AUTORITETET / INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR PÛRKRAHJEN E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI</b>	<b>Totali (n=570)</b>
Policia	95.0%
Pushteti qendror	51.8%
Bashkia/ komuna	53.9%
Sistemi i drejtësisë (gjykatë/prokurori)	83.7%
Institucionet shëndetësore	57.8%
Organizata jofitimprurëse/ shoqëria civile	44.8%
Strehëza	49.3%
Familjarë/miq/kolegë	86.8%
Tjetër (psikologë)	1.3%

Diskutimet e thelluara tregojnë se komuniteti urban dhe rural e vlerëson policinë si autoritetin kryesor, përgjegjës për të ofruar ndihmën – ndërhyrjen e parë, për të izoluar dhunuesin dhe parandaluar përshtallëzimin më tej të situatës familjare.

Pjesëmarrës të tjerë deklarojnë se dhuna në familje duhet të adresohet brenda përbrenda familjes, veçanërisht komuniteti rural, ku edhe presioni i mentalitetit patriarkal është më i theksuar.

Gati 1 në 2 të anketuar cilësojnë gjithë autoritetet e tjera të listuara si përgjegjëse për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje: institucionet shëndetësore (spitalet, qendrat e urgjencës), pushtetin qendror dhe vendor, pasuar nga strehëzat dhe shoqëria civile.

53,9% e të anketuarve konsiderojnë bashkitë dhe/ose komunat si autoritete përgjegjëse për të mbështetur viktimat e dhunës në familje, ndërkohë që nuk kanë informacion mbi ekzistencën e strukturave të specializuara / fokusuar tek dhuna në familje në këto institucione.

Në fokus grupe u theksua shumë roli i psikologut në institucione të ndryshme (bashki, spitale e shkolla) si tepër i nevojshëm për të mbështetur viktimat.

Në vijim, shoqëria civile dhe media, sidomos programet televizive, perceptohen si aktorë tepër të rëndësishëm në adresimin e çështjes së dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave.

### 3.2.4. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi shërbimet që mund të ofrohen në Shqipëri për viktimat e dhunës në familje

<b>TABELA 15</b> <b>A JENI NË DIJENI PËR SHËRBIME TË NDRYSHME QË MUND T'U OFROHEN VIKTIMAVE/PERSONAVE TË PREKUR NGA DHF NË VENDIN TONË?</b>	<b>Total (n=570)</b>
Një numër telefoni falas për të dhunuarit që kërkojnë ndihmë dhe këshilla (Linja këshillimi)	38.4%
Faqe interneti për informacion, ndihmë dhe këshilla në rastet e dhunës në familje	27.7%
Urdhra mbrojtjeje nga gjykata për të dhunuarit	69.1%
Strehëza për vendbanim të përkohshëm	50.0%
Shërbime sociale dhe psikologjike	51.1%
Shërbime ligjore	72.1%
Shërbime mjekësore	66.5%

Të anketuarit janë në dijeni të një sërë shërbimesh që mund të marrin viktimat e dhunës. Tre shërbimet më të përmendura janë: shërbimet ligjore (72.1%), urdhrat e mbrojtjes nga gjykata (69.1%) dhe shërbimet mjekësore (66.5%). Gjysma e të anketuarve kanë përmendur strehëzat dhe shërbimet sociale.

Përgjatë intervistave individuale të thelluara me komunitetin rural u vu re mungesa e informacionit mbi shërbimet që mund të marrin viktimat e dhunës në familje.

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe deklarojnë se pjesa më e madhe e shërbimeve të nevojshme nuk ofrohen dhe/ose janë të pamjaftueshme për të plotësuar gjithë nevojat e viktimave të dhunës në familje.

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit deklarojnë se shërbimet më të nevojshme për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje janë: mbështetja psikologjike nga profesionistët, punësimi, strehimi, procedura falas për divorc, ndihma ekonomike dhe mbrojtja nga shteti. Teksa për dhunuesit shërbimet e mëposhtme janë raportuar si të nevojshme për t'u ofruar ose përmirësuar: masa ligjore, mbështetje psikologjike (veçanërisht për ata me probleme të shëndetit mendor ose çrregullime emocionale), shërbime rehabilituese, punësim.

### 3.2.5. Perceptimi i komunitetit mbi autoritetet që mund të kontribuojnë më tepër në parandalimin e dhunës në familje

Sistemi i drejtësisë, arsimit/ shkollat e policia, të pasuara nga media perceptohen si institucionet që mund të ndihmojnë më tepër në parandalimin e dhunës në familje.

<b>TABELA 16</b> <b>VLERËSIMI PËR NDIHMËN QË MUND TË JAPIN</b> <b>KËTO INSTITUCIONE NË PARANDALIMIN E DHF</b>	<b>Shumë</b>	<b>Disi</b>	<b>Pak</b>	<b>Aspak</b>	<b>Nuk e di</b>
Policia	54.1	37	6.3	1.8	0.7
Pushteti qendror	41.6	25.6	21.5	8.5	2.9
Bashkia/komuna	35.1	38.5	14.2	5.6	6.6
Shoqëria civile/organizatat jofitimprurëse	34.4	37.2	19.3	3.6	5.5
Strehëzat	33.2	36.4	18.7	2.2	9.6
Shërbimet shëndetësore (urgjenca/qendra shëndetësore e lagjes)	39.8	38.2	16	3.8	2.2
Sistemi i drejtësisë (prokurori / gjykatë)	63.6	23.8	11	0.3	1.2
Institucionet fetare	19.6	28.3	25.3	24.3	2.4
Mediat	47.5	32.1	16.4	3.8	0.2
Shkollat/arsimi	57.4	30.3	10.1	1.4	0.7

*"Psikologu i shkollës mund t'u japë informacione fëmijëve dhe të rinjve për çështjet e dhunës në familje: si të mbrohen, ku të raportojnë etj." (Femër, 23 vjeçe, Tirana rurale)*

*"Në shkolla janë përpjekur të rrisin numrin e punonjësve të kualifikuar, të ketë psikologë. Është rritur numri i identifikimit, por ka ende për të bërë, pasi një psikolog mbulon 3-4 shkolla. Është e vështirë të identifikojë dhe raportojë rastin e një nxënësi." (OJF)*

### 3.2.6. Institucionet më të besueshme për të raportuar dhunën në familje

Kur u pyetën se tek cili institucion kanë më tepër besim për të raportuar dhunën në familje, të anketuarit listuan kryesisht tre autoritetet e mëposhtme: policinë, rrethin e tyre personal (shoqëror e familjar) dhe sistemin e drejtësisë (gjykatën dhe prokurorinë)


<b>TABELA 17</b> <b>SUPOZONI SE NË FAMILJEN TUAJ NDODH NJË RAST</b> <b>DHUNE.TEK CILI INSTITUCION KENI MË SHUMË</b> <b>BESIM PËR TË RAPORTUAR?</b>	<b>Autoriteti më i</b> <b>besueshëm</b>	<b>Autoritetet</b> <b>më të</b> <b>besueshme</b>
Policia	59.1	73.7
Familjarë/miq/kolegë	17.4	61.0
Sistemi i drejtësisë	11.7	49.9
Organizatrat jofitimprurëse	3.4	12.4
Bashkia/ komuna	1.7	11.3
Pushteti qendror	1.1	10.1
Institucionet shëndetësore	0.2	9.8
Strehëzat	0.2	7.7
Nuk kam besim tek askush	2.3	2.3
Refuzoj të përgjigjem/ Nuk e di	2.9	2.9

*“Në polici do të drejtohesha... Në bashki nuk ta zgjidh njeri problemin, aty mund të shkosh për papunësi. Mbase edhe në gjykatë” (Femër, 25-35 vjeçe, Tirana urbane)*

*“Denoncim direkt në polici po të më dhunojë i dashuri. Nëse më dhunon familja, atëherë do të shkoja tek shoqëria ose tek partneri.” (Femër, 14-18 vjeçe, Shkodër)*

### 3.2.7. Niveli i rekomandimit për të raportuar rastet e dhunës në familje nëpolici

Të anketuarve iu kërkua të shprehnin se në ç’skallë nga 1 në 10 (ku 1 do të thotë “nuk e rekomandoj aspak” dhe 10 do të thotë “e rekomandoj plotësisht”) do t’u rekomandonin të tjerëve ta denonconin në polici dhunën që kanë pësuar në familje.



Duke emërtuar “frenues” ata të anketuar që janë përgjigjur 1 - 6, “neutral” ata që janë përgjigjur 7-8, dhe “nxitës” ata që janë përgjigjur 9-10, mund të llogarisim Treguesin e Përkrahjes nga komuniteti, që rezulton të jetë minus gjashtë. Ky rezultat tregon se komuniteti nuk e promovon raportimin / denoncimin e dhunës në familje pranë policisë.

Disa pjesëmarrës, qoftë nga zonat urbane, dhe nga ato rurale, deklarojnë se raportimi i dhunës në familje varet nga forma e dhunës së pësuar: dhuna fizike duhet të raportohet në polici, kurse dhuna psikologjike duhet të ndahet me të afërmit ose OJF-të që ofrojnë mbështetje psikologjike.


*“Garantimi i mbrojtjes nuk ndodh. Nëse nuk funksionon sistemi, njerëzit kanë frikë. Funksionimi është shumë i rëndësishëm...” (Mashkull, 25-35 vjeç, Tirana urbane)*

*“Po, për rastet kur personat janë të dëmtuar fizikisht dhe vuajnë vazhdimisht nga dhuna. Ndërsa në rastet kur ndodh vetëm njëherë, duhet të ndërhyjnë familjarët e afërt për ta zgjidhur problemin.” (Mashkull, 36-55 vjeç, Korça rurale)*

*“S’e di nëse duhet të denoncohet, pasi kam frikë nga ndarja dhe zakonisht këto çifte kanë edhe fëmijë ... çfarë do të bëhet me ta, do ndahen? Pasoja të vuajnë fëmijët pastaj.” (Femër, 25-35 vjeçe, Vlora rurale)*

### 3.2.8. Raportimi i dhunës në familje: niveli dhe institucionet ku raportohet

23.4% nga 254 viktima të dhunës në familje e kanë adresuar incidentin tek autoritetet ose rrjeti i tyre personal (miq, të afërm, kolegë). Të rinjtë dhe femrat e adresojnë këtë çështje më shumë sesa të rriturit dhe meshkujt.




Sipas OJF-ve dhe autoriteteve të ndryshme, raportimi i dhunës në familje është në nivele tepër të ulta, edhe pse ka ndërgjegjësim dhe rritje të numrit të denoncimeve këto vitet e fundit. Nga ana tjetër, ata deklarojnë se ka mungesë të statistikave për raportin fenomen-raportim.

*“Mund të them se raportohet shumë pak nga ajo që ekziston realisht. Do të duhej një statistikë, por edhe në këtë rast do të kishte shumë që s’do të pranonin se dhunoheshin” (OJF)*

*“Kemi rritje të denoncimeve si rezultat i sensibilizimit për dhunën në familje. Problemi qëndron se ato (viktimat) duke mos pasur mundësi të tjera për strehim dhe ndonjëherë të ndikuara nga opinioni apo frika e prishjes së familjes dhe fëmijëve, tërhiqen.” (Strehëz)*

Viktimat u pyetën se ku e kishin raportuar fillimisht rastin dhe nëse kishin pasur kontakte të tjera të mëpasshme me autoritete të tjera mbi çështjen e dhunës në familje.

2.1% nga 254 viktima e kanë raportuar fillimisht rastin në polici, kurse 21.3% ia kanë besuar këtë çështje rrethit të tyre personal (miq, familjarë, kolegë).



Në përfundim, 4% e viktimave e kanë raportuar rastin në polici, ndërkohë që 2% e kanë raportuar edhe në institucione të tjera, si: bashki, spital, OJF, strehëz dhe psikolog (1 rast për secilin).

Sipas OJF-ve dhe autoriteteve të ndryshme, rezulton se autoriteti tipik për raportim është policia, pasi shihet si një autoritet me fuqi, pushtet dhe që ofron mbrojtje për qytetarin.


*“Më shumë u drejtohen komisariateve, pasi viktimat kanë besim tek uniforma blu. Ata mendojnë se policia do t'i mbrojë, do të gjejnë mbështetje, si organi më kompetent...” (OJF-të)*

### 3.2.9. Faktorët frenues dhe nxitës në raportimin e dhunës në familje

63.3% nga 244 viktima të dhunës në familje që nuk e kanë raportuar incidentin në asnjë institucion, deklarojnë se këto raste nuk janë mjaftueshëm serioze / të rënda për t'u raportuar; ndjekur nga gjysma e tyre që deklarojnë se këto çështje duhen trajtuar brenda familjes.

Faktorë të tjerë frenues në raportimin e dhunës në familje janë: qëllimi për të ruajtur privatësinë e kësaj çështjeje delikate (37.2%) dhe shpresa se ky do të jetë një rast i izoluar (18.2%).

Vetëm 5.5% e këtyre viktimave shprehen se arsyeja e mosraportimit të rasteve të dhunës në familje ka qenë mungesa e besimit sepolicia mund apo do të bëjë diçka.




(a) Faktorët e tjerë përfshijnë: frikën nga dhunuesi (5.3%), varësinë ekonomike nga dhunuesi (4.2%), drojën që askush nuk do ta besojë (1.1%), efektivët e policisë e njohin / janë miq me dhunuesin (0.6%), etj.

“Edhe unë njoh dikë që e keqtrajton burri, por nuk e denoncon se ka frikë nga ai. Po ka edhe turp se mos e paragjykojnë të tjerët. Ja unë vetë, për shembull, kam turp të them se mamin tim e rreh babi” (Femër e re, komuniteti egjiptian)

Ka disa ndryshime midis të rinjve dhe të rriturve përsa i përket faktorëve frenues për të raportuar dhunën në familje. 56.7% e të rriturve përkundrejt 36.5% të të rinjve e konsiderojnë dhunën në familje si një çështje e cila duhet të trajtohet brenda familjes.

Të rriturit ndihen më tepër përgjegjës për të mbajtur të bashkuar familjen (16.7%) krahasuar me të rinjtë (4.1%), si pasojë ata nuk i raportojnë rastet e dhunës në familje. Ndërkohë 14.9% e të rinjve përkundrejt 1.7% e të rriturve besojnë se dhunuesi e di çka është më e mirë për ta. Mungesa e besimit tek policia është gati dy herë më e lartë tek të rinjtë (8.1%) sesa të rriturit (4.2%).


**GRAFIKU 13**  
**FAKTORËT FRENUES NË RAPORTIMIN E DHUNËS**  
**NË FAMILJE: TË RINJ VS. TË RRITUR**




(a) Faktorët e tjerë përfshijnë: frikën nga dhunuesi, varësinë ekonomike nga dhunuesi, drojën që askush nuk do ta besojë, efektivët e policisë e njohin / janë miq me dhunuesin etj.



Kur të anketuarve, viktimave të dhunës në familje, që nuk e kishin raportuar këtë çështje, iu prezantua koncepti i masave mbrojtëse (urdhrrat e mbrojtjes nga gjykata), 92% e tyre deklaruan se ishin të gatshëm ta raportonin një rast të mundshëm në të ardhmen.



Pjesa më e madhe e viktimave që nuk i kanë raportuar rastet e dhunës në familje, ka gjasa ta raportojnë në të ardhmen në rast se jeta e tyre ose e familjarëve është në rrezik.



### 3.3. POLICIA DHE DHUNA NË FAMILJE

Ky seksion do të japë një pasqyrë të opinionit të përgjithshëm të publikut për policinë, e ndjekur me perceptimin e tyre mbi rolin e policisë në çështjet e dhunës në familje, organizimin e Policisë së Shtetit lidhur me dhunën në familje, bashkëpunimin e Policisë së Shtetit me aktorët e tjerë, suksesin/efikasitetin e Policisë së Shtetit dhe pengesat/shkaqet, si dhe nevojat dhe sugjerimet për të ardhmen.

#### 3.3.1. Opinioni i përgjithshëm publik për policinë

Gjatë diskutimeve të thelluara, pjesëmarrësit nga komuniteti i zonave urbane dhe rurale u pyetën se çfarë u vinte në mendje në momentin e parë kur përmendej fjala “policia”.

Ajo çka është e dukshme, është fakti se këto asociacione të komunitetit i referohen policisë si një autoritet në tërësinë e saj, që në perceptimet e tyre përfshin fusha të ndryshme, si: policinë rrugore, hetimin e krimeve, rendin publik, policinë tatimore etj.

**FIGURA I**  
**MENDIMETË LIRA TË PJESËMARRËSVE NË LIDHJE ME POLICINË**



Policia është e perceptuar nga komuniteti urban e rural i këtyre pesë qarqeve si një autoritet që ofron mbrojtje, siguri, mbrojtjen e rendit dhe zbatimin e ligjeve, në gatishmëri dhe shërbim 24 orë. Në të njëjtën kohë ka disa pjesëmarrës të cilët kanë shqetësime / rezerva kur përmendet fjala “policia”. Sipas pjesëmarrësve, është e kuptueshme që policia në rolin e saj si ruajtëse e rendit dhe qetësisë, ndodh të bëhet nganjëherë e dhunshme dhe frikësuese për njerëzit. Gjithashtu, ata shprehin opinione të dyfishta për punonjësit e policisë (sjellje të mirë dhe ndihmuese, po aq sa edhe indiferentë apo të pasjellshëm).


Të anketuarit u pyetën nëse ishin dakord me një listë pohimesh mbi Policinë e Shtetit Shqiptar duke përdorur një shkallë nga 1-4 (1 do të thotë “nuk jam aspak dakord” dhe 4 “jam plotësisht dakord”). Grafiku i mëposhtëm paraqet imazhin publik të Policisë së Shtetit Shqiptar bazuar në përqindjen e atyre që “janë plotësisht dakord” me deklaratatë të tilla përkundrajt shumës së atyre që janë “dakord” plus “plotësisht dakord”.

7-9 nga 10 të anketuarit kanë mendim mjaft pozitiv për Policinë e Shtetit.

90% e tyre shprehen se PSH-ja mbron rendin publik, 87% që mbron njerëzit nga krimet, 83% që heton dhe arreston ata që kryejnë krime, 75% që reagon menjëherë kur njerëzit kërkojnë ndihmë. 78% e tyre e shohin PSH-në si një

autoritet të besueshëm, 86% shprehen se punonjësit e policisë janë të respektuar nga komuniteti, 73% që punonjësit janë të sjellshëm e të komunikueshëm dhe 63% e tyre shprehen se punonjësit e policisë i trajtojnë të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, etnisë etj.

**GRAFIKU 16**  
**IMAZHI PUBLIK I POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR**




Të anketuarve iu kërkua të shprehnin kënaqësinë e tyre përpolicinë duke marrë parasysh përvojat personale dhe familjare me këtë institucion në përgjithësi, duke përdorur një shkallë nga 1 deri në 10 (1 do të thotë "plotësisht të pakënaqur" dhe 10 do të thotë "plotësisht të kënaqur"). Niveli mesatar i kënaqësisë i totalit të të anketuarve është 6.6.

60% e të anketuarve janë të kënaqur më shumë se mesatarja me rolin e policisë në përgjithësi. 53% e viktimave të dhunës në familje përkundëjt 65.4% e personave që nuk kanë qenë viktimë të dhunës në familje janë më shumë se mesatarja të kënaqur me rolin e policisë në përgjithësi.

Nuk ka dallime të mëdha në nivelin e kënaqësisë me rolin e përgjithshëm të policisë në bazë të gjinisë, moshës, vendbanimit (urban kundrejt rural).

**GRAFIKU 17**  
**SHKALLA E KËNAQËSISË ME ROLIN E POLICISË SË SHTETIT**



Disa deklarata nga të anketuarit e zonave urbane dhe rurale:

“Ka pasur një rast kur m'u kërkua të jap informacion për një grup hajdutësh në fshatin tim. Ata (policët) ishin profesionistë dhe shumë të saktë. Në atë kohë isha 13 vjeç.” (Mashkull, 17 vjeç, Vlora rurale)

“Edhe për kontrolle normale rutinë na trajtojnë pa respekt.” (Mashkull, 25-35 vjeç, Tirana urbane)

“Një shoqja ime u largua njëherë nga shtëpia për shkak të një grindjeje me prindërit. Shumë të shqetësuar, ata morën policinë. Punonjësit e policisë u sollën shumë ftohtë duke u thënë se duhet të kalonin 48 orë për të filluar kërkimet dhe nuk bënë asgjë për të qetësuar prindërit.” (Femër, 14-18 vjeç, Shkodra urbane)

“Një natë, kur një vajzë ishte dhunuar nga një djalë, policia arriti menjëherë dhe e shoqëroi atë djalin në komisariat. U ndjeva shumë mirë me reagimin e policisë.” (Femër, 14-18 vjeç, Tirana urbane)

“Policët e trafikut janë shumë të korruptuar. Ata gjithmonë kërkojnë lekë në vend të dënimit zyrtar” (Femër, 35-55 vjeç, Tirana urbane)

“Ka raste kur ne shkelim ligjin dhe policët rrugorë na tolerojnë dhe na këshillojnë.” (Mashkull, 36-55 vjeç, Vlora urbane)

“Njëherë tim bir e shoqëruan në komisariat për shkak të grindjeje me shokët e klasës. Ne u njoftuam vetëm në orët e vona të mbrëmjes që ai ishte atje. U mor në pyetje pa praninë tonë, të një psikologu apo të një avokati. Edhe pse ishte i plagosur, nuk iu dha ndihmë mjekësore.” (Femër, 36-55 vjeç, Korça urbane)

“Dy vjet më parë punonjësit e policisë shoqëruan vëllanë dhe kushëririn tim bashkë me njerëz të tjerë të fshatit tonë për t'i marrë në pyetje për trafikimin e lëndëve narkotike. Me vëllanë dhe kushëririn tim u sollën shumë mirë, por kemi dëgjuar ankesa nga të tjerët.” (Femër, 22 vjeç, Korça rurale)

### 3.3.2. Perceptimi i komunitetit mbi rolin e policisë në rastet e dhunës në familje

Komunitetit urban dhe rural iu kërkua të shprehin mendimet e tyre për rolin e policisë në çështjet e dhunës në familje. Shumica e të anketuarve e perceptojnë policinë si autoritet që reagon menjëherë dhe paraqitet në vendin e ngjarjes së dhunës në familje, arreston dhe merr në pyetje dhunuesin. Pothuajse gjysma e të anketuarve e shohin policinë në raste të tilla në një rol hetues dhe pyetës. Komuniteti e sheh policinë si një autoritet që ka më pak rol në dhënien e informacionit mbi aspektet ligjore/këshilla ligjore, në përgatitjen e një kërkesë-padie që viktimë mund të paraqesë në gjykatë/prokurori apo në paraqitjen së bashku me një staf të specializuar në vendngjarje.

<b>TABELA 18</b> <b>PERCEPTIMI MBI ROLIN EPOLICISËNË RASTET EDHUNËS NË FAMILJE</b>	<b>Total</b> <b>(n=570)</b>
Policia vjen menjëherë në vendngjarje	77.6
Arreston /shoqëron dhunuesin për në komisariat	64.2
Merr në pyetje dhunuesin	55.0
Heton rastin konkret	49.5
Merr në pyetje viktimën	48
Regjistron informacionet e dhëna nga viktimë	18.1
Sjell në vendngjarje staf/ekip të specializuar (psikolog/ punonjës social etj)	14.5
Ndihmon viktimën për të hartuar kërkesë-padinë për në gjykatë / prokurori	13.2
Shoqëron viktimën drejt qendrave shëndetësore për të marrë shërbimet e nevojshme mjekësore	12.8
Jep informacion për aspektet ligjore/ këshillim ligjor (viktimës dhe dhunuesit)	6.2
Monitoron / ndjek çështjen në vijim	11.4
Nuk e di	1.1

Më tej, diskutimet e thelluara me anëtarë të komunitetit urban dhe rural nxorën në pah se ata presin nga policia që ta burgosë dhunuesin, si dhe që punonjësit e policisë të jenë të shoqëruar me një psikolog kur shkojnë në banesën e të dhunuarës/it dhe/ose kur marrin në pyetje viktimën. Të tjerë presin që policia të ndërmjetësojë dhe të zgjidhë konfliktin familjar pa proceduar me masat ligjore të parashikuara.

*“Zakonisht është inspektori i zonës ai që vjen aty ku ndodh ngjarja, merr të dhëna për atë që ka ndodhur dhe e ndjek më tej çështjen. Policia mbështet viktimën edhe për të bërë kërkesën për urdhrin e mbrojtjes. Ata bashkëpunojnë ngushtësisht me prokurorinë dhe gjykatën.” (Femër, 35-55 vjeçe, Korça urbane)*

*“Kur u referohet një rast dhune, ata shkojnë menjëherë në vendngjarje, këshillojnë palët sipas gjendjes, sa e rëndë është dhe, sigurisht, policia merr masat përkatëse ..” (Mashkull, 35-55 vjeç, Vloa urbane)*

*“Policët i përgjigjen dhunës në familje me dhunë. Ata e marrin me forcë dhunuesin për në komisarariat... dhuna me dhunë ..” (Mashkull, 19-24 vjeç, Korça urbane)*

*“Policët duhet të mbrojnë viktimën, të arrestojnë dhunuesin dhe të mos e lejojnë atë që abuzojë sërish; ata s’duhet ta nënvlerësojnë rastin dhe thjesht të rrinë e pajtojnë çiftin.” (Femër, 25-35 vjeçe, Tirana urbane)*

Gjatë intervistave të thelluara me viktimat, u shprehën pritshmëritë e tyre më të larta ndaj policisë, pritshmëri që tejkalojnë rolin dhe përgjegjësitë e policisë, si p.sh.: strehim të menjëhershëm në rastet e situatave kritike, ushqime, strehim dhe punësim.

*“Punonjësit e policisë ishin shumë të sjellshëm dhe profesionalë. Ata më pritën ngrohtë dhe më bënë të ndihesha rehat, por pastaj filluan të plotësonin gjithë ato letra; mua s’më duhen letrat... mua më duhet një vend ku të fus kokën, të kem një punë, të ndihem e sigurtë, e mbrojtur... Unë kam nevojë për mbështetjen e shtetit, të policisë ...” (Viktimë, femër, Durrës)*

*“Mua më ndihmoi kjo shoqata sociale, por unë pres nga shteti, pres më shumë: pres shtëpi, që burri t’më paguajë detyrimin ushqimor për fëmijët etj.” (Viktimë, femër, Shkodër)*

*“Policia erdhi shumë shpejt. Ata bëjnëç’të munden... por ata s’kanë sesi të gjejnë një vend pune për mua, aq më tepër që gjithë ky popull është pa punë” (Viktimë, femër, Vlorë)*


### 3.3.3. Struktura organizative përgjegjëse për dhunën në familje brenda Policisë së Shtetit

Bazuar në intervistat me punonjësit e policisë, rezulton se Policia e Shtetit ka një organizim dhe linjë raportimi vertikal të mirëstrukturuar dhe funksionale për dhunën në familje.

Në nivelin qendror ka një Sektor për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje (që përbëhet nga një shef dhe 2 specialistë) dhe në nivel rajonal ka Seksione për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje. Standardet e ndryshme për numrin e stafit në këto seksione janë vendosur duke u bazuar në numrin e rasteve të denoncuar. Seksioni pranë DPQ Tiranë ka 4 punonjës (1 shef dhe 3 specialistë), në DPQ Fier ka 2 punonjës (1 shef dhe 1 specialist), ndërkohë që në 10 Drejtoritë e Policisë së Qarqeve të tjera (Shkodër, Dibër, Kukës, Lezhë, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Berat, Durrës dhe Elbasan) ka vetëm një punonjës në këtë seksion.

Në të gjithë vendin ka 43 komisariate që mbulojnë 482 zona. Çdo zonë mbulohet nga një inspektor zone (ndihmëspecialist, SPZ), pra në total ka 482 inspektorë zone, të cilët ndër shumë përgjegjësi të tjera, kanë edhe detyrën e përbaljes së parë me rastet e dhunës në familje.

**FIGURA 2: STRUKTURA ORGANIZATIVE PËRGJEGJËSE PËR DHUNËN NË FAMILJE BRENDA POLICISË SË SHËTETIT**



Bazuar në intervistat me punonjës të rangjeve të ndryshme të Policisë së Shtetit rezulton se linja piramidale e raportimit është e rregullt dhe realizohet çdo ditë, javë dhe muaj.

Për arsye statistikore (por jo vetëm) mblidhen të dhëna / informacione të ndryshme: informacion mbi profilin e viktimave (emër, mbiemër, mosha, nëse është rast i përsëritur, gjinia, vendbanimi, arsimit, statusi civil, lidhja me dhunuesin, minoritetet, shtetësia); informacion mbi dhunuesin (arrestuar në flagrancë, në drejtim të panjohur, në kërkim etj.), si dhe lloji veprës / kundravajtjes penale. Këto statistika përditësohen dhe raportohen çdo muaj dhe më pas çdo tre muaj në secilin nga nivelet.

*“Nga statistikat bie në sy sezonaliteti i dhunës në familje. Gjatë pushimeve të verës dhe në periudhën e vitit të ri kthehen shumë emigrantë, të cilët gjejnë situata të papëlqyeshme në familje, dhe kjo çon në incidente të dhunës në familje..” (Punonjës policie, Tiranë)*

### 3.3.4. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me aktorë të tjerë për dhunën në familje

Policia e Shtetit bashkëpunon me aktorë të ndryshëm për të adresuar, hetuar dhe reduktuar dhunën në familje. Informacioni i mëposhtëm paraqet pikëpamjet dhe opinionet e aktorëve të ndryshëm bazuar në përvojën e tyre të bashkëpunimit.

#### **Bashkëpunimi PSH - MPÇSSHB**

Të dyja palët deklarojnë se bashkëpunimi është i kënaqshëm dhe i suksesshëm. Ministria e cilëson Policinë si partnerin më të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje.

Policia furnizon MPÇSSHB-në me statistika mbi numrin e rasteve të dhunës në familje dhe numrin e kërkesë-padive për urdhra mbrojtjeje çdo tremujor.

Në kuadër të forcimit institucional të kapaciteteve specifike në përgjigje të nevojave të viktimave të dhunës në familje, gjatë viteve të fundit MPÇSSHB-ja ka kryer trajnime mbi çështjet e barazisë gjinore e dhunës në familje me Drejtoritë e Policisë në Qarqe me tematikë “Mbrojtja, trajtimi dhe menaxhimi i rasteve të dhunës në familje në nivel lokal, bazuar në legjislacionin përkatës dhe në krijimin e reagimit të koordinuar kundrejt këtij fenomeni”.

Në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë së Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2011-2015), MPÇSSHBJ-ja ka planifikuar në vazhdimësi trajnime të punonjësve të policisë, shëndetësisë, gjykatave, prokurorive, zyrave të përmbarrimit, mediave etj, mbi çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

### **Bashkëpunimi PSH - Ministria e Shëndetësisë / qendrat shëndetësore**

Bashkëpunimi midis Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Shëndetësisë është kryesisht në nivelet bazë, pra, me qendrat shëndetësore dhe drejtoritë rajonale të shëndetit publik.

Ministria e Shëndetësisë deklaron se ka rol mbështetës në përgjigjen ndaj dhunës në familje, duke krijuar kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna.

Punonjësit e policisë shoqërojnë viktimat drejt qendrave shëndetësore kur ndihma mjekësore është e nevojshme. Stafii mjekësor raporton rastet e dhunës në familje vetëm me miratimin e viktimës.

*“Qendrat shëndetësore shpesh nuk e lëshojnë raportin e nevojshëm mjekësor që u duhet viktimave gjatë procesit gjyqësor” (OJF)*

*“Institucionet e kujdesit shëndetësor, siç janë qendrat e planifikimit familjar, konsultoret e grave dhe fëmijëve, qendrat shëndetësore, spitalet janë vende ku popullata e gjerë ka kontakte të shpeshta dhe shpeshherë të para me punonjësit e kujdesit shëndetësor.” (Ministria e Shëndetësisë )*

*“Nga ana e personelit mjekësor bëhen referime (kur kërkohet) në rajonin e policisë, strehë, referim ligjor etj., sepse falë trajnimeve të bëra tashmë në 6 rajone (ndërkohë janë dhe 6 rajone të tjera për t'u trajnuar), ata dinë të dallojnë personat e dhunuar. Por, nga ana tjetër, duhet punuar shumë me mentalitetin e njerëzve. Në përgjithësi nuk e pranojnë që janë të dhunuar”. (Ministria e Shëndetësisë)*

### **Bashkëpunimi PSH - Ministria e Drejtësisë / Zyrat e Përmbarrimit**

Në këtë kontekst Ministria e Drejtësisë deklaron se është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi midis Zyrave të Përmbarrimit dhe Policisë së Shtetit e miratuar që në 2005-n dhe e rishikuar në 2011-n. Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin dypalësh duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë. Nga intervistat e thelluara rezulton se policia ofron mbështetjen e saj në rastet e kërkuara nga Zyrat e Përmbarrimit për të ekzekutuar UMM / UM-të.

*“Ka qenë mbështetja absolute e Policisë së Shtetit dhe, kur ka vepruar përmbarruesi, ka bashkëpunuar me policinë. Edhe nëse vendimi për ekzekutimin e UMM-së është dërguar direkt tek përmbarrimi, gjithnjë këto janë zbatuar vetëm me bashkëpunimin e forcave të policisë” (Ministria e Drejtësisë)*

Ka pak punonjës policie që shprehen se nuk ka bashkëpunim të mirëfilltë me Ministrinë e Drejtësisë, pasi ndihma ligjore falas ofrohet kryesisht nga OJF-të.

Shumë ankesa të punonjësve të policisë i adresohen Zyrave të Përmbarrimit në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes/ urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

*“Zyrat e përmbarrimit nuk janë mbështetëse. Është detyra e tyre, janë ata kryesorët për të zbatuar vendimin e gjykatës dhe ne si polici duhet t'i mbështesim kur është e nevojshme.” (Punonjës policie)*

*“Ka raste kur UM-të janë ekzekutuar nga përmbarruesi privatë, pra, duhet edhe të paguajë viktimat.” (Punonjës policie)*

### **Bashkëpunimi PSH - Sistemi i Drejtësisë (Gjykata dhe Prokurori)**

Bazuar në intervistat me Policinë e Shtetit, bashkëpunimi me gjykatat është rritur vitet e fundit për shkak të rolit të drejtpërdrejtë të policisë në kuadrin e urdhrave të mbrojtjes. Megjithatë, ka pasur disa vërejtje lidhur me mundësinë e zbatimit të vendimeve të veçanta të gjykatës.

“Një shtëpi është 70m<sup>2</sup> dhe gjykata vendos që dhunuesi nuk duhet të ketë më pak se 50 m distancë nga viktima. Ky është vendim i pazbatueshëm. Gjyqtarët nuk tregojnë kujdes për çështje të tilla” (Punonjës i policisë)

“Ka bashkëpunim mes gjykatës dhe policisë, por nuk është shumë i dukshëm. Ne nxjerrim një vendim dhe policia duhet ta zbatojë atë në përputhje me rrethanat...” (Gjyqtar civil)

“Personalisht nuk e shoh si zgjidhje apo si masë mbrojtjeje lënien në një shtëpi të viktimës dhe dhunuesit gjatë periudhës së urdhrimit të mbrojtjes. Në raste të tilla do të duhej edhe një punonjës policie në korridor. Por ndonjëherë është e vështirë të japësh një vendim, pasi nuk ka shërbime në vend...” (Gjyqtar civil)

“Punonjësit e policisë nuk dëshmojnë në seancat gjyqësore, pavarësisht se mund të jenë dëshmitarë të dhunës së ushtruar...” (Përfaqësues i OJF-ve)

“Ka raste kur viktimat janë paragjykuar në seanca gjyqësore nëse janë veshur mirë ose kur mundohen të mos e japin veten. Gjyqtarët shprehin me ironi se gratë duken mirë dhe nuk ngajnë si të dhunuara”. (Përfaqësues i OJF-ve)

“Bashkëpunimi me prokurorinë është më i rrallë, pasi ata merren me rastet kur viktimat kanë dëmtime fizike.” (Punonjës i policisë)

“Bashkëpunimi me policinë është mjaft i mirë. Sigurisht, Policia e Shtetit ka një strukturë organizimi ndryshe nga e jona, ndaj kemi nevojë për t’u përshtatur, dmth. ka raste kur ne e kalojmë një çështje tek një punonjës i policisë, i cili për arsye pune mund të transferohet diku tjetër dhe kjo ndikon në efikasitetin dhe përgjigjen e shpejtë...” (Prokuror)

### **Bashkëpunimi PSH - Qeveria lokale**

Bazuar në intervistat me Policinë e Shtetit, bashkëpunimi me qeverinë lokale është shumë i rëndësishëm në përgjigjen ndaj dhunës në familje; dhe hap pas hapi bashkitë po ndërtojnë kapacitetet për të ngritur strukturën e duhur për të përmbushur rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

Bashkëpunimi është vendosur në nivel lokal me të gjitha Drejtoritë e Policisë Rajonale në të gjitha ato bashki ku tashmë është ngritur sistemi i reagimit të koordinuar dhe referimit të rasteve të dhunës në familje (kohët e fundit Bashkia e Tiranës).

Bashkitë bashkëpunojnë ngushtë me policinë, prej së cilës merret një informacion i plotë për rastet e ndodhura.

Bashkitë në përgjithësi kanë një bashkëpunim më të gjerë me OJF-të, që vjen edhe për faktin se këto të fundit zakonisht u ofrojnë strehë, këshillim dhe ndihmë ligjore viktimave të dhunës, por edhe për faktin se plotësojnë boshllëqet që vetë bashkitë kanë në ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave.

Punonjësit e policisë nga komisariate të ndryshme pohojnë se ekziston gatishmëria nga bashkitë për të bashkëpunuar, por ato kanë kapacitete të kufizuara në burime njerëzore dhe financiare, orë pune zyrtare të kufizuara, linjë telefonike falas jofunksionale 24 orë etj, çka dhe e vështirëson punën e tyre për trajtimin e rasteve.

“Ka raste të bashkëpunimit konkret ndërmjet komisarariatit tonë dhe bashkisë për të koordinuar ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat, si: strehëza, këshillim etj.” (Inspektor zone, Vlorë)

“Të gjitha institucionet e tjera mbyllen në orën 4:00 të pasdites dhe, kur ndodhin incidentet e dhunës në familje, i vetmi institucion funksional është policia. Në mesnatë të gjithë janë mbyllur...” (Specialisti për hetimin dhe parandalimin e krimeve, Tiranë)

Në mënyrë të ngjashme OJF-të pohojnë se:

“Bashkia duhet të jetë koordinatori, duhet të krijojë qendra sociale, por buxheti që vjen nga qeveria qendrore është zvogëluar shumë, ndërkohë që kërkesat legislative janë gjithmonë në rritje”.

“Bashkia e Durrësit dhe vetë kryetari kanë qenë shumë të gatshëm dhe përkrahës. Gjithë këto vite unë kam punuar me grupet në nevojë dhe mund të them se ato janë konsideruar me përparësi. Ka shtëpi në dispozicion



*për raste emergjente (qiraja paguhet nga bashkia). Me aq sa jam informuar, bashkia po planifikon që të ketë apartamente të përbashkëta, të ngjashme me përvojën italiane, për gratë e dhunuara”*

Përfaqësuesit e intervistuar në katër bashkitë pohojnë se bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është i kënaqshëm dhe produktiv.

*“Ne i referojmë rastet tek policia ose ata na japin informacion për rastet e dhunës në familje. Gjithashtu, policia është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe vepron brenda zonës së përgjegjësive të saj...” (Bashkia Vlorë)*

*“Ne referojmë dhe ata na referojnë raste të dhunës në familje dhe koordinojmë punën për zgjidhjen e mbështetjen e rastit. Zakonisht ne ndihmojmë kur femrat kanë vështirë të përballen me policinë për shkak të opinionit. Në këto raste ne plotësojmë akt-padinë për UM-në, shoqërojmë viktimën në sallën e gjyqit, e shoqërojmë pranë strehëzave”. (Bashkia Shkodër)*

*“Bashkëpunimi është i mirë, nuk di ç’mund të përmirësohet. Sa herë na është dashur bashkëpunimi me policinë, sa herë i kemi thirrur, na janë përgjigjur” (Bashkia Durrës)*

*“Bashkëpunimi me policinë është i mirë. Në rastet kur viktimës i nevojitet strehim, qoftë edhe i përkohshëm, dhe sipas rastit që paraqitet, ne koordinojmë punën mes dy palëve” (Bashkia Korçë)*

Bashkëpunimi me komunat është përshkruar si më sfidues, pasi nuk ka specialistë të çështjeve gjinore apo administratorë socialë, ndërsa Policia e Shtetit mbulon të gjithë territorin e vendit.

### **Bashkëpunimi PSH - Drejtoritë Arsimore**

Punonjësit e policisë kanë raportuar se ka bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale në aktivitete të përbashkëta me OJF-të dhe/ose aktorët e tjerë. Si fushë kryesore e bashkëpunimit kanë qenë aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit në shkolla.

Nga ana e punonjësve të policisë bëhet e ditur se ata bashkëpunojnë me shkollat. Ka aktivitete të organizuara ku punonjësit e policisë gjatë orëve të mësimit kanë ndarë informacione për dhunën në familje, ndikimin e saj në shoqëri, ligjin shqiptar etj. me qëllim për të ndërgjegjësuar nxënësit në lidhje me fenomenin dhe raportimin.

*“Në bashkëpunim me bashkitë dhe shkollat kemi iniciuar disa takime me nxënësit për të siguruar informacion dhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e dhunës në familje” (Punonjës i policisë)*

Disa prej inspektorëve të zonave shprehen se prania e tyre në shkolla është e përditshme dhe kanë një bashkëpunim shumë të ngushtë me mësuesit dhe nxënësit. Disa SPZ shprehen se janë vetë shkollat ato që duhet të planifikojnë orët e mësimit dhe pastaj policia është shumë e gatshme që të marrë pjesë në këto orë ndërgjegjësimi.

Një nga kritikantët, sidomos nga OJF-të, lidhet me numrin e kufizuar të psikologëve në shkolla për të përballuar fluksin e problemeve që nxënësit mund të kenë. Sipas punonjësve të policisë dhe OJF-ve, denoncimet për rastet problematike bëhen kryesisht nga mësuesit dhe rrallë nga psikologu.

### **Bashkëpunimi PSH - OJF**

Të gjithë punonjësit e policisë kanë raportuar bashkëpunimin me OJF-të e ndryshme në rajonet e tyre, si: Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz, qendra “Sot për të ardhmen” dhe “Qendra Sociale për Gra dhe Vajza” në Durrës, qendra sociale dhe strehëza “Vatra” dhe “Aulona” në Vlorë, fondacioni “Kennedy”, shoqata “Dorka” dhe “Gruaja Korçare” në Korçë, shoqatat “Gruaja tek gruaja”, “Hapat e lehtë”, “SOS Fshati i fëmijëve – Programi i Fuqizimit të Familjes” në Shkodër, “Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare”, “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, “Në dobi të gruas shqiptare”, “Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza”, shoqata “Refleksione” në Tiranë, “Tjetër Vizion” në Elbasan etj.

Bashkëpunimi me OJF-të konsiston në aktivitete të ndryshme: trajnime, aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe shërbime të drejtpërdrejta, si: informacion mbi procedurat dhe shërbimet në dispozicion, ndihmë ligjore falas, këshillim psikologjik, mbështetje shëndetësore, strehim, trajnime profesionale, ndërmjetësim për punësim, linjë këshillimi 24 orë falas etj.

Një bashkëpunim i tillë i ngushtë ishte i dukshëm gjatë intervistave, pasi palët përmendën edhe emrat personale të njëri - tjetrit.

*“Pika e fortë e bashkëpunimit mes Policisë dhe OJF-ve është se ata ofrojnë shërbime që qeveria lokale ose autoritetet e tjera përgjegjëse nuk i ofrojnë... Ata janë një mbështetje e madhe për menaxhimin e rasteve, një ndihmë e çmuar për viktimat.” (Punonjës i policisë, Tiranë)*

*“Në praktikë ndihma ligjore falas ofrohet vetëm nga avokatët e OJF-ve...” (Punonjës të policisë & OJF)*

*“OJF-të kanë shërbime plotësuese, atë çfarë shteti nuk ua ofron viktimave...” (Përfaqësues i OJF-ve)*

*“Falë OJF-ve, viktimat kanë disa strehëza për të qëndruar edhe pa u lëshuar ende urdhri i mbrojtjes...” (Punonjës i policisë)*

*“Policia është burimi kryesor referues i rasteve të dhunës ose ne raportojmë rastet tek ata. Së bashku koordinojmë punën se si të mbështesim dhe zgjidhim rastet sipas specifikave që kanë.” (Strehëz)*

OJF-të pranojnë se në përgjithësi bashkëpunimi me Policinë është i mirë, duke u shprehur se ka vend për përmirësim. Disa prej tyre shfaqën edhe disa shqetësime:

*“Bashkëpunimi ynë i drejtpërdrejtë me policinë është ose për referimin e rasteve, ose për transportin dhe shoqërimin e viktimave në spital. Ne e kërkojmë bashkëpunimin e tyre pothuajse çdo dy ditë. Ata janë gjithmonë në dispozicion dhe nuk na e mohojnë mbështetjen”. (Strehëz)*

*“Me Policinë e Shtetit në përgjithësi bashkëpunimi është i mirë. Një shqetësim i madh është luhatja e lartë e stafit që merret me dhunën në familje. Pasi një specialist merr trajnimin e plotë lidhur me këtë çështje, ai/ajo transferohet ....” (Përfaqësues i OJF-ve)*

*“Shpesh kërkojmë nga policia që të përgatisë kërkesën për urdhër mbrojtjeje për viktimat që ndihmojmë. Kjo ndodh sepse ata e nënvlerësojnë seriozitetin e rasteve. Nuk janë të gatshëm të nisin plotësimin e kërkesës nëse viktima nuk është shpërftuar nga dhuna fizike...” (OJF)*

*“Ka vend për përmirësim, gjithmonë.. p.sh. të gjitha komisariatet mund të informojnë punonjësit e tyre dhe ata të informojnë familjet që ekziston një linjë e tillë këshillimi, ku mund të marrin informacione ose të flasin me ne...” (OJF)*

### **Bashkëpunimi PSH - komunitet**

Sipas punonjësve të policisë të intervistuar, janë organizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme: për të dhënë informacion në lidhje me çështjet e dhunës në familje, mbrojtjen e të miturve dhe rolin e policisë në komunitet. Sipas tyre, ekziston një vetëdije në rritje në radhët e komunitetit dhe kjo ka kontribuar gjithashtu në rritjen e raportimit zyrtar. Megjithatë, nuk ka qenë e mundur të organizohen aktivitete me shkallë të gjerë pjesëmarrësish nga komuniteti për shkak të mungesës së fondeve, mungesës së burimeve njerëzore dhe logjistikës. Përveç kësaj, mbledhja e komunitetit në një aktivitet të mirëkoordinuar dhe motivimi i tyre për të marrë pjesë në këto aktivitete, është një sfidë më vete. Megjithatë, inspektorët e zonave përpiqen të informojnë mbi baza individuale.

*“Janë zhvilluar seminare me popullsinë rome dhe anëtarët e komunitetit egjiptian për t'i informuar ata për strategjinë, për integrimin e komunitetit rom, regjistrimin e fëmijëve në zyrën e gjendjes civile, si dhe çështjet e dhunës në familje” (Punonjës policie, Korçë)*

*“Policimi në komunitet nuk është i matshëm nga aktivitetet. Shkalla e suksesit të saj është e lidhur me shërbimet profesionale dhe të shpejta në komunitet, në mënyrë që puna jonë të çojë në bashkëpunim të mëtejshëm me komunitetin. Ata janë të gatshëm të afrohen dhe të ndajnë me ne”. (Punonjës i policisë, Tiranë)*

Punonjësit e policisë pohojnë se komuniteti nuk është aktiv në raportimin zyrtar të dhunës në familje dhe kjo vjen si rezultat i arsyeve të ndryshme. Ajo çka vihet re, është një rritje në raportimin zyrtar në 3-4 vitet e fundit, dhe kjo jo vetëm në qytetet e mëdha. Qarqet më problematike për nivelin e raportimit janë Kukësi, Dibra, si dhe zonat rurale.

Gjatë hulumtimit të thelluar të qëndrimeve dhe sjelljeve të komunitetit urban dhe rural, ishte e qartë autokritika për rolin e tyre pasiv, sidomos në adresimin e dhunës në familje. Përveç kësaj, është vetë komuniteti që kontribuon edhe në përkeqësimin e situatës së viktimës: stigmatizimi, paragjykimet, fajësimi dhe braktisja e viktimave etj.

*“Dhuna në familje ndodh brenda shtëpisë. Është e nevojshme të jetë dikush që të informojë policinë, përndryshe ne nuk mund t'i shërbejmë komunitetit ... (Punonjësi i policisë)*

*“Viktimat e dhunës e durojnë dhunën për një kohë të gjatë dhe na drejtohen vetëm në raste ekstreme... Si mund t'i ndihmojmë ne, nëse fqinjët nuk na informojnë?!” (Punonjës policie)*

*“Kemi bërë shumë për rritjen e ndërgjegjësimit. Kemi shpërndarë fletëpalosje, por njerëzit përtojnë të lexojnë. Mbetet komunikimi ballë për ballë. Dhe në përgjithësi, problemi kryesor në raportimin dhe denoncimin e çështjes është qëndrimi: nëse nuk është problemi im, s'më intereson se kush ofron ndihmë” (Përfaqësues i OJF-së)*

*“ Në fshatin tim komuniteti është pasiv; nuk të mbështesin në raste të tilla. Vetëm thashetheme...” (Femër, 17 vjeçe, Durrësi rural)*

*“Ende besojmë se, nëse raportojmë incidentin që mund t'u ndodhë fqinjëve, të afërmeve, miqve tanë, do të etiketohemi si spiunë, si në kohën e komunizmit... Nëse viktimat është femër, mendojmë se ajo me siguri ka bërë diçka të gabuar dhe kjo është arsyeja përse burri e rreh... I gjithë komuniteti jeton me një mentalitet problematik. Ne ndjekim ligjin e heshtjes dhe indiferencës.” (Grup diskutimi me meshkuj, 25-35 vjeç, Shkodër)*

*“Nëse fqinjët e mi kanë një grindje të dhunshme brenda çiftit, nuk ndihem i sigurt për ta raportuar. Policia mund të vijë dhe t'i thotë atij se kush e ka denoncuar dhe ditën tjetër gjej fqinjin tim duke më kërkuar llogari se pse e bëra atë gjë... Nuk dua të kem probleme të tilla” (Grup diskutimi me meshkuj, 25-35 vjeç, Tiranë)*

### 3.3.5. Ndërgjegjësimi dhe perceptimi i komunitetit mbi efikasitetin e bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me aktorët e tjerë për dhunën në familje

Të anketuarit e zonave urbane dhe rurale deklaruan se autoritetet kryesore me të cilat bashkëpunon policia për dhunën në familje janë: sistemi gjyqësor (gjykatat dhe prokuroritë), qeveria qendrore e lokale dhe vetë komuniteti.

<b>TABELA 19 NDËRGJEGJËSIMI MBI BASHKËPUNIMIN E POLICISË ME INSTITUCIONET TË TJERA</b>	<b>Njohuria spontane</b>	<b>Njohuria totale (spontane &amp; e nxitur)</b>
Sistemin e drejtësisë	59.5	79.4
Pushtetin qendror	36.6	49.1
Bashkitë / komunat	29.7	47.4
Komunitetin	14.3	48.3
Shërbimet shëndetësore	13.1	39.3
Shoqërinë civile / OJF-të	11.0	28.4
Strehëzat	8.7	24.5
Policia nuk bashkëpunon me asnjë autoritet për dhunën në familje	1.3	1.3
Nuk e di	9.3	9.3

Sipas të anketuarve, bashkëpunimi i policisë është i efektshëm me pothuaj të gjitha institucionet, por më tepër me sistemin gjyqësor, qeverinë qendrore dhe komunitetin krahasuar me institucionet dhe aktorët e tjerë.

<b>TABELA 20 SA EFEKTIV ËSHTË BASHKËPUNIMI I POLICISË ME INSTITUCIONET E TJERA</b>	<b>Shumë efektiv</b>	<b>Disi efektiv</b>	<b>Pak efektiv</b>	<b>Aspak efektiv</b>	<b>Nuk e di</b>
Pushtetin qendror	54.6	39.7	4.3	1.1	0.3
Pushtetin lokal	41.1	50.2	8.0	0.4	0.3
Shoqërinë civile / OJF-të	36.6	52.1	10.0	0.5	0.7
Strehëzat	36.2	44.7	16.3	0.0	2.8
Shërbimet shëndetësore	50.1	37.9	10.3	0.9	0.9
Sistemin e drejtësisë	64.5	27.4	7.5	0.0	0.7
Komunitetin	53.8	35.2	9.2	0.8	1.0

### 3.3.6. Efektiviteti dhe sukcesi i Policisë së Shtetit

#### Këndvështrimi i komunitetit

Bazuar në përvojën e tyre personale ose atë të rjetit të tyre personal (shoqëror e familjar), 3 në 4 të anketuar deklarojnë se policia është e efektshme dhe reagon menjëherë në rastet e dhunës në familje; 2 në 3 të anketuar deklarojnë se policia është e efektshme në mbështetjen që ofron për viktimat e dhunës në familje; dhe 56.1% e tyre deklarojnë se policia është e efektshme në parandalimin e këtij fenomeni.

<b>TABELA 21 EFEKTIVITETI I POLICISË NË PËRGJIGJIE NDAJ DHUNËS NË FAMILJE</b>	<b>Shumë efektiv</b>	<b>Disi efektiv</b>	<b>Pak efektiv</b>	<b>Aspak efektiv</b>	<b>Nuk e di</b>
Reagimin e menjëhershëm në rastet e dhunës në familje	18.5	55.0	22.4	3.3	0.9
Mbështetjen e dhënë për viktimat e DHF-së	24.0	39.8	31.6	3.2	1.4
Parandalimin e dhunës në familje	12.4	43.7	32.8	8.1	2.9

Pavarësisht kësaj, disa pjesëmarrës nga komuniteti urban e rural, gjatë diskutimeve të thelluara shprehën disa rezerva në lidhje me efikasitetin e policisë:


*“S’besoj se policia është 100% efektive. Ka raste këtu në fshatin tim kur policia vetëm vjen, e sheh rastin dhe nuk e ndjek më tej...” (Femër, 25-35 vjeçe, Korça rurale)*

*“Policia është mjaft korrekte dhe gjithmonë respekton procedurat që kanë...” (Femër, 14-18 vjeçe, Tirana urbane)*

*“Punonjësit e policisë nuk janë efektivë për ta adresuar siç duhet dhunën në familje. Si mund të bëjnë këtë? Ata vetë janë agresivë. Unë jetoj në një pallat ku shumë fqinjë janë punonjës policie... Dhe unë e di që ata i rrahin gratë e tyre...” (Femër, 19-24 vjeçe, Vlorë)*

*“Me sa di unë, policia është shumë e suksesshme. Vijnë me vrap...” (Mashkull, 35-55 vjeçe, Korça rurale)*

## GRAFIKU 18 EFEKTIVITETI I POLICISË NË PËRGGJIGJIE NDAJ DHUNËS NË FAMILJE



*“Në shumicën e rasteve ata e mbyllin diskutimin me viktimën duke i thënë se është e pranueshme që burri t’i japënganjëherë nja dy shpulla gruas” (Femër, 36-55 vjeçe, Tiranë)*

*“Shpesh i neglizhojnë rastet. Ishte një rast që një grua denoncoi djalin e vet se e dhunonte. Dhe polici në vend që të merrte ndonjë masë, ç’bënte? E pyeste vazhdimisht nëse ishte e sigurt që donte ta padiste të birin ...” (Mashkull, 25-35 vjeç, Shkodër)*

### Këndvështrimi i viktimave të dhunës në familje

Gjatë këtij studimi, në të dyja fazat sasiore dhe cilësore, kemi diskutuar në total me 733 individë nga komuniteti. Prej tyre 23 individë kanë qenë viktimë të dhunës në familje që e kishin raportuar / denoncuar rastin në polici. Në fazën cilësore, intervistat e thelluara u bënë të mundura kryesisht me ndërmjetësimin e OJF-ve dhe strehave që mbështesin viktimat e dhunës në familje në qarqe të ndryshme. Përzgjedhja ishte rastësore dhe me miratimin e vetë viktimave. Në fazën sasiore, të gjithë të anketuarit janë pyetur për përvojën e tyre personale me dhunën në familje; dhe ata që kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunë në familje, janë pyetur më tej nëse e kanë raportuar këtë incident, ku etj.

Këta individë, viktimë të dhunës në familje janë midis moshës 14 e 55 vjeç, dhe 18 nga 23 janë femra. Pjesa më e madhe e tyre kanë përjetuar dhunë të vazhdueshme për vite dhe në të njëjtën kohë, dhunë të formave të ndryshme. Nga këto 23 viktimë: 21 prej tyre deklarojnë se kanë pësuar dhunë fizike, 2 dhunë seksuale, 18 abuzim emocional dhe 21 abuzim psikologjik.

*“Ai më keqtrajtonte që kur ishim të fejuar. Por atëherë isha e re dhe s’e kuptoja që kjo s’ishte sepse ai ishte xheloz apo se më donte. Ndihej gjithnjë më inferior se unë dhe më vonë filloi të vinte pothuaj çdo ditë i dehur. Kishim zënka dhe më kërcënonte, me raste më dhunonte. Para 10 vjetësh mora guximin të shkoja drejt divorcit, por siç janë këto punë në Shqipëri, të afërmit donin të na pajtonin. Në atë kohë s’kishte informacion që kishte kështu strukturash për dhunën në familje. Kur fëmijët u rritën, s’mund të duroja dot më ...” (Femër, 46 vjeçe, e divorcuar)*

*“Gjithmonë kemi pasur zënka në familje, sidomos me vëllanë. Besoj që ai gjithmonë e ka ditur ose dyshuar drejtimin tim seksual. Por kur ua thashë atyre të shtëpisë të vërtetën, që jam homoseksual, vëllai më godiste me grushta dhe më pas edhe babai. Prindërit më shumë përdornin format e abuzimit psikologjik: më ofendonin,*

kërcënuan partnerin tim, dhe më vonë më ndërprejnë çdo mbështetje financiare, edhe ato që ishin në emrin tim... (Mashkull, 22 vjeç, beqar)

Në gjysmën e këtyre rasteve viktimat e kanë raportuar vetë incidentin në polici, kurse në rastet e tjera ka qenë dikush nga miqtë ose të afërmit (farefisi).

Në gjysmën e rasteve viktimat e kanë raportuar incidentin përmes numrit falas të policisë (129) dhe brenda së njëjtës ditë kur ka ndodhur incidenti.

Katër nga këto viktimat janë paraqitur në gjykatë, tre prej tyre kanë marrë urdhër mbrojtjeje. Më tej, gjashtë prej tyre kanë marrë mbështetje nga OJF-të (2 prej tyre në strehëza).

Në gjysmën e rasteve këto viktimat kanë marrë mbështetje ligjore, sociale dhe psiko-emocionale dhe në dy raste kanë marrë shërbime mjekësore.

Tabela e mëposhtme tregon disa nga veprimet / masat e marra nga policia në rastin e këtyre viktimave.

<b>TABELA 22</b> <b>REAGIMI I POLICISËNË RASTET E DHFTË RAPORTUARA(a)</b>	<b>n=23 raste</b>
Shkon menjëherë në vendngjarje	9
Arreston dhunuesin	5
Merr në pyetje dhunuesin	5
Heton rastin konkret	6
Merr në pyetje/ mbledh informacione nga viktimat/t dhe dëshmitarë të tjerë	10
Regjistron informacionin e dhënë nga viktimat/t	6
Dërgon në vendngjarje një staf të specializuar (psikolog/ punonjës social)	6
Ndihmon viktimën për hartimin e kërkesë-padisë për në gjykatë/ prokurori	3
Shoqëron viktimën/ të dhunuarën drejt shërbimeve mjekësore	2
Jep informacion për aspektet ligjore/ këshillim ligjor	5
Tjetër (këshillim për t'u pajtuar, shoqërim drejt shërbimeve sociale)	4

(a) Shifrat në këtë tabelë paraqesin numrin e rasteve

Pjesa më e madhe e këtyre viktimave janë të kënaqura me përgjigjen e shpejtë të policisë për trajtimin e rastit. Disa prej tyre janë të kënaqura me sjelljen dhe komunikimin e punonjësve të policisë, të tjerat jo.

Ka disa arsye që shpjegojnë pakënaqësinë e tyre: policia ka arrestuar dhe lënë "lehtësisht" të lirë dhunuesin; punonjësit e policisë nuk u kanë dhënë informacione mbi shërbimet e mundshme ose të drejtat që ka viktimat. Më tej, viktimat shprehen se ato janë mbështetur me shërbime kryesisht nga OJF-të më shumë sesa nga policia. Nga vëzhgimi dhe diskutimet me viktimat është e dukshme se pakënaqësia e tyre vjen gjithashtu edhe si rezultat i pritshmërive të larta që kanë ndaj shërbimeve që policia duhet të ofrojë, të cilat shkojnë edhe përtej përgjegjësive ligjore të këtij autoriteti, si p.sh.: ofrimi i strehimit, ndërmjetësim për punësim etj.

### **Këndvështrimi i aktorëve të tjerë, përfshi PSH-në**

Policia e Shtetit ka hartuar një Plan Veprimi në shtator 2011 për zbatimin e planit të veprimit të SKBGJ-DHGDHF 2011-2015. Ky plan përcakton tre objektiva strategjike, si dhe aktivitetet përkatëse deri në fund të vitit 2012, sikurse në vijim:

Objektivi I: Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore

- Të informohen dhe orientohen në çdo rast viktimat për masat mbrojtëse të parashikuara në ligjin "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", me qëllim parandalimin/ reduktimin e dhunës

- Të zbatohet legjislacioni penal për çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe hetimin e plotë, objektiv e dokumentimin ligjor të këtyre rasteve dhe referimin (sipas rastit) njëkohësisht të materialeve procedurale në prokurori dhe kërkesë–padive “Për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” në gjykatë, pasi këto procedura ligjore nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën dhe garantojnë mbrojtje me të efektshme për viktimat e dhunës
- Të merren masa për plotësimin korrekt të rubrikave të kërkesë-padive për “Lëshimin e UM/UMM-ve”, duke propozuar/përcaktuar në mënyrë të efektshme masa mbrojtëse që u përgjigjen nevojave specifike të viktimës
- Të merren masa për garantimin e masave mbrojtëse në zbatim të vendimeve të dhëna nga gjykatat “Për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes/ urdhrin të mbrojtjes”
- Të merren takime me njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit, referimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje me qëllim dhënien e ndihmës dhe mbështetjes së nevojshme.
- Në këtë kontekst kërkohet sigurimi i pjesëmarrjes dhe kontributit të përfaqësuesve të policisë në Komitetin Drejtues të Bashkisë dhe Ekipit Teknik Ndërdisciplinor, të cilat do të funksionojnë në kuadër të ngritjes së sistemit të reagimit të koordinuar dhe referimit të rasteve të dhunës në familje
- Të vendoset bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse të licencuara për të ofruar ndihmë sociale dhe ligjore për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, me qëllim ofrimin nga ana e tyre të ndihmës psiko-sociale dhe ndihmës ligjore falas. Kjo do të ndihmonte gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesë-padive nga ana e gjykatës, ku një përfaqësues ligjor i këtyre organizatave të mbronte interesat e viktimave të dhunës në familje

Objekti 2: Të vazhdohen trajnimet e efektivave të policisë për t'u ardhur në ndihmë viktimave të dhunës

- Të bëhet identifikimi i nevojave për trajnim dhe kualifikim të mëtejshëm të strukturave për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve në Komisaritetet e Policisë, duke u fokusuar në: ndryshimet dhe përmirësimet legjislative lidhur me fenomenin e dhunës në familje gjatë periudhës 2010-2011; procedurat standarde që duhet të zbatohen për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe kryerjen e referimeve përkatëse.

Objekti 3: Të sistematizohet mbledhja e të dhënave të ndara sipas kategorive për DHBGJ

- Të merren masa për administrimin dhe plotësimin e “Regjistrave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje” dhe “Statistikës së dhunës në ambientet familjare” (formulari 16), sipas Urdhrit nr. 344, datë 05.10.2010 të ministrit të Brendshëm, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhritin e ministrit të Brendshëm Nr. 251, datë 15.02.2008, “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”, i ndryshuar; Për treguesit dhe rezultatet e punës, të informohet sipas kërkesave të Urdhrit nr. 1485 datë 25.11.2010 të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, “Mbi monitorimin, pasqyrimin dhe raportimin e treguesve dhe rezultateve të punës në strukturat për hetimin dhe parandalimin e krimeve”

Diskutimet cilësore përmes intervistave të thelluara, fokus grupeve dhe grupeve të diskutimit (workshops) me autoritetet dhe shoqërinë civile dalin në përfundimin se policia luan një rol kyç në adresimin e dhunës në familje. PSH-ja realizon kontaktin e drejtpërdrejtë me viktimat në më të shumtën e rasteve.

Policia bën përpjekje maksimale për të qenë e suksesshme dhe e efektshme në punën e saj. Por ky efikasitet është i ndikuar nga një kombinim faktorësh të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm: shërbimet që ofrohen, bashkëpunimi ndër-institucional, kuadri ligjor, burimet njerëzore, financiare dhe logjistike; qëndrimet personale, aftësitë dhe kapacitetet e punonjësve të policisë; qëndrimet e viktimave dhe komunitetit në tërësi. Informacion më i detajuar përshkruhet në seksionin pasues (3.3.7. *Nxitësit dhe frenuesit në efikasitetin e Policisë së Shtetit*)

Vetëvlerësimi i punonjësve të policisë është në një masë të konsiderueshme në përputhje me ato çka aktorët e tjerë konstatojnë mbi efektshmërinë e Policisë.

*“Policia bën maksimumin për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës. Në rast se më parë mendohej se, nëse shkoj në polici do të më presin egër, tani është ndryshe. Edhe trajnimet që i janë bërë policisë nga instancat e larta, kanë*

dhënë efektin e tyre, pasi dinë të trajtojnë rastet që u paraqiten.” (Bashkia Durrës)

“Suksesi i policisë... Nëse ndryshojnë mendësinë, që ata vetë ta kuptojnë se një shuplakë quhet dhunë, dhe nëse policët marrin bazën e duhur arsimore, informohen dhe trajtohen se si duhet të trajtohen këto raste, atëherë besoj se do të ketë efektshmëri.” (OJF Tiranë)

“Së bashku kemi arritur të jemi të suksesshëm në hetimin, parandalimin e dhunës dhe burgosjen e dhunuesve” (OJF Korçë)

“Në pjesën më të madhe të rasteve kur punojmë së bashku, ka pasur rezultate të mira. Por ka raste në të cilat suksesi i tyre është i kushtëzuar nga qëndrimet dhe sjellja e vetë viktimave, përderisa janë ato që shpesh tërheqin padinë.” (Bashkia Shkodër)

“Policia bën të pamundurën për të mbështetur viktimat, por ka rol të kufizuar me ligj” (OJF Tiranë)

“Policia është i vetmi autoritet në punë 24 orë/ 7 ditë në javë... asnjë autoritet tjetër nuk punon më shumë se 8 orë në ditë. Policia është ajo që i përgjigjet viktimës atëherë kur është situata më emergjente, në mes të natës...” (OJF Tiranë)

“Edhe në rastet kur incidenti i dhunës në familje është i përsëritur, policia sërish përpiqet të pajtojë çiftin...” (OJF)

“Ne i përgjigjemi rasteve kur ato na referohen. Në këtë kontekst mund të themi se ne parandalojmë fenomenin duke parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës në rastet e raportuara” (Punonjës policie)

“Dhuna në familje është reduktuar. Rastet që raportohen në polici, janë trajtuar me sukses në 80-90% të tyre... por duhet të kemi parasysh që ky është fenomen i fshehur dhe nuk denoncohet lehtë, dhe është sfidë më vete koordinimi ndërinstucional për ndërhyrjen dhe përgjigjen ndaj dhunës” (Punonjës policie)

“Seksioni për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje ka si fokus ngritjen e kapaciteteve të efektivave të policisë që përballen direkt me rastet, që në shumicën e tyre janë meshkuj, për të rritur ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin për dhunën me bazë gjinore dhe nevojat që kanë viktimat ... Kemi arritur rezultate të mira përmes punës së vazhdueshme dhe efektivat meshkuj janë të paanshëm dhe profesionalë në qëndrimet e tyre kur trajtojnë viktimat femra ... Gjithsesi, gjithnjë ka vend për përmirësim...” (Punonjës policie)

### 3.3.7. Nxitësit dhe frenuesit në efikasitetin e Policisë së Shtetit Shqiptar

Ky seksion do të japë një përmbledhje të gjetjeve nga të gjitha grupet e përfshira në studim në lidhje me faktorët nxitës dhe frenues të cilët ndikojnë në efikasitetin e Policisë së Shtetit për ofrimin e shërbimeve për të adresuar, hetuar dhe zvogëluar fenomenin e dhunës në familje dhe shkallën e koordinimit mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë, me qëllim sigurimin e trajtimit të përshtatshëm të rasteve të dhunës në familje.

Informacioni në vijim do të paraqesë pikat e forta dhe të dobëta sikurse të perceptuara nga target grupet e këtij studimi: punonjësit e policisë, autoritete të tjera, OJF-të, si dhe komuniteti urban e rural dhe viktimat e dhunës në familje, lidhur me:

- Kapacitetet e Policisë së Shtetit Shqiptar
  - Burimet njerëzore
  - Infrastruktura, burimet logjistike dhe financiare
- Faktorë të tjerë
  - Legjislacioni
  - Ofrimi i shërbimeve: të tjerët dhe PSH-ja
  - Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve



**Kapacitetet e Policisë së Shtetit Shqiptar**

Pikat e forta të përshkruara më poshtë janë kryesisht rezultat i analizës SWOT të realizuar me punonjës të policisë dhe intervistat e thelluara me PSH-në dhe, deri në njëfarë masë, janë në përputhje me vlerësimin e aktorëve të tjerë. Ndërkohë pikat e dobëta përmenden nga të gjitha target grupet.

<b>TABELA 23</b>	
<b>KAPACITETET E POLICISË SË SHTETIT LIDHUR ME BURIMET NJERËZORE</b>	
<b>Pikat e forta/ avantazhet</b>	<b>Pikat e dobëta / disavantazhet</b>
<p>Punonjës të policisë të përkushtuar dhe të angazhuar</p> <p>Inspektorë të zonave të mirinformuar në lidhje me komunitetin e zonës së tyre. Lidhje e mirë e inspektorëve të zonave me komunitetin</p> <p>Paanshmëria në trajtimin e profileve të ndryshme të viktimave dhe dhunuesve</p> <p>Punonjës policie mendjehapur, pa paragjykim</p> <p>Aftësi të përmirësuar komunikimi lidhur me situata të ndryshme sfiduese</p> <p>Informacioni mbi DHF-në është i përfshirë në programin e formimit / trajnimit policor</p> <p>Trajnime të vazhdueshme</p> <p>Në përgjithësi, punonjës policie të aftë dhe profesionistë</p> <p>Njohuri të mira mbi procedurat dhe ligjet për dhunën në familje</p> <p>Bashkëpunim i mirë i brendshëm dhe struktura funksionale organizative</p> <p>Besimi i viktimave te policia për të raportuar dhe ndjekur rastet (në rritje ndër vite)</p>	<p>Staf i mbingarkuar me shumë detyra e përgjegjësi / mungesa e SPZ-ve të fokusuar vetëm në dhunën në familje</p> <p>Numër i kufizuar i personelit (1 inspektor zone/ SPZ që merret me çdo gjë)</p> <p>Mungesa e psikologëve dhe punonjësve socialë në nivel komisarati</p> <p>Lëvizje e vazhdueshme e stafit (transferime)</p> <p>Numri i vogël i punonjësve të policisë (SPZ-ve) të gjinisë femërore</p> <p>Mungesa e shkëmbimit të përvojave me policinë e vendeve të tjera</p>
<p>Disa opinione shtesë në lidhje me kapacitetet njerëzore të policisë nga komuniteti, viktimat dhe OJF-të janë paraqitur si më poshtë:</p>	
<p>Punonjës policie të zotë dhe me kurajë (komuniteti)</p> <p>Punonjës policie altruistë dhe humanë (OJF)</p>	<p>Aftësi të pamjaftueshme kryesisht të SPZ-ve për të plotësuar kërkesën për UM apo aftësitë varfra kompjuterike(OJF)</p> <p>Ka raste të psikologëve të gjinisë mashkullore në DPQ, gjë që step viktimat (OJF)</p> <p>Sjellje joetike e disa punonjësve të policisë (viktima, komuniteti, OJF-të)</p> <p>Aftësi komunikimi dhe intervistimi të dobëta (komuniteti dhe OJF-të)</p> <p>Mentaliteti patriarkal dhe mashkullor i disa punonjësve të policisë (komuniteti dhe OJF-të)</p> <p>Kanë qëndrime diskriminuese e paragjyquese ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT</p>

*“Janë të guximshëm ... duhet guxim t'i shkosh tjetrit në shtëpi dhe të ndërhysh në punët familjare.. mund të ketë armë ose kushedi ç'mund të ndodhë...” (Femër, 35-55 vjeçe, Vlorë)*

*“Ata mund të kenë bërë trajnime, por ende nuk po e bëjnë punën siç duhet ...” (OJF dhe komunitet)*

*“Na ka ndodhur një herë të më ndalojnë mua dhe partnerin tim në komisariat. Gjatë qëndrimit kemi dëgjuar mjaft pohime etiketuese dhe diskrimuese vetëm e vetëm sepse ishim çift homoseksualësh, si p.sh.: Mos i lini ata të dy bashkë se ...” (Mashkull, 19-24 vjeç, Tiranë)*

Diskutimi mbi kapacitetet e PSH-së lidhur me infrastrukturën dhe burimet logjistike e financiare ishte një mundësi për punonjësit e policisë për të shprehur shqetësimet dhe nevojat që burojnë nga puna e përditshme dhe përballja me rastet me nevoja të shumëfishta të viktimave të dhunës në familje (shiko tabelën 24). Për më tepër të njëjtat nevoja janë përmendur edhe nga OJF-të dhe komuniteti.

**TABELA 24**  
**KAPACITETET E POLICISË SË SHTETIT LIDHUR ME**  
**INFRASTRUKTURËN, BURIMET LOGJISTIKE DHE FINANCIARE**

<b>Pikat e forta/ avantazhet</b>	<b>Pikat e dobëta / disavantazhet</b>
<p>Mbulim i plotë geografik i të gjithë vendit me anë të 43 komisariateve</p> <p>Nisma pozitive të realizuara me mbështetjen e Ambasadës së Francës për të ngritur ambiente/ dhoma miqësore për fëmijët në dy komisariate, si dhe plane për ta zgjeruar këtë nismë edhe në komisariate të tjera me mbështetjen e “Save the Children”</p>	<p>Mungesa në komisariate e hapësirës/ dhomave për intervistimin individual, të përshtatshme dhe miqësore për viktimat e dhunës dhe fëmijët, që sigurojnë një hetim të saktë dhe ruajtje të privatësisë</p> <p>Numër i kufizuar i kompjuterave dhe pajisjeve të tjera teknike, materialeve kancelarike</p> <p>Pamjaftueshmëri e automjeteve dhe karburantit në dispozicion (shpesh përdoren automjetet personale për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit)</p> <p>Nuk ka buxhet të veçantë për nevojat specifike të dhunës në familje dhe për aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin (është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të departamentit / sektorit)</p> <p>Mungesa e një fondi emergjence për të mbuluar nevojat emergjente të viktimave të DHF-së, si p.sh.: nevoja ushqimore, produkte për bebe, transportin për rastet emergjente etj. (ndodh shpesh që punonjësit e policisë ua plotësojnë këto nevoja viktimave nga xhepi i tyre)</p> <p>Jo në përputhje me zhvillimet e fundit të teknologjisë</p>

*“Ka raste që policia është e shpejtë, dhe në raste të tjera jo. Komisarati nuk është afër fshatrave. Nuk ka infrastrukturë të mirë rrugore...” (Femër, 36-55 vjeçe, Durrësi rural)*

*“Dhoma të veçanta për gratë dhe fëmijët ka vetëm në Drejtorinë Rajonale të Policisë të Tiranës dhe në komisaratin e Kamzës dhe Kavajës” (Punonjës policie)*

*“Po ne kemi 1 kompjuter për 6 veta... Si t'i mbarojmë gjithë ato punë, letra?” (Punonjës policie)*

*“Ka plot raste që policët blejnë me lekët e tyre bukë për viktimat apo edhe pampers, se ka nga ato me fëmijë të vegjël... duhet të ketë ndonjë buxhet vetë policia për këto raste”. (OJF-të)*

**Faktorë të tjerë**

Puna dhe efektiviteti i PSH-së ndikohet edhe nga faktorë të tjerë, si: legjislacioni, shërbimet aktuale për viktimat dhe dhunuesit, si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional. Për këtë arsye, më poshtë do të listohen pikat e forta dhe të dobëta, sikurse janë perceptuar nga aktorë të ndryshëm (policia, autoritete të tjera, OJF-të, komuniteti dhe viktimat) për secilën nga këto fusha.

**Faktorë të tjerë - Legjislacioni dhe zbatimi i tij**

<b>TABELA 25 LEGJISLACIONI DHE ZBATIMI</b>	
<b>Pikat e forta/ avantazhet</b>	<b>Pikat e dobëta / disavantazhet</b>
<p>Ekzistenca e një kuadri ligjor thelbësor dhe bashkëkohor në lidhje me dhunën në familje (Ligjet dhe aktet normative, Strategjitë Kombëtare për Barazi Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje, Punësimin etj)</p> <p>Ndryshimet në Ligjin "Për masat ndaj Dhunës në Familje", veçanërisht VKM-ja nr.334, datë 17/02/2011 për ngritjen e mekanizmit kombëtar të referimit për rastet e DHF-së</p> <p>Kriminalizimi i dhunës në familje (ndryshimet e fundit në Kodin Penal me dispozitat e nenit 121/ a, 124/ b dhe neni 130/ a, të cilat adresojnë më mirë çështjet e dhunës në familje dhe sigurojnë masa më kufizuese ligjore për dhunuesit. Tani DHF-ja konsiderohet si një vepër penale dhe si e tillë dënohet me burgim, ndërsa gjobitja nuk parashikohet më si masë ligjore)</p> <p>Ligji ofron shërbime të veçanta për viktimat, si p.sh.: ndihmë ligjore falas, nxjerrjen e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes brenda 24 orëve për të miturit, përjashtimin e paditësit nga detyrimi për të paguar shpenzimet gjyqësore, ndihmë ekonomike gjatë periudhës së vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes etj.</p> <p>Përkufizimi i gjerë i "anëtarëve të familjes" nga ligji shqiptar</p> <p>Mbrojtje më të mirë ligjore për të miturit të cilët janë autorë të veprave penale: një fëmijë nën 14 vjeç nuk mund të procedohet ligjërisht, qoftë edhe për një vrasje. Nëse fëmija është mbi 14 vjeç, niveli i dënimit është i përgjysmuar krahasimisht me një të rritur. Ka disa hapa që ndiqen: shërbimi i provës, dënimi me kusht.</p> <p>Legjitimiteti i policisë për të kërkuar urdhër mbrojtjeje për të miturit</p> <p>Kur kërkesa është paraqitur nga policia, dëshira e viktimës për të hequr dorë nga çështja, nuk ka efekt mbi vazhdimin e procesit gjyqësor</p>	<p>Ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nuk bëhen paralelisht</p> <p>Përkufizimi në ligj i "anëtarit të familjes" nuk përfshin partnerët e së njëjtës gjini dhe ata që nuk janë të martuar apo nuk bashkëjetojnë me të tjerët (të dashur apo partnerë intímë). Kjo është shumë e rëndësishme, sidomos për të rinjtë që janë në një marrëdhënie dhe janë të pambrojtur ndaj çdo lloji të dhunës familjare. Veç kësaj, marrëdhëniet e së njëjtës gjini nuk janë të legjitimuara. Kodi i Familjes e përkufizon bashkëjetesën vetëm mes një burri dhe një gruaje. Për pasojë, ligji nuk siguron mbrojtje ligjore për këto kategori.</p> <p>Rrahja nuk është e përkufizuar qartë në Kodin Penal.</p> <p>Tortura nuk parashikohet në Kodin Penal si një formë e dhunës në familje</p> <p>Mungesa e strehëzave për viktimat deri në lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes siç është përcaktuar nga ligji (një vakuum 48-orësh për situatat emergjente)</p> <p>Nuk ka ndëshkim të rëndë për dhunuesit që thyejnë UM / UMM-të</p> <p>Ligji nuk përcakton sigurimin e shpenzimeve gjyqësore falas në rastet e divorcit për viktimat e dhunës në familje</p> <p>Ka mungesë fondesh publike për zbatimin e ligjeve dhe strategjive</p> <p>Roli i kufizuar i policisë në ekzekutimin e UM-ve dhe UMM-ve sipas parashikimit të ligjit</p> <p>Zbatim i dobët i ligjeve në fuqi (a)</p>

(a) Sqarime të mëtejshme për këtë çështje do të ketë në vijim: shërbimet e ofruara dhe bashkëpunimin ndërinstytucional

**Faktorë të tjerë - Shërbimet e ofruara aktualisht**

Intervistat e thelluara me OJF-të, por jo vetëm, treguan se viktimat mbështetjet më shumë sesa dhunuesit me shërbime.

Format kryesore të mbështetjes që OJF-të u sigurojnë viktimave të dhunës në familje janë: mbështetja psikologjike, mbështetja mjekësore, strehimi, ndërhyrja për punësim, trajnimet profesionale, mbështetja ligjore dhe mbështetja urgjente materiale.

Shërbimet për dhunuesit mungojnë dhe në përgjithësi janë të kufizuara me këshillime ose mbështetje mjekësore në rastet e problemeve të shëndetit mendor.

Pothuajse të gjitha institucionet, individët, viktimat e dhunës në familje deklarojnë se shërbimet më të nevojshme për viktimat e dhunës në familje janë punësimi dhe strehimi. Shumë prej institucioneve deklarojnë se aktivitetet për mbështetjen e dhunuesve duhet të jenë në shkallë më të gjerë dhe kjo të realizohet në bashkëpunim me institucione të ndryshme.

**TABELA 26 A**  
**SHËRBIMET E OFRUARA – INSTITUCIONET TË TJERA**

<b>Pikat e forta / avantazhet</b>	<b>Pikat e dobëta / disavantazhet</b>
<p>OJF aktive në ofrimin e shërbimeve</p> <p>Qendra kombëtare për viktimat e dhunës në familje</p> <p>Strehim në apartamente të dhëna me qira nga bashkitë (Korça dhe Durrësi)</p> <p>Linja telefonike rajonale falas për dhunën në familje (Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës)</p> <p>Linja "ALO 116" për fëmijët</p> <p>Ofrohen shërbime mbështetëse për fëmijët: organizata për zgjidhjen e konflikteve; programe rehabilitimi për të miturit me probleme me ligjin</p> <p>Aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit në shkollë, qendra shëndetësore, komunitet</p> <p>Trajnim i specialistëve të ndryshëm që merren me dhunën në familje (përmbartues, punonjës të policisë, stafi shëndetësor, media, magistratë)</p> <p>Mbështetje e fortë financiare nga ndërkombëtarët dhe programet e Kombeve të Bashkuara (UNDP, UNICEF, OSBE/ODHIR, "World Vision", "Save the Children" etj.)</p> <p>Fëmijët që janë viktimat të dhunës në familje, asistohen gjithnjë nga një psikolog</p>	<p>Strehëzat: numër i kufizuar; kapacitet i kufizuar në ato ekzistuese, mungesë e strehëzave për rastet urgjente dhe ato afatgjata në veri të vendit</p> <p>Urdhra mbrojtjeje të paefektshëm dhe të pazbatueshëm (viktimat dhe dhunuesit në shumë raste ndajnë të njëjtën banesë, pasi nuk ka strehëza apo vende të tjera alternative ku mund të qëndrojnë viktimat; bashkëshorti është dhunuesi dhe viktimat jeton me vjehrrin e vjehrrën)</p> <p>Ka raste që urdhrat e mbrojtjes nuk lëshohen për shkak të mungesës së provave; ose nuk ekzekutohen gjithnjë nga zyra e përmbartimit</p> <p>Pamjaftueshmëri punësimi dhe trajnimesh profesionale për viktimat e dhunës në familje</p> <p>Nuk ka shërbime 24-orëshe për viktimat</p> <p>Mosfunksionim ose mungesë e linjave telefonike rajonale 24-orëshe të lidhura me policinë lokale, shërbimet e urgjencës mjekësore dhe OJF-të</p> <p>Nuk ka ndihmë ligjore falas nga shteti në rastet e divorcit të viktimave të dhunës në familje</p> <p>Ka pak raste të viktimave të mbështetura me asistencë ligjore falas (për të siguruar mbrojtjen e viktimës në seancën gjyqësore)</p> <p>Qendrat shëndetësore dhe/apo shërbimet e urgjencës nuk i sigurojnë gjithnjë viktimës raportin mjekësor të nevojshëm për t'u përdorur si provë në seancë gjyqësore për UM/UMM-të</p> <p>Asistenca ekonomike për viktimat nuk sigurohet gjithnjë ose ka vonesa të konsiderueshme</p> <p>Sasi e pamjaftueshme e asistencës ekonomike të përcaktuar për viktimat</p> <p>Shpërndarje e pamjaftueshme e informacionit lidhur me procedurat që duhet të ndiqen kur denoncohen rastet e dhunës në familje</p> <p>Në rastet e thyerjes së UM/ UMM-ve nga dhunuesi, nuk ka një ndjekje të duhur me veprime ligjore</p> <p>Mungesë e shërbimeve për dhunuesit: rehabilitim ose shërbime psiko-sociale (shumë pak nisma të ndërmarrura nga OJF-të)</p>

**TABELA 26 B**  
**SHËRBIMET E OFRUARA NGA POLICIA**

Pikat e forta / avantazhet	Pikat e dobëta / disavantazhet
Shërbim 24-orësh nga e hëna në të dielë	Megjithëse ngjarja (DHF) mund të jetë e përsëritur, qëllimi i policisë vijon të mbetet fillimisht pajtimi i palëve
Përgjigje e shpejtë e çdo rasti të raportuar (129 dhe patrulla e policisë)	Viktimës nuk i sigurohet gjithnjë informacion për ligjin dhe masat e mbrojtjes
Përpjekje të mëdha për të këshilluar dhe pajtuar palët e përfshira para se të fillojë ndjekja e hapave ligjorë	Jo gjithnjë ruhet fshehtësia për burimin e informacionit (i cili i bëhet i ditur dhunuesit)
Dokumentim i saktë i rasteve	Ka raste kur punonjësitë policisë nuk paraqiten të dëshmojnë në seancat gjyqësore kur është e nevojshme
Mbledhje e informacionit për rastet e dhunës në familje përmes burimeve të ndryshme, përfshirë edhe takimet me autoritetet lokale	
Punonjësit e policisë ndihmojnë viktimat në përgatitjen e kërkesës për UM/UMM-të	
Policia e Shtetit ndihmon përmbauesit në ekzekutimin e UM-ve dhe UMM-ve	
Transportimi dhe shoqërimi i viktimave në qendrat shëndetësore, strehëza, OJF-të	

*“Nuk ka strehëza të mjaftueshme për të siguruar një mbulim gjeografik kombëtar. Rreth 200-300 viktima janë të detyruara të qëndrojnë me dhunuesin”. (OJF)*

*“Strategjitë për shtëpitë me qira nuk janë një zgjidhje e mirë, sepse në shumicën e rasteve viktimat janë të papuna dhe nuk mund të përballojnë edhe mbulimin e shpenzimeve për shtëpinë”(OJF)*

*“Viktimave duhet t’u jepet një asistencë ekonomike prej 3 000 lekësh nga qeveria lokale. Por, kur viktimat paraqiten në zyrat e tyre, justifikimi është se buxheti për gjashtëmujorin përkatës tashmë është i mbyllur”. (OJF)*

*“Inspektori i zonës vinte çdo ditë për të parë nëse situata në familje ishte e qetë...” (Viktimë, Shkodra rurale)*

*“Durrësi nuk ka strehëz. Jemi të detyruar t’i kërkojmë strehëzës së Elbasanit (Tjetër Vizion) që të presë viktimat” (Përfaqësues i OJF-së)*

*“Spitali psikiatrik ofron shërbim për viktimat me probleme të shëndetit mendor duke i shtruar dhe mjekuar” (Punonjës të policisë së Vlorës dhe Shkodrës)*

### **Faktorë të tjerë - Bashkëpunimi ndërinstytucional**

Aktorë të ndryshëm shprehen se mes tyre ka një bashkëpunim të rregullt dhe të kënaqshëm. Ka një angazhim ndër autoritetet përgjegjëse për DHF-në, për të bashkëpunuar efektivisht. Gjithsesi, secili përmend vështirësi të ndryshme që ndikojnë në cilësinë e bashkëpunimit e, si rrjedhojë, edhe në përgjigjen e duhur ndaj viktimave të dhunës në familje.

**TABELA 27**  
**BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL**

Pikat e forta/avantazhet	Pikat e dobëta/disavantazhet
<p>Vendosja e mekanizmit të referimit në 20 bashki</p> <p>Marrëveshje mirëkuptimi mes autoriteteve dhe autoritetet me OJF-të</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi mes PSH-së dhe aktorëve të ndryshëm (ministrive, bashkive, OJF-ve etj.)</p> <p>Rritje e kontrollit të strukturave vertikale brenda autoriteteve, të cilat ndikojnë në cilësinë e bashkëpunimit ndërinstytucional</p> <p>Punë e mirëkoordinuar mes OJF-ve</p> <p>Ngritja e Njërive për Mbrojtjen e të Miturve në bashki dhe komuna</p> <p>Roli i medias për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e publikut</p> <p>Policia i ofron statistika MPÇSSHB-së dhe autoriteteve të tjera</p>	<p>Boshllëqe në ofrimin e shërbimeve, sidomos në nivelin lokal</p> <p>Burime të kufizuara njerëzore dhe financiare ndër autoritete të ndryshme</p> <p>Infrastrukturë dhe logjistikë e kufizuar</p> <p>Sisteme referimi të pangritura mirë. Grupet multidisiplinare nuk janë gjithnjë të përcaktuara / organizuara, sidomos për trajtimin e rasteve të vështira</p> <p>Specialisti në bashki ka një fushë të gjerë përgjegjësish, duke mbuluar shërbimin social në përgjithësi, përfshi këtu edhe dhunën në familje dhe barazinë gjinore</p> <p>Prokuroria shpesh ndërhyt vetëm në rastet kur viktimat ka pësuar dëme fizike</p> <p>Mungesë e trajnimeve të përbashkëta me pjesëmarrjen e specialistëve nga institucione të ndryshme</p> <p>Mungesë e një shkëmbimi të rregullt informacioni gjatë trajtimit të një çështjeje</p> <p>Administratorët lokalë në Sektorët për Mbrojtjen e të Miturve nuk po luajnë rol në përgjigjen ndaj rasteve</p> <p>Nuk ka staf të specializuar për t'u marrë me kategori të ndryshme të viktimave të dhunës në familje (fëmijë, të moshuar, me probleme të shëndetit mendor etj.)</p> <p>Paraqitja joetike e të dhënave personale të viktimave nga media</p> <p>Komuniteti nuk është shumë aktiv në referimin e rasteve të dhunës në familje</p>
<p><b>Si pasojë ka një rritje të ndërgjegjësimit të publikut për dhunën në familje, raportimin zyrtar të dhunës në familje, rritje të cilësisë për menaxhimin e rasteve dhe rezultate më pozitive.</b></p>	

### 3.4. NEVOJA PËR PËRMIRËSIME TË MËTEJSHME

Target grupe të ndryshme konkludojnë në një sërë nevojash dhe sugjerimesh për një përmirësim të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të tij, bashkëpunimit mes institucioneve dhe shërbimeve për viktimat dhe dhunuesit, sikurse vijon më poshtë. Mbi të gjitha, bashkëpunimi dhe shërbimet janë fushat më kryesoret ku, sipas tyre, ka hapësirë për ndryshime thelbësore.

#### 3.4.1. Nevojat: Legjislacioni, bashkëpunimi ndërinstytucional, shërbimet

TABELA 28

#### NEVOJAT: LEGJISLACIONI, BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE SHËRBIMET

LEGJISLACIONI	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL
<p>Ligji duhet të jetë më i ashpër për dënimin e dhunuesve dhe atyre që thyejnë UM/UMM-të</p>	<p>Bashkëpunimi ndërinstytucional duhet të forcohet dhe përmirësohet edhe më tej</p>
<p>Ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duhet të realizohen paralelisht</p>	<p>Duhet të rritet roli i bashkive për adresimin e rasteve të dhunës në familje</p>
<p>Masat për mbrojtje ligjore në kuadër të Ligjit për Dhunën në Familje duhet të përfshijnë edhe partnerë të së njëjtës gjini, si dhe ata që nuk janë të martuar apo që nuk bashkëjetojnë (të dashur ose partnerë intimë)</p>	<p>Të shtohen burimet njerëzore, logjistike dhe financiare për dhunën në familje në institucione të ndryshme</p>
<p>Ekzekutimi i UM-ve dhe UMM-ve duhet të përcaktohet më qartë në vendimet e gjykatës dhe të zbatohet nga policia si i vetmi autoritet i besueshëm dhe efektiv (OJF-të)</p>	<p>Të ngrihen kapacitetet e specialistëve të ndryshëm në nivele dhe institucione të ndryshme, përfshirë edhe median</p>
<p>Strehëzat për viktimat e dhunës në familje duhet të përcaktohen në ligj</p>	<p>Stafe të specializuara për t'u marrë me kategori të ndryshme të viktimave të dhunës në familje (fëmijë, të moshuar, me probleme të shëndetit mendor etj.)</p>
<p>Procedurat e divorcit që kryhen nga viktimat e dhunës duhet të ofrohen falas dhe kjo duhet të sanksionohet me ligj</p>	<p>Bashkia duhet t'i konsiderojë gratë si kryefamiljare dhe si një target-grup parësor për t'u siguruar një banesë sociale</p>
<p>Ligji duhet zbatuar rreptësisht nga të gjitha autoritetet përgjegjëse, veçanërisht në ato raste kur urdhri i mbrojtjes / urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes nuk zbatohet nga dhunuesi</p>	<p>Shtim i aktiviteteve nga OJF-të dhe autoritetet lokale për rritjen e ndërgjegjësimit</p> <p>Forcim i bashkëpunimit me komunitetin duke organizuar takime informale me gratë, burrat, të rinjtë dhe fëmijët</p> <p>Çështjet e strehimit duhet të adresohen vetëm nga qeveria lokale</p>

SHËRBIMET PËR VIKTIMAT	SHËRBIMET PËR DHUNUESIT
<p>Të ketë buxhet publik të dedikuar për viktimat e dhunës në familje</p> <p>Sigurimi (de facto) i asistencës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje në të gjithë hapat, siç është sanksionuar në ligj</p> <p>Integrimi social i viktimave duhet përmirësuar: punësimi, strehimi, trajnime profesionale. Rritje e praktikave të punësimit të viktimave, forcim i bashkëpunimit me kompanitë / bizneset private dhe mbështetje më e madhe nga shteti për këtë kategori</p> <p>Numri i strehëzave duhet rritur për të bërë të mundur plotësimin e nevojave të të gjitha viktimave</p> <p>Duhen ngritur strehëza emergjence për t'iu përgjigjur menjëherë situatave me rrezik jetësor të viktimave</p> <p>Nga përmbauesit duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë zbatimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore (UMM-ve dhe UM-ve)</p> <p>Duhet të ngrihen dhe funksionojnë linjat telefonike 24-orëshe</p> <p>Ndihmë ekonomike për viktimat, sidomos kur janë gra dhe fëmijë</p> <p>Rritja e mbështetjes psikologjike për viktimat</p> <p>Një raport për vlerësim psikologjik gjatë seancave gjyqësore duhet të jetë i detyrueshëm</p> <p>Ngritja e një qendre për mbështjen e fëmijëve të dhunuar.</p>	<p>Qendra rehabilitimi, sidomos për ata që kanë varësi nga alkooli dhe droga</p> <p>Qendra për trajtimin psikologjik të dhunuesve, sidomos të atyre që kanë pasur histori abuzimi në fëmijërinë e tyre</p> <p>Ekspertizë klinike për dhunuesit</p> <p>Duhet të sigurohen shërbime mbështetëse punësimi</p>

### Disa nevoja për aktivitete mbështetëse me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit:

- Rritje e ndërgjegjësimit mbi dhunën në familje duke adresuar zakonet patriarkale dhe doket kulturore që lidhen me fenomenin e dhunës në familje
- Të ketë aktivitete të vazhdueshme për rritjen e ndërgjegjësimit, jo thjesht të përqendruara në 16-ditëshin e aktiviteteve kundër dhunës ndaj grave (25 nëntor – 10 dhjetor)
- Rritje e ndërgjegjësimit për ligjet në fuqi (ligjet e reja, ndryshimet dhe shtesat) ndër komunitetin e profesionistëve dhe publikun e gjerë

### 3.4.2. Perspektiva e komunitetit mbi shërbimet e dobishme dhe aktivitetet për luftimin e dhunës në familje

Sikurse vihet re edhe nga tabela 29, të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e listuara vlerësohen nga komuniteti urban dhe rural i pesë qarqeve të përfshira në studim, si të dobishme për të luftuar fenomenin e dhunës në familje. Zbatimi i ligjit aktual, ndëshkimi i dhunuesve, ligje më të rrepta dhe sigurimi i linjave telefonike falas për të kërkuar



ndihmë dhe këshillim janë nga sugjerimet kryesore të të anketuarve; të ndjekura më pas nga edukimi i hershëm i të rinjve dhe rritja e ndërgjegjësimit publik mbi dhunën në familje dhe reagimin zyrtar për të.

<b>TABELA 29 AKTIVITETE DHE SHËRBIME TË DOBISHME PËR TË LUFTUAR DHUNËN NË FAMILJE</b>	<b>n=570</b>
Pasja e një linje telefoni falas për viktimat që kërkojnë ndihmë dhe këshillim	97.7
Pasja e një faqeje interneti për viktimat/ të dhunuarit që kërkojnë ndihmë dhe këshillim	81.6
Shpërndarja e fletëpalosjeve në çdo banesë	92.2
Pasja e ligjeve më të forta/më të rrepta	97.5
Zbatimi i ligjeve ekzistuese	98.0
Trajnimi i punonjësve të policisë për njohjen më të mirë të të drejtave të viktimave	95.0
Kryerja e fushatave për rritjen e njohurive në komunitet mbi dhunën në familje dhe reagimin zyrtar	96.1
Dënimi i dhunuesve	98.1
Ngritja e programe kuruese/trajtoese (rehabilituese) për abuzuesit / dhunuesit	94.1
Edukimi i nxënësve e studentëve për respektimin e njëri-tjetrit (në shkolla)	97.1

# ***KAPITULLI 4***

# **PËRFUNDIMET**

Ky kapitull paraqet përfundimet që derivojnë nga gjetjet e hapave të ndryshëm të studimit (kërkimi cilësor, sasior dhe rishikimi i dokumentacionit e të dhënave të tjera).

Fenomeni i dhunës në familje mbetet një problem shqetësues dhe i përjetuar nga gati gjysma e popullatës urbane e rurale në qarqet e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës. Dhuna në familje pësohet më shumë nga femrat sesa nga meshkujt, nga të rinjtë deri në 24 vjeç më shumë sesa ata mbi 24 vjeç. Shumica e viktimave janë me arsim bazë ose të mesëm, të papunë, të martuar dhe jetojnë në familje të mëdha me të ardhura të pakta mujore. Bazuar në deklaratat personale të banorëve të këtyre pesë qarqeve, dhuna në familje ka ndodhur më tepër mes banorëve në qarkun e Durrësit, Tiranës dhe Vlorës sesa në atë të Korçës dhe Shkodrës. Kjo mund të jetë rezultat i popullatës më konglomerate, me banorë të rinj të ardhur pas viteve '90 në Tiranë, Durrës e Vlorë. Nga ana tjetër, Durrësi e Vlora janë qytete portuale, çka krijon një tjetër dinamikë të zonës. Kurse Shkodra dhe Korça janë zona më tradicionale dhe më tepër praktikantë të besimit fetar. Sipas deklaratave të komunitetit, forma më e përhapur e dhunës në familje është ajo emocionale, pasuar nga dhuna psikologjike. Të dyja këto forma shihen si më "të lehta", më të zakonshme, të pranueshme dhe gati të pashmangshme në jetën familjare, si pasojë janë edhe format me më pak gjasa për t'u raportuar. Dhuna fizike është deklaruar të jetë përjetuar nga më pak njerëz, dhuna seksuale nga akoma edhe më pak. Të dyja këto forma shihen si më "të rënda", por stigma që i shoqëron ato është e lartë, ndaj edhe këtu gjasat e raportimit janë të ulta, por gjithsesi më të larta sesa abuzimi emocional e psikologjik.

Grupet më të riskuara nga dhuna në familje rezultojnë të jenë:

- Fëmijët, si pasojë e pafuqisë së tyre dhe botëkuptimit prindëror në lidhje me pranueshmërinë e dhunës
- Gratë, për shkak të fuqisë fizike të kufizuar, mentalitetit dominues mashkullor dhe pamundësisë për pavarësi ekonomike
- Të moshuarit, kryesisht pre e shfrytëzimit ekonomik nga fëmijët e tyre
- Familjet që jetojnë në varfëri
- Komuniteti rom dhe egjiptian, pasi dhuna në familje jo vetëm shihet si një sjellje relativisht e pranueshme, por edhe sepse rëndësia e saj zbehet prej diskriminimit shoqëror dhe problemeve të shumta social-ekonomike që kanë këto komunitete.

Bazuar në të dhënat zyrtare të PSH-së, dhunuesit janë kryesisht meshkuj, bashkëshortët e viktimave, kurse gratë dhunuese të bashkëshortëve janë raste shumë të pakta. Prindërit që dhunojnë fëmijët janë raste më të shpeshta sesa fëmijët që dhunojnë prindërit (kryesisht këta të fundit të moshuar).

Për t'iu përgjigjur këtij fenomeni, shteti shqiptar ka hartuar ligje dhe akte nënligjore të posaçme, strategji të ndryshme dhe plane veprimi përkatëse, dhe mund të thuhet që kuadri legjislativ është përgjithësisht i kompletuar. Në zbatim të këtij legjislacioni ka një varg institucionesh përgjegjëse për parandalimin, trajtimin dhe luftën kundër dhunës në familje. Në nivel qendror autoriteti përgjegjës kryesor është MPCSSH-bja dhe në nivel lokal janë njësitë vendore (bashki e komuna) për menaxhimin konkret të rastit. Roli i Policisë së Shtetit sipas ligjit është më dytësor, pavarësisht rëndësisë që ka përgjigja fillestare nga ky autoritet, kur denoncohet një rast i tillë.

Komuniteti deklaron se ka dijeni për ekzistencën e ligjeve, por ata nuk kanë informacion konkret apo të detajuar për përmbajtjen e tyre. Më së shumti ata presin që për dhunën në familje, sikurse për plagë të tjera të shoqërisë, shteti të ketë mjete ligjore në dispozicion. Burimet kryesore të informacionit për komunitetin mbeten media, kryesisht televizioni, dhe rrethi personal familjar e shoqëror. Vihet re se komuniteti urban e rural njeh si autoritetin kryesor përgjegjës për të parandaluar fenomenin dhe për të mbështetur viktimat e dhunës në familje Policinë e Shtetit, dhe më pas sistemin e drejtësisë (gjykatat dhe prokurorinë).

Pavarësisht se pjesa më e madhe e komunitetit të këtyre pesë qarqeve deklaron se dhuna në familje është gjithmonë e papranueshme dhe duhet raportuar, rezulton se pjesa më e madhe e atyre që përjetojnë incidente të tilla preferojnë ta mbajnë të fshehtë. Gati çereku i viktimave pranon ta diskutojë këtë rast, kryesisht me familjarët, të afërmit apo miqtë. Vetëm një pjesë e vogël e viktimave të dhunës në familje (4%) e denoncojnë rastin e tyre në polici. Në të tilla raste, përgjithësisht, ato janë viktimat të formave të shumfishta të dhunës dhe serioze, si dhe e përjetojnë për një kohë të gjatë.

Ka një sërë arsyesh sociale, kulturore e psikologjike që ndikojnë në mosraportimin e incidenteve të dhunës në familje. Arsyeja më kryesore e mosraportimit të këtyre rasteve është shkalla e ashpërsisë së rastit, e perceptuar si e ulët. Pra, viktimat të cilat zakonisht pësojnë abuzim emocional dhe/ose psikologjik, kanë prirjen të durojnë dhe justifikojnë incidentin dhe të mos e raportojnë tek autoritetet. Arsyeja e dytë më kryesore është qëndrimi i viktimave duke e trajtuar këtë rast vetëm si çështje familjare, e cila duhet të mbetet e tillë dhe të zgjidhet brenda familjes. Dhe arsyeja e tretë kryesore e mosraportimit është shpresa që kanë këta individë se rasti i dhunës do të jetë i izoluar, dhe jo i përsëritur. Për më tepër, vetë komuniteti ka më pak të ngjarë ta nxisë raportimin zyrtar te policia, pavarësisht nivelit të lartë të besimit ndaj këtij autoriteti.

Nxitësit kryesorë për të denoncuar rastet e dhunës në familje duket se janë situatat me risk të lartë të jetës personale ose anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe siguria në ekzistencën e masave mbrojtëse efektive, si: UMM / UM-të, dhe shërbimeve mbështetëse për viktimat, si: strehimi, punësimi etj.

Duke pranuar nivelin e ulët të raportimit / denoncimit përballë frekuencës së fenomenit, institucione të ndryshme, si: MPÇSSH-bja, bashkitë, OJF-të në iniciativa individuale dhe/ose në bashkëpunim mes tyre dhe institucioneve të tjera, përfshi këtu policinë, kanë ndërmarrë fushata ndërgjegjësuese të herëpashershme. Si pasojë e masave ligjore dhe kësaj veprimtarie ndërgjegjësuese me komunitetin, mund të thuhet se ka një rritje të numrit të raportimit të rasteve të dhunës në familje nga viti në vit në të gjitha zonat, sikurse tregojnë të dhënat zyrtare të PSH-së. Pavarësisht këtij progresi, zonat rurale dhe ato veriore mbeten më problematike në drejtim të denoncimit të fenomenit.

Pjesa më e madhe e komunitetit urban dhe rural të këtyre pesë qarqeve e cilëson Policinë si autoritetin më të besueshëm për të raportuar incidentet e dhunës në familje. Kjo shpjegohet me imazhin dominues pozitiv që ky komunitet ka për PSH-në në përgjithësi, si një autoritet që ofron mbrojtje, qetësi, rend, siguri dhe zbatimin e ligjeve nëpërmjet punonjësve të përkushtuar, gjithnjë të gatshëm, të komunikueshëm dhe të respektuar nga vetë komuniteti.

Disa nga detyrat kryesore të Policisë së Shtetit në rastet e dhunës në familje janë krijimi i strukturave përkatëse dhe trajnimi i stafit, përgjigjja ndaj çdo rasti të raportuar për dhunë në familje, informimi dhe mbështetja e viktimave, si dhe mbështetja ndaj autoriteteve si prokuroria apo zyrat e përmbartimit, sipas rastit. Por viktimat e dhunës në familje dhe komuniteti në përgjithësi besojnë se në të tilla raste policia duhet t'u ofrojë atyre më shumë shërbime, si: strehim, punësim etj., çka në realitet i tejkalon kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të policisë. Ndërgjegjësimi i ulët i komunitetit mbi autoritetet përgjegjëse për adresimin e rasteve të dhunës në familje, si bashkitë dhe komunat, prania e dukshme e PSH-së në komunitet, besimi tek uniformat blu dhe shërbimi 24 orë në ditë 7 ditë në javë, bën që policia të presë pjesën dërrmuese të rasteve të dhunës në familje dhe pikërisht në momentet më kritike të çështjes. Sikurse disa njerëz deklarojnë, ka raste si demonstratat, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor etj. kur policia vepron si "ndëshkues" duke shkaktuar ndjesi jo pozitive tek njerëzit dhe duke ndikuar negativisht në opinionin e tyre për policinë.

Policia rezulton të jetë e efektshme dhe e suksesshme në plotësimin e rolit dhe përgjegjësi të saja ligjore, sikurse pohon komuniteti dhe institucionet e ndryshme të përfshira në këtë studim. Për më tepër, policia ka arritur të ofrojë një bashkëpunim të mirë ndër-institucional dhe mbështetje të kënaqshme ndaj viktimave duke shfrytëzuar pikat e saj të forta: mbulim total të vendit, strukturë të mirorganizuar që trajton rastet e dhunës në familje, detyra e përgjegjësi të mirëpërcaktuara e të qarta në çdo nivel të PSH-së, punonjës të devotshëm, të angazhuar, guximtarë, altruistë, me njohuri të mira në këtë fushë, që marrin trajnime të herëpashershme dhe me lidhje të forta me komunitetin.

Nga ana tjetër, roli më i gjerë i pritur nga policia prej komunitetit nxjerr në pah një sërë nevojash aktualisht të pambluara në drejtim të burimeve njerëzore, logjistike, financiare dhe infrastrukturës për këtë autoritet. Disa prej tyre janë: rishikimi i numrit të punonjësve që merren me çështjet e dhunës në familje dhe detyrave e përgjegjësi të tyre, qëndrueshmëria në pozicionin e caktuar të specialistëve dhe balanca gjinore e stafit, trajnimi i vazhdueshëm i tyre, përmirësimi i infrastrukturës dhe organizimit të hapësirave, shtimi i burimeve logjistike dhe pajisjeve teknologjike, rritja e buxhetit të dedikuar për shërbimet dhe aktivitetet ndërgjegjësuese, parandaluese etj. mbi dhunën në familje.

Sikurse është përcaktuar edhe në ligj, policia është një nga aktorët që trajton çështjet e dhunës në familje, dhe

për të çuar përpara punën e saj, ka nevojë që çdo institucion të realizojë detyrat e përgjegjësitë vetkaje, sikurse ka nevojë dhe për bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe me vetë komunitetin. Ministrinë e linjës, qeveria vendore, OJF-të, sistemi i drejtësisë e përshkruajnë policinë si aktorin kryesor në kontaktin e drejtpërdrejtë dhe fillestar me viktimat e dhunës në familje. Ato e cilësojnë bashkëpunimin me policinë si të kënaqshëm në drejtim të raportimeve, shkëmbimeve të statistikave, përgjigjes së menjëhershme kur kërkohet mbështetja e tyre, pjesëmarrja në aktivitetet ndërgjegjësuese etj. Për më tepër, theksohet se PSH-ja bën përpjekjet maksimale për të arritur rezultatin më të lartë në reduktimin e fenomenit pavarësisht burimeve të kufizuara që ka në dispozicion.

Nga ana e saj, policia njih vullnetin e institucioneve për bashkëpunim, por punonjësit e policisë shprehin disa rezerva në lidhje me zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësi që ligji u ka sanksionuar autoriteteve të tjera për t'iu përgjigjur si duhet dhe në kohë viktimave të dhunës në familje. Disa nga shqetësimet e shprehura që ndikojnë pashmangshmërisht cilësinë e menaxhimit të rastit, si dhe efektivitetin e punës së policisë janë të lidhura me kufizimet kohore të shërbimeve ekzistuese (p.sh. linjat e këshillimit, oraret e institucioneve publike); mbulimi i pjesshëm gjeografik i vendit me shërbime nga autoritete të tjera (p.sh. strehëzat); zbatimi i pjesshëm i detyrave dhe rolit të përcaktuar nga ana e institucioneve të tjera (p.sh. ngritja e mekanizmit të referimit në çdo njësi vendore, ekzekutimi i UMM / UM-ve nga zyrat e përmbarimit, punësimi); mungesë të shërbimeve, si p.sh.: strehimi për 48 orët e pritjes së UMM-ve, mbështetje ligjore falas gjatë divorcit, programe rehabilituese për dhunuesit; e shoqëruar kjo me kapacitete e burime njerëzore e financiare të kufizuara në një pjesë të konsiderueshme të institucioneve përgjegjëse, veçanërisht në bashki e komuna.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi dhe partneriteti me komunitetin është një nga përparësitë e PSH-së, e cila ka adoptuar edhe modelin e policimit në komunitet në strategjinë e saj 2007-2013. Policia bën përpjekjet e saj për të krijuar dhe ruajtur lidhjet me komunitetin urban e rural, veçanërisht përmes SPZ-ve. Gjithsesi, partneriteti me komunitetin mbetet një sfidë për shkak të kufizimeve njerëzore, logjistike e financiare të PSH-së për të realizuar aktivitete masive me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje, si dhe për shkak të apatisë dhe mosdhënies së rëndësishme së duhur këtij fenomeni nga e gjithë shoqëria.

# ***KAPITULLI 5***

## **REKOMANDIMET**

Bazuar në gjetjet dhe përfundimet e studimit, duke marrë në konsideratë nevojën për parandalimin dhe reduktimin e fenomenit të dhunës në familje, më poshtë do të vijojnë disa rekomandime që fokusohen tek aktivitetet me komunitetin, Policinë e Shtetit dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.

### **Aktivitete me komunitetin**

Të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit mbi ligjet për dhunën në familje, autoritetet përgjegjëse (MPÇSSHB, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë, Pushteti Lokal, Sistemi i Drejtësisë) dhe rolin e tyre të sanksionuar me ligj, procedurat në raste të denoncimit të incidenteve të dhunës në familje (ku dhe si), masat mbrojtëse, shërbimet mbështetëse për viktimat dhe dhunuesit etj.

Të promovohen të drejtat e njeriut duke u fokusuar veçanërisht tek të drejtat e fëmijëve, grave e minoriteteve; të trajtohet fenomeni dhe format e ndryshme të dhunës në familje; të rritet vetëbesimi tek popullata për të rritur nivelin e raportimit.

Këto aktivitete të realizohen nga policia dhe autoritetet e tjera përkatëse, duke realizuar vizita të rregullta nëpër shkolla, seminare me nxënësit, përgatitjen dhe shpërndarjen e broshurave informative e ndërgjegjësuese, aktivitete të tjera mediatike, duke promovuar përvojat pozitive dhe menaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës në familje. Aktivitete të tilla të konsiderohen me përparësi në zona dhe komunitete specifike me nivele tepër të ulta të ndërgjegjësitimit dhe raportimit të fenomenit të dhunës në familjes, siç janë zonat rurale dhe ato veriore, komunitetet rome e egjiptiane.

### **Policia e Shtetit**

Të përmirësohet imazhi publik i policisë duke përforcuar marrëdhëniet me komunitetin, duke vënë theksin në aspektet pozitive, gatishmërinë dhe shërbimet që Policia e Shtetit ofron për komunitetin në përgjithësi dhe për rastet e dhunës në familje në veçanti, dhe tek profesionalizmi, paanshmëria dhe zbatimi i etikës nga punonjësit e saj.

Të rritet ndërgjegjësimi për rolin real të policisë dhe efikasitetin e saj aktual përmes:

- Rritjes së pranisë dhe paraqitjes së aktivitetit të policisë në media (televizione dhe programe radiofonike, artikuj në gazeta e revista). Në këtë mënyrë do të jepet saktësisht dhe plotësisht roli i policisë në përgjigje ndaj dhunës në familje, duke siguruar shpërndarjen e informacionit të drejtë tek audienca. Duke qenë se media më e ndjekur dhe burimi kryesor i informacionit mbetet televizioni, është e preferueshme të krijohen marrëveshje me televizionet kombëtare dhe ato lokale për të krijuar hapësira televizive të herëpashershme për policinë dhe çështjet e dhunës në familje.
- Zhvillimit të një lidhjeje ([link](#)) brenda faqes së internetit të Policisë së Shtetit që të ofrojë informacion konkret, të detajuar dhe praktik, këshilla mbi dhunën në familje, të prezantojë rolin e policisë dhe informacione të tjera të nevojshme rreth shërbimeve në dispozicion, duke pasur si target grup të rinjtë, si përdoruesit kryesor të internetit, që janë gjithashtu përcjellës shumë të mirë të informacionit.
- Organizimit të aktiviteteve brenda ambienteve të komisariateve të policisë ku të ftohet komuniteti dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave të ndryshme që punojnë në këtë fushë në raste ngjarjesh specifike, për të prezantuar rolin, risitë apo arritjet e policisë.

Në vazhdimësi të disa nga planeve të PSH-së, si: shtimi i punonjëseve femra, rishikimi i strukturës përgjegjëse për dhunën në familje sipas dinamikës zonale, trajnimi i vazhdueshëm i stafit, të merret në konsideratë gjithashtu rishikimi i burimeve njerëzore (numri, profillizimi, specialitetet, detyrat dhe përgjegjësitë), riorganizimi i ambienteve të brendshme të komisariateve për të krijuar më shumë hapësira për intervistime individuale të viktimave dhe po aq të përshtatshme për fëmijët; përmirësimi i infrastrukturës, shtimi i burimeve financiare e logjistike (transport, pajisjet kompjuterike, burimet administrative), si dhe përdorimin e teknologjisë së fundit.

Të vazhdohet trajnimi dhe kualifikimi i mëtejshëm i të gjithë efektivave të policisë që merren me dhunën në familje, veçanërisht për ata që kontaktojnë direkt me viktimën (salla operative 129, patrullat, SPZ-të, specialistët e hetimit dhe parandalimit të krimit). Trajnimet duhet të përfshijnë përditësimin e njohurive mbi ndryshimet legislative e procedurale, teknikat e intervistimit, fazat e dhunës në familje, rritjen e kuptueshmërisë mbi nevojat dhe pikëpamjet e viktimës (për të shmangur riviktimizimin) dhe rritjen e familjaritetit me burimet në dispozicion (për të informuar më mirë viktimën).

**Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Të organizohen në mënyrë sistematike trajnime të përbashkëta me punonjës të institucioneve të ndryshme që merren me dhunën në familje (policia, bashkia, gjykata, prokuroria, zyra e përmbartimit, shkollat, qendra shëndetësore, media, OJF-të etj.) të fokusuar tek ndryshimet ligjore, strukturat e reja etj., çka do të sillte edhe rritje të ndërgjegjësimit për rolin e gjithsecilit, kuptimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve përkatëse, si dhe forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale.

Secili prej aktorëve përgjegjës për dhunën në familje të marrë përsipër realizimin e detyrave të paracaktuara në ligj: të ngrihen shërbimet e nevojshme për viktimat e dhunuesit dhe të sigurohet funksionaliteti i tyre në rastet e shërbimeve ekzistuese; të ngrihet mekanizmi i sistemit të reagimit të koordinuar dhe referimit të rasteve të dhunës në familje në të gjitha bashkitë; të jetë funksional dhe efektiv sistemi i reagimit i ngritur tashmë në disa bashki të vendit; të riorganizohen kapacitetet njerëzore e burimet e tjera për t'iu përgjigjur rolit të tyre ligjor.

Të forcohet edhe më tej bashkëpunimi e koordinimi ndërinstitucional: takime të rregullta, shkëmbim i vazhdueshëm informacioni mbi rastet, bashkërendimi dhe unifikimi i sistemit aktual të mbledhjes së të dhënave nga institucione të ndryshme për rastet e dhunës në familje.



## BIBLIOGRAFIA

Ligji nr:9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

Ligji nr:9914, datë 12.5.2008 "Për disa shtesa në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

Ligji Nr. 10 329, datë 30.09.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar

VKM Nr.334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"

Ligjin nr:8876, datë 4 Prill 2002 "Mbi shëndetin riprodhues"

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 23/2012 datë 1.3.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr:7895 datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje 2011-2015

Vendimi nr:573, datë 16.6.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin me bazë Gjinore e Dhunës në Familje 2011-2015, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj"

Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013. Tiranë, 2007

Plan Veprimi i PSH-së (shtator'11 –dhjetor'12) për zbatimin e planit të veprimit të SKBGJ-DHGDHF 2011-2015

Urdhër nr. 379 datë 03.03.2008 i ministrit të Brendshëm: "Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje"

Urdhër nr. 344, datë 05.10.2010 i ministrit të Brendshëm "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e ministrit të Brendshëm Nr.251, datë 15.02.2008, Për hartimin e statistikave të kriminalitetit", i ndryshuar

Urdhër nr:981 datë 31.10.2008 i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë "Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare"

Manual "Mbi procedurat standarde që duhet të zbatojë punonjësi i Policisë së Shtetit në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare". PSH-it, 2008

Strategjia për Trajnimin dhe Arsimin në Policinë e Shtetit Shqiptar, 2011-2016. MB / PSH

Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

INSTAT. Dhuna në familje në Shqipëri: vërtetim kombëtar me bazë popullatën. Mars 2009

- INSTAT. *Shqipëria: Studim demografik dhe mbi shëndetin*. Mars 2010
- UNICEF. *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*. Tiranë, 2006
- UNICEF. *Dhuna në familje ndaj grave në Shqipëri*. 2002
- Toska, Ariana, Corrokaj, Armila, dhe Aliaj, Emirtela. *Dhuna në familje dhe në komunitetet me etni të ndryshme*. 2008
- Rrjeti i Shoqatave kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit. Raporti "Ngritja e mekanizmit të referimit ndërsektorial për rastet e dhunës në familje, në nivel lokal dhe efektivitetit i funksionimit të tij". Mars 2010
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. "Raport: Zbatimi i ligjit për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare". Shkurt 2010
- QAGJZH & MPÇSSHB. *Dhuna në familje: Paraqitje e situatës aktuale*. Prill 2006
- Amnesty International. *Raport 2011: Situata e drejtave të njeriut në botë (Shqipëria)*
- Amnesty International. *T'i jepet fund dhunës në familje në Shqipëri: hapat e mëtejshëm*. Mars 2010
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. *Temë studimore: dhuna në familje, masat e marra dhe rezultatet e arritura kundër këtij fenomeni 2008 – 2010*
- ALO 116. *Raporti vjetor 2010*. Tiranë, Janar 2011
- UNICEF. *Harta e informacionit ekzistues mbi dhunën në familje në Shqipëri*. Tiranë, Tetor 2000
- Avokatët e Minesotës për të Drejtat e Njeriut. *Dhuna në familje në Shqipëri*. Prill 1996
- OSCE. *Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje: një manual për viktimat dhe OJF-të*. 2007
- OSCE. *Raporti mbi të drejtat e njeriut 2010 Shqipëri*
- USAID. *Udhëzimet për Urdhrat e Mbrojtjes në Shqipëri*. 2006
- USAID. *Protokolli shëndetësor në Shqipëri për dhunën në familje*. 2006
- Qendra "Fëmijët Sot". *Manual trajnimi "Dhuna në familje ndaj fëmijëve, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve"*. Tiranë, 2009
- Ministria e Shëndetësisë. *Një qasje praktike ndaj dhunës me bazë gjinore, udhërrëfyes për punonjësit e shëndetësisë*. Tiranë, 2010
- Draft final (i edituar) *Raport kombëtar mbi pozicionin e grave dhe barazisë gjinore në Shqipëri 2011*

## SHTOJCAT


### SHTOJCA A: LISTA E PJESËMARRËSVE NGA AUTORITETET DHE OJF-TË NË STUDIMIN CILËSOR

Institucioni / OJF-të	Emri i pjesëmarrësit	Pozicioni
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	Alida Tota	Drejtoreshë, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen
Ministria e Drejtësisë	Marsela Mezini	Inspektore pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor
Ministria e Drejtësisë	Agim Bega	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor
Ministria e Shëndetësisë	Luiza Alushi	Specialiste në sektorin e Shëndetit Riprodhues në Drejtorinë e Shëndetit Publik
Ministria e Shëndetësisë	Erol Çomo	Shef i sektorit të Mjekësisë Familjare në Drejtorinë e Shëndetit Publik
Bashkia e Durrësit	Aurora Hyka	Specialiste për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në Zyrën e Shërbimeve Sociale
Bashkia e Korçës	Elizeta Vando	Specialiste e nivelit të lartë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Drejtorinë e Përkrahjes Sociale
Bashkia e Shkodrës	Jeta Xhabiaj	Specialiste e nivelit të lartë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale
Bashkia e Vlorës	Rezarta Andoni	Specialiste e nivelit të lartë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje pranë Zyrës së Shërbimeve Sociale
Gjykata e Rrethit të Tiranës	Alkelina Gazidede	Gjyqtare civile
Gjykata e Rrethit të Tiranës	Bujana Tonçica	Zëdhënëse për shtypin
Gjykata e Rrethit të Shkodrës	Arbër Çela	Gjyqtar civil

Gjykata e Rrethit të Vlorës	Ervin Trashi	Gjyqtar civil
Prokuroria e Tiranës	Marjeta Zaimi	Zëvendësprokurore e Prokurorisë së Tiranës
Streha kombëtare (Kamzë)	Redinela Azizaj	Drejtoreshë e komanduar
Qendra/ strehëza "Vatra" (Vlorë)	Valbona Avdullai	Koordinatorë projekti për gratë e dhunuara dhe të trafikuar
ALO 116	Belioza Çoku	Koordinatorë
ALO 116	Gjergji Xhaholli	Mbikëqyrës në linjën e këshillimit të fëmijëve
"Sot për të ardhmen" (Durrës)	Viola Çikalleshi	Drejtoreshë
"Sot për të ardhmen" (Durrës)	Menada Petro	Punonjëse sociale për programin e dhunës në familje
"Gruaja tek gruaja" (Shkodër)	Trëndelina Boriçi	Koordinatorë
"Hapat e lehtë" (Shkodër)	Arlinda Kaca	Psikologe
"Hapat e lehtë" (Shkodër)	Luljeta Alibali	Punonjëse sociale
Fondacioni "Kenedi" (Korçë)	Voltisa Furxhi	Koordinatorë për dhunën në familje mes bashkisë dhe fondacionit; drejtuese e strehëzës për gratë e dhunuara
Shoqata "Gruaja Korçare" (Korçë)	Klara Çelo	Kryetare e shoqatës
UNICEF	Floriana Hima	Oficere projekti, Programi për Mbrojtjen e Fëmijëve, Të rinjve dhe Familjes
PNUD	Ermira Shkurti	Drejtuese programi, Programi për Barazinë Gjinore
PNUD	Elona Dine	Oficere projekti, Programi për Barazinë Gjinore
Shoqata e Grave me Probleme Sociale (Durrës)	Bajana Çeveli	Drejtoreshë ekzekutive
Shoqata e Grave me Probleme Sociale (Durrës)	Rezarta Agolli	Avokate
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare	Jonida Gezka	Juriste
Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara	Enkelejda Bakia	Koordinatorë
ProLGBT	Erjon Tela	Financier

Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci"	Afërdita Prroni	Drejtoreshë
Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci"	Jenna Peppenelli	Praktikante
Terre des hommes	Eva Dauti	Oficere advokimi
Në dobi të gruas shqiptare	Sevim Arbana	Presidente
Në dobi të gruas shqiptare	Migena Mollanji	Aktiviste gjinore
World vision	Dea Haxhi	Menaxhuese projekti
World vision	Jona Dogani	Mbrojtëse e fëmijëve
Amaro Drom	Skënder Veliu	Drejtor ekzekutiv
Shoqata e Ballkano-Egjiptianëve	Behar Sadiku	Kryetar i shoqatës

**SHTOJCA B: NIVELET NË POLICINË E SHTETIT TË INTERVISTUARA GJATË STUDIMIT CILËSOR**



Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, personat e intervistuar u përkasin departamenteve / drejtorive / sektorëve të shenjuar me ngjyrë të kuqe.

Në Drejtoritë e Policisë në Qarqe janë intervistuar Specialistë të Seksionit për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje.

Në Komisaritet e Policisë në kryeqendrat e qarqeve janë intervistuar nivele të ndryshme brenda Seksionit për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve: shef seksioni, specialistë për hetimin e krimeve dhe ndihmëspecialistë (SPZ).

